



Hëna e Re

Viti XXXIV | Nr.352 | Janar 2021 | Jumada al-Ula - Jumada al-Akhirah 1442 | Çmimi 50 den



**NË PRAG
TË TRE MUAJVE
TË BEKUAR...**

FILLON TV IKRE I BFI-së

Më 23 dhjetor, 2020, ka filluar realizimi i iniciativës së Kryetarit të BFI-së, **Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, për prezantimin virtual (viziv) të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes një kanali në *Youtube* dhe *Facebook* me emrin **TV Ikre**, që do të jetë kanal zyrtar online i saj.

TV Ikre do të sjellë një laramani projektësh, foto e video, punime me ligjërata, këshilla, organizime dhe aktivitete që do të zhvillohen nga ana e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të gjitha institucionet e saj.

Projekti i parë i kësaj platforme do të jetë emisioni "Ikre", që do të vijë për çdo natë të xhuma me hoxhallarë e figura eminente të vendit, me këshilla dhe informacione islame për besimtarët.

Kanali ka këtë përbërje kadrovike: **Evzal Sinani, Rexhep Ziberi, dr. Islam Islami, dr. Kujtim Mirzo, Omer Dauti, Xhemail Ahmed, Shaban Neziri.**

Më 24 dhjetor, nga ora 20:00, ka filluar emisioni i parë "Ikre" me mysafir Kryetarin e BFI, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, me temën "Islami, domosdoshmëri e së sotmes dhe e së nesërme", me moderator **hfz. Evzal Sinani**. Më 31 dhjetor është transmetuar (po ashtu

në orën 20) emisioni i dytë dhe në të mysafir ka qenë Myftiu i Myftinisë së Shkupit, **dr. Qenan ef. Ismaili**. Emisioni është realizuar me moderator **h. Rexhep ef. Ziberi**, ndërsa në të është biseduar rreth qëndrimit të Islamit ndaj rrjeteve sociale. Emisioni i tretë "Ikre", i emetuar më 7 janar, 2021, është titulluar "Islami dhe sfidat e organizimit të jetës fetare në Zvicër", me mysafir **hfz. Mehas ef. Alija**, Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, me moderator **hfz. Evzal Sinani**. Emisioni i katërt "Ikre", ndërkaq, është emetuar më 14 janar, 2021. Temë e tij ka qenë: "Bazat filozofike të pedagogjisë islame", me mysafir **prof. dr. Naser Ramadani** dhe moderator **h. Rexhep ef. Ziberi**.

TV Ikre në kohë reale, në të njëjtin moment, përemtohet nga **TV Globi (Gostivar)** dhe **TV Festa (Kumanovë)**, ndërsa një ditë më vonë, nga ora 12:15, transmetohet nga **TV Koha (Tetovë)**.

Kanali **TV Ikre** në *Facebook* mund të ndiqet në:

TV IKRE - Bashkësia Fetare Islame në RMV

Në *Youtube* shkon me parapagim, përmes kësaj lidhje:

https://www.youtube.com/channel/UCOuXMpu5cvxc6dq_EHB-GALg

VEÇUAM 2021: BUXHET REKORD PËR TRASHËGIMINË KULTURORE...

Siç është bërë e ditur nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut për agjencinë shtetërore MIA – transmeton NOVA TV (10.01.21) – në rrjedhë e sipër është konkursi publik për programin "Evropa kreative", ndërsa prioritetet prijatë për vitin në vazhdim (2021) mbeten mbrojtja e trashëgimisë kulturore, mbështetja e ideve dhe e kreativitetit të rinjtë dhe BE-integrimet.

– Mbrojtja e Kishës në Matejç është prioritet për vitin vijues, por edhe konservimi i Manastirit të Leshkës, dhe sanimi i Çarshi-Xhamisë në Prilep. Në pikëpamje të realizimit të prioritetëve në mbrojtje, Kurbinovo (rrethina e Resnjës) është në krye. Për momentin, nga Enti dhe Muzeu Manastir, të cilat edhe e udhëheqin këtë projekt, punojnë në mbrojtjen preventive të kishës, që ajo e sigurt ta kalojë dimrin dhe në paranverë të vazhdojnë me shërimin e kësaj vlere tonë të çmuar nga Kurbinova, thonë nga Ministria.

Gjithashtu, në mënyrë intensive punohet edhe në Ligjin për realizimin e interesit publik në kulturë, i cili është në Kuvend, përgatitet ligj i ri për trashëgiminë kulturore, ndërsa në rrjedhë e sipër është përpilimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit për të drejtat e autorit.

Për vitin 2021 është hapur program i ri buxhetor për trashëgimi kulturore në rrezik, për të cilën do të ndahen 12 milionë denarë. Është siguruar buxhet rekord për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në lartësi prej 105 milionë denarë (mbi 1,7 milion euro).

EDITORIAL

NË PRAG TË TRE MUAJVE TË BEKUAR...

Gjendemi në prag të muajt Rexheb të vitit 1442 hixhri, muaj i cili u paraprin muajve Shaban dhe Ramazan, të cilët, që të tre, ndër besimtarët myslimanë njihen si Tre Muaj me vlerë të veçantë. Rexhebi konsiderohet si muaji i faljes nga Allahu (xh. sh.) ose si muaji i mbjelljes; Shabani është muaji i ndërmjetësimit për falje, ose muaji i ujitjes, apo i kultivimit; ndërkaq, muaji Ramazan është muaji i shtimit të begatave dhe mirësive, ose muaji i korrjes apo mbledhjes së bereqetit.

Tanimë, edhe pse të lodhur nga prania e Covid-19 dhe nga masat për t'u mbrojtur nga ky virus, duhet bërë përpjekje në kushtet ekzistuese që sa më shumë ta shfrytëzojmë praninë e tyre. Kështu që, pos ibadeteve të përditshme, duhet shtuar vëllimi i punëve të dobishme dhe të mira, siç janë: ndihma njerëzve në nevojë, sadakaja, zeqati, agjërimi etj., e sidomos këtë të fundit Muhamedi (a. s.) e ka praktikuar gjatë muajit Shaban. Pejgamberi (a. s.) dhe myslimanët bashkëkohanikë të tij punonin shumë për të arritur mirësitë e këtyre tre muajve, duke falur namaze nafile, duke bërë dhikër, tesbih, falënderim ndaj Allahut (xh. sh.), duke kërkuar falje, duke ndihmuar të varfrit, duke gëzuar jetimët e kështu me radhë.

Gjatë këtyre tre muajve gjenden netët e mira, apo Netët e Mëdha, siç njihen ndër ne, të cilat duhet shënuar dhe shfrytëzuar për ibadete, e ato janë:

- **Nata e Regaibit**, sipas emrit të saj kuptohet se kjo është nata e dhuntive, e dhuratave, e shpërblimeve dhe e nxitjeve për vepra të mira. Kjo natë gjithnjë bie në natën e xhumasë së parë të muajit Rexheb (18 shkurt 2021). Kjo natë njihet edhe për nga ajo që thuhet se Emineja, nëna e Pejgamberit (a. s.), e ka hetuar veten se është shtatzënë.

- **Nata e Miraxhit**, e cila bie në natën e 27-të të muajit Rexheb, natë kjo të cilën e përmend edhe Kurani fisnik: "**Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës nga Mesxhidi Haram (nga Qabeja) deri në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar; (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), pamësi (i punëve të Muhamedit)."**

Pra, në këtë natë Muhamedi (a. s.) përjetoj ngritjen më të madhe dhe nga Allahu i madhërisëm ka pranuar obligimin për pesë kohët e namazit. Në këtë natë, po ashtu, Muhamedi (a. s.) gjatë kryerjes së Israsë dhe Miraxhit përjetoj shumë gjëra, të cilat atë e trimëruan në kryerjen e misionit të tij pejgamberik.

- **Nata e Beratit**, e cila bie në natën e 15-të të muajit Shaban. Kjo natë paralajmëron ardhjen e shpejtë të muajit Ramazan, muajit tonë më të dashur, kështu që sa më mirë duhet të përgatitemi shpirtërisht dhe fizikisht për agjërim dhe ibadete të tjera. Se çfarë nate është dhe çfarë rëndësie ka kjo natë, më së miri na e përshkruajnë hadithet e Muhamedit (a. s.): "**Në natën e 15-të të muajit Shaban të gjitha veprat nxirren përpara Zotit të gjithësisë; për këtë arsye unë dëshiroj që veprat e mia të nxirren para Tij deri sa unë agjëroj."**

- **Nata e Kadrit**, e cila bie në dhjetë netët e muajit Ramazan, është nata më e vlefshme dhe më e bekuar. Në të filloi të shpallet Kurani fisnik. Një kaptinë e Kuranit mban emrin e kësaj nate. Vlerën e kësaj nate më së miri na e tregon Kurani: "**Ne e shpallëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit; e ç'të bëri ty të dish se çka është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj...**"

Rreth Tre Muajve dhe vlerave të tyre në faqet e revistës sonë ka dhe do të ketë punime të detajuara, por qëllimi ynë është që këto pak rreshta të shërbejnë si paraprirje e njëherit t'i përkujtojmë lexuesit me rëndësinë e tyre, e cila duhet të shfrytëzohet siç është më së miri.

Qofshin me bereqet Tre Muajt!

Q. Osmani

NGA KURANI...

#1 Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishte i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj, falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai. (Ali Imran, 159)

#2 Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë. (Fussilet, 34)



#3 Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit! Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: 'Paqe qoftë!' (Furkan, 63)



REISI TAKOHET ME MINISTRIN OSMANI

Më 8 janar, 2021, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, u prit nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, z. Bujar Osmani, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Ministri Osmani fillimisht i uroi mirëseardhje Reis'ul-Ulemasë dhe e uroi për zgjedhjen në krye të Bashkësisë Fetare Islame, duke i dëshiruar shumë sukses në menaxhimin e institucionit më të lartë fetar në vend.

Kryetari, po ashtu, e uroi ministrin Osmani për postin e shefit të diplomacisë së vendit dhe i uroi suksese të shumta e mbarësi në detyrë.

Në vazhdim, z. Bujar Osmani e falënderoi Kryetarin, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për takimin, i cili, sipas tij, është një shenjë shumë e mirë nga ana e Bashkësisë Fetare Islame dhe vetë ai,

si Reis'ul-Ulema, për mbajtjen e raporteve të mira me udhëheqësit e vendit.

Kryetari e falënderoi Ministrin për mikpritjen dhe respektin dhe u shpreh se BFI duhet të ruajë marrëdhëniet me faktorët vendimtarë të vendit, për të qenë kështu në nivelin e duhur të shërbimit të myslimanëve.

Gjatë takimit u bisedua për çështje të ndryshme me rëndësi për myslimanët e vendit dhe Reis'ul-Ulemaja e njoftoi Ministrin për situatën aktuale në BFI dhe veprimtarinë e Rijasetit. Me theks të veçantë, u bisedua për raportet me faktorët e jashtëm dhe bashkëpunimin me jashtë.

Në takim Kryetari prezantoi i shoqëruar nga Drejtori për Marrëdhënie me Botën Arabe, h. Ismet ef. Ademi dhe Shefi i Kabinetit, hfz. Evzal Sinani, thuhet në njoftimin e BFI-së.

REISI PRITET NGA PRESIDENTI PENDAROVSKI

Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Stevo Pendarovski, më 13 janar, 2021, në rezidencën e tij në Vodno priti në takim punë Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Krahas anëtarëve të Kabinetit të Presidentit, në takim prezent ishte edhe ambasadori i RMV në Emiratet e Bashkuara Arabe, Shkëlqesia e Tij z. Abdulkadir Memed.

Fillimisht, Presidenti Pendarovski e uroi Reis'ul-Ulemanë për zgjedhjen në krye të BFI-së dhe i dëshiroi shëndet dhe suksese në udhëheqjen e saj. Ai po ashtu shprehu konsideratë të veçantë për punën e këtij institucioni fetar nën udhëheqjen e h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, si dhe për gjuhën e unitetit kah e cila synojnë ndryshimet në BFI.

Kryetari i BFI, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, falënderoi Presidentin Pendarovski për kohën dhe respektin, si dhe për urimet dhe dëshirat e sinqerta të shprehura nga ana e Kreut të shtetit. Ai e njoftoi Presidentin për aktivitetet dhe

veprimtaritë që ka ndërmarrë BFI në realizimin e pikësnyimeve dhe planeve për ta avancuar BFI-në, që të hapërojë me kohën, por edhe për pengesat në të cilat has ky institucion.

Nga ana tjetër, Presidenti Pendarovski u zotua se do t'i ofrojë përkrahje dhe bashkëpunim Reis'ul-Ulemasë dhe BFI-së për të gjitha çështjet ku është i mundshëm kontributi i tij.

Tradicionalisht, nën patronazhin e Presidentit të Shtetit dhe në bashkëpunim me Bashkësinë Fetare Islame organizohet Konferenca ndërkombëtare për dialog dhe tolerancë ndërfaqetare, mysafirë të së cilës janë edhe shumë figura eminente të vendeve të Lindjes së Mesme, ambasadorë të akredituar të shumë vendeve etj. Në lidhje me këtë Shkëlqesia e Tij, ambasadori z. Abdulkadir Memed, ka dhënë mendimin e vet dhe është konsultuar.

Në fund, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu i dhuroi një pikturë të Xhamisë së Pashës (Xhamia e Larre) në Tetovë Kryetarit të RMV, Stevo Pendarovski, përfundon njoftimi i BFI-së.

TAKIM ZYRTAR NË ABU DHABI (EBA)

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me ftesë të Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane (KBKM) me seli në Abu Dhabi, është duke qëndruar këto ditë në vizitë zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Më 17 janar, 2021, Reis'ul-Ulemaja zhvilloi një takim zyrtar me Shkëlqesinë e Tij, Kryetarin e KBKM, dr. Alij Rashid En-Nuajmij. Në takim u bisedua për çështje me rëndësi për myslimanët në rrafsh global dhe me theks të veçantë, në vendet e Ballkanit dhe në Maqedoninë e Veriut.

Kryetari i KBKM, dr. Alij En-Nuajmij, e njoftoi Reis'ul-Ulemanë me punët e KBKM dhe me planet e tyre. Reis'ul-Ulemaja, në takimin mjaft miqësor, i njoftoi të pranishmit me aktivitetet që janë duke u zhvilluar në Bashkësinë Fetare Islame dhe me synimet e saj. Po ashtu, i njoftoi nikoqirët me projektet për të ardhmen e BFI-së.



Kryetari i BFI-së u shoqërua nga Myftiu i Myftinisë së BFI-Kumanovë, h. Abedin ef. Imeri dhe Drejtori për Marrëdhënie me Botën Arabe pranë BFI-së, h. Ismet ef. Ademi. Nga KBKM, ndërkaq, në takim ishin edhe anëtarët e Kryesisë

dr. Halid el-Kabi dhe dr. Hasen el-Merzuki.

Në pritjen shumë vëllazërore palët u dakorduan për një bashkëpunim të mirëfilltë reciprok në të ardhmen, thuhet në njoftimin e BFI-së. (19.01.2021)



VEPRAT FLASIN: Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu inspekton punimet në institucionin Arkivi i Bashkësisë Fetare Islame, i cili pritet të fillojë me punë së shpejti. (6.01.2021)

SHAQIR EF. FETAHU TAKON SPASOVSKIN DHE BUSHIN

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 14 janar, 2021, ka pritur në Rijaset, në një takim zyrtar, Ministrin e Punëve të Brendshme të Maqedonisë së Veriut z. Oliver Spasovski dhe zv/Ministrin e Punëve të Brendshme z. Nazim Bushi, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Fillimisht, Ministri e uroi Reis'ul-Ulemanë për zgjedhjen në postin drejtues – Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe i dëshiroi shëndet dhe suksese

në udhëheqjen e këtij institucioni. Në vazhdim ai falënderoi Reisin dhe gjithë myftinjët e BFI të RMV për ndihmën e rezervë dhe angazhimin maksimal në luftën kundër pandemisë së Koronavirusit në vendin tonë. Gjithashtu, z. Spasovski potencoi se BFI ka bërë një punë të madhe edhe në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm. Ai tha se në rrethana të ndryshme, nga qarqe të ndryshme, tentohet që ekstremizmi dhe terrorizmi t'i vishen fesë islame, por që, në fakt, kjo nuk është e vër-

retë, sepse Islami është fe e paqes dhe se nuk ka asgjë të përbashkët mes ekstremizmit dhe terrorizmit me Islamin.

Pas kësaj, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi Ministrin e Punëve të Brendshme dhe zv/Ministrin e Punëve të Brendshme për vizitën, për urimet dhe dëshirat e sinqerta. Ai gjithashtu nga afër i njoftoi mysafirët me punën dhe aktivitetet e BFI-së, si dhe me planet që ka për të ardhmen ky institucion fetar, përfundon njoftimi i BFI-së.

DARIJAN SOTIROVSKI NË RIJASET

Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur në një takim pune drejtorin e Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze, mr. Darijan Sotirovski, i shoqëruar nga Robert Alagjovovski, koordinator nacional për interkulturalizëm në Qeverinë e RMV dhe nga z. Petar Petkovski.

Në takim, siç bëhet e ditur nga BFI, Kryetari i ka pritur mysafirët i shoqëruar nga Myftiu i Myftinisë së BFI-Shtip, h. Nasir ef. Rexhepi dhe referenti për vakëf në BFI, Driton Dikena.

Është biseduar për katër çështje themelore:

E para: Çështja e Orta-Xhamisë në Strumicë dhe rregullimi i statusit të saj përfundimisht. Një iniciativë e këtuilë është ngritur disa herë nga Bashkësia Fetare Islame dhe ka interes të madh për t'u zgjidhur përfundimisht. Kryetari i BFI-së është duke ndërmarrë hapa konkretë dhe

ditën e premte (25.12.2020), me lejen e Allahut, do të jetë për vizitë në Strumicë që ta shohë nga afër Orta-Xhaminë.

E dyta: Xhamia e Husamedin Pashës në Shtip, për të cilën ka një kontest, për të cilin shpresojmë të zgjidhet dhe për të njëjtin do të inicohet krijimi i një komisioni ekspertësh që do të japë vlerësimin shkencor për objektin dhe natyrën e tij, pas së cilës do të fillojnë bisedimet mes BFI-së dhe KOM-it për ta zgjidhur problemin njëherë e mirë.

E treta: Çarshia-Xhamia e Prilepit është çështje e lënë zyrave të ndryshme për një kohë të gjatë dhe aktualisht ka vullnet nga të gjitha palët për zgjidhjen e këtij problemi. Kjo xhami do të jetë një pasuri e madhe kulturore dhe dëshmi e qartë e frymës së bashkëjetesës në Maqedoninë e Veriut.

E katërta: Xhamia e Tabanocit, xhamia më e vjetër në Maqedoninë e Veriut, e ndërtuar nga tregtarët arabë qysh para

ardhjes së osmanëve në këto vise, një perlë që doemos të rindërtohet dhe të zbukurohet, për t'iu kthyer hijeshia që e meriton. Kjo xhami bie në territorin e Kumanovës dhe gjendet shumë afër kufirit që çon në Preshevë.

Kryetari i Komisionit, z. Darijan Sotirovski, dhe koordinatori nacional për interkulturalizëm, z. Robert Alagjovovski, shprehën gatishmërinë e tyre për të ndihmuar në zgjidhjen e këtyre kontesteve dhe problemeve në një afat sa më të shpejtë kohor. Reisul Ulema, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, nga ana tjetër, u shpreh para të pranishmëve se këto çështje të pazgjidhura janë plagë të hapura për bashkëjetesën e vendit tonë dhe se ai, së bashku me organet përkatëse, kanë gatishmëri të plotë dhe punojnë me të gjitha mundësitë që këtyre xhamive t'u kthehet bukuria dhe të rregullohen njëherë e përgjithmonë, thuhet në njoftimin nga BFI. (23.12.2020)

KOMISIONI SHTETËROR Mbledh Bashkësitë Fetare

Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 30 dhjetor, 2020, ka marrë pjesë në takimin e punës në organizim të kryetarit të Komisionit për Marrëdhënie mes Bashkësisë Fetare, z. Darijan Sotirovski, njofton BFI.

Në takim, i pranishëm ka qenë Kryepeshkopi i Ohrit dhe i Maqedonisë, Imzot Stefani, Ipeshkvi i Shkupit dhe Eparku i Strumicës dhe Shkupit, z. Kiro Stojanov dhe superintendenti i Kishës Evangjeliste-Methodiste, z. Marijan Dimov. Për shkaqe objektive, mungoi kryetarja e Bashkësisë Hebraike të Maqedonisë së Veriut, znj. Berta Romano Nikoliq, thuhet në njoftim.

U diskutua për shumë çështje, duke filluar nga rezultatet e anketës së zhvilluar nga Komisioni rreth opinionit publik të të rinjve karshi bashkësive fetare. Liderët fetarë ranë dakord që të formohen grupe të miqësisë mes shërbyesve të ardhshëm fetarë të të gjitha komuniteteve, me qëllim njohjen dhe krijimin e fushës për bashkëpunim në dobi të të gjithë qytetarëve të RMV në të ardhmen.

Çështje tjetër që u trajtua ishte edhe reformimi i arsimit filor dhe njëzëri liderët kërkuan nga Ministria përkatëse për-



fshirjen e Bashkësive Fetare në diskutimin publik, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të lëndës së Etikës së religjioneve, si dhe mbrojtjen e mësimdhënësve të së njëjtës, e mbi të gjitha evitimin e vendimeve që nuk do të ishin të pranueshme sipas vlerave tona shoqërore.

Po ashtu, u diskutua për propozim-ligjin për ndalimin e dhunës dhe mbrojtjen e gruas dhe propozim-ligjin për tatim në prona, për të cilët, me qëllim përmirësimin e rregullativës ligjore, do kontribuojnë konstruktivisht me propozime drejtuar propozuesve përkatës, thuhet në njoftimin e BFI-së.

AMBASADORJA E SHBA-ve NË BFI

Më 12 janar, 2021 ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, Shkëlqesia e Saj Kate Marie Byrnes vizitoi BFI-në dhe u takua me Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Fillimisht, Ambasadorja e SHBA-ve ia uroi zgjedhjen në krye të BFI-së Reis'ul-Ulemasë dhe i dëshiroi shëndet dhe suksese në drejtimin e BFI në të ardhmen. Ambasadorja dha vlerësime shumë të larta për ecurinë e punëve në Bashkësinë Fetare Islame dhe qëndrimet e Reis'ul-Ulemasë për çështjet aktuale.

Kryetari i BFI e falënderoi mysafirin e çmuar për vizitën, për përkrahjen dhe mbështetjen e rezervë që ka BFI nga Ambasada Amerikane, si dhe për urimet e përcjella për një udhëheqje sa më të mirë, të drejtë, efikase dhe frytdhënëse.

H. hfz. Shaqir ef. Fetahu gjithashtu e njoftoi Shkëlqesinë e Saj Kate Marie Byrnes me organizimin dhe funksionimin e BFI-së në këtë periudhë, si dhe për planet dhe projektet që do të ndërmerren në të ardhmen nga institucioni më i lartë fetar islam në vendin tonë.



Në fund të takimit, Reisi në shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi i dhuroi znj. ambasadore një pikturë të Xhamisë së Pashës (Xhamia e Larme) në Tetovë, pasi

që Ambasada Amerikane ka dhënë kontribut të madh në restaurimin e kësaj xhamie me vlerë të madhe kulturore dhe historike, thuhet në njoftimin e BFI-së.

PRITJE PËR AMBASADORIN E KOSOVËS

Më 14 janar, 2021, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në një takim njoftues, në Rijaset, Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Shkup, z. Gjergj Dedaj, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Shkëlqesia e Tij z. Dedaj e uroi Rei-

s'ul-Ulemanë për zgjedhjen në postin drejtues të Bashkësisë Fetare Islame dhe i dëshiroi suksese në të ardhmen në drejtimin e këtij institucioni fetar, duke e vlerësuar lart angazhimin dhe veprimtarinë e Reis'ul-Ulemasë në udhëheqjen e BFI-së.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu,

e falënderoi ambasadorin Gjergj Dedaj për urimet dhe dëshirat e sinqerta dhe e njoftoi atë me ecurinë e punëve në BFI, si dhe me planet për ecurinë e mëtejshme të punëve të Bashkësisë Fetare Islame.

Në shenjë respekti, Ambasadori i dhuroi Reis'ul-Ulemasë një flamur të Kosovës dhe një kopje të Kushtetutës.

NAIM EF. TËRNAVA VIZITON BFI-në

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur në vizitë Myftiun e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, h. Naim ef. Tërnavë, me anëtarë të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Myftiu Tërnavë e ka vizituar homologun e tij, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e zgjedhjes Kryetar i BFI-së. Ata janë pritur në selinë e Bashkësisë Fetare Islame nga Reis'ul-Ulemaja dhe anëtarë të Rijasetit.

Myftiu Tërnavë e ka përshëndetur zgjedhjen e Shaqir ef. Fetahut në funksionin e Reis'ul-Ulemasë dhe i ka uruar shëndet dhe mbarësi.

Nga ana tjetër, Reis'ul-Ulemaja e falënderoi mikun e tij të kahershëm, Myftiun e Kosovës dhe biseduan për shumë çështje me rëndësi për të dyja palët, më e rëndësishmja e të cilave- intensifikimi i marrëdhënieve të mira mes bashkësive simotra dhe zhvillimi i hovshëm dhe i mëtejshëm i bashkëpunimit mes të gjitha

bashkësive fetare të rajonit, e në veçanti mes tri bashkësive simotra, asaj të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Ndër të tjera, njëzëri deklaruan se përfaqësimi i denjë i Islamit është kyç dhe shumë i rëndësishëm për kohën dhe vendin në të cilin jetojmë.

Në fund, të dy kryetarët dhanë një deklaratë të përbashkët për media dhe falën namazin e drekës në Xhaminë Isa Beu, përfundon njoftimi i BFI të RMV. (24.12.2020)

AMBASADORI MEMEDI NË BFI

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu ka pritur në një takim ambasadorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe ambasador jorezident për shtetet e Gjirit Persik (Arabinë Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kuvajtin, Bahrejin, Omanin), z. Abdulkadër Memedi.

Shkëlqesia e Tij, Ambasadori Memedi, kishte ardhur për ta uruar Kryetarin e BFI-së për zgjedhjen Reis'ul-Ulema i institucionit më të lartë përfaqësues të myslimanëve në vend.

Reis'ul-Ulemaja, thuhet në njoftimin e BFI-së, e ka mirëpritur mysafirin, e ka njoftuar atë me situatën aktuale në Bashkësinë Fetare Islame, me punët që janë duke u bërë dhe me strategjinë e tij për zhvillimin e institucionit në të ardhmen. Nga ana tjetër, Ambasadori Memedi e ka përshëndetur zgjedhjen e h. hfz. Shaqir ef. Fetahut në funksionin Reis'ul-Uelma të BFI të RMV dhe e ka njoftuar për punën që bën. (23.12.2020)

KRYETARI DUKA VIZITON REIS'UL-ULEMANË

Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur në një vizitë Kryetarin e Komunës së Dibrës, z. Hekuran Duka.

Kryetari ka prezantur në takim i shoqëruar nga Myftiu i Myftinisë së BFI-Dibër, h. Reshat ef. Kaçallniku, për të uruar Reis'ul-Ulemanë në deytirën e re.

Në takim mysafiri është informuar me rrjedhën e punëve në Bashkësinë Fetare Islame dhe me planet që i ka Reis'ul-Ulemaja për institucionin në të ardhmen, sikundër dhe në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes Myftinisë së Dibrës dhe Komunës. (24.12.2020)

PUNËTORI KUNDËR TERRORIZMIT

Më 23 dhjetor, 2020, Organizata Ndërkombëtare për Migrim - IOM, që merret me Platformën ndërfaqetare dhe multikonfessionale për dialog, në kuadër të projektit rajonal "Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes zërave dhe nismave lokale në Ballkanin Perëndimor", financuar nga Byroja Kundër Terrorizmit në Departamentin Amerikan të Shtetit, në bashkëpunim me Komitetin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit, ka organizuar punëtori njëditore në Shkup.

Përfaqësues të Bashkësisë Fetare

Islame të RMV ishin mr. Mustafa Dauti, drejtor i Sektorit për punë të jashtme (kontakte me faktorin ndërkombëtar OSBE, BE dhe faktorin e brendshëm); Fadil Ramadani, kryetar i OH "Hilal" dhe prodekani i FSHI doc. dr. Muaz Agushi.

Qëllimi i punëtorisë, thuhet në njoftimin e BFI-së, ishte fasiliteti i platformave të dialogut ndërfaqetare dhe multikonfessionale, për të identifikuar forma të reja të angazhimit, që do të arrijnë një audiencë të re dhe të përparuar teknologjikisht, por që është në rrezik nga radikalizmi.



Urimi i Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu drejtuar Kryepeshkopit të Kishës Ortodokse Maqedonase-Arkishopia e Ohrit, Imzot Stefani, dhe të gjithë besimtarëve ortodoksë të vendit për festën e Krishlindjeve. (6.01.2021)

TAKIM PUNE: XHAMIA E TABANOCIT NË FOKUS

Kryetari i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 5 janar, 2021, ka pritur në takim pune drejtorin e Qendrës Nacionale për Konservim, z. Memet Selmani. I shoqëruar nga referenti për Vakëf pranë BFI-së, Driton Dikena, në takim Kryetari fillimisht falënderoi Drejtorin e nderuar për bashkëpunimin e deritani dhe biseduan për çështje të shumta, ndër më kryesoret: Xhamia e Tabanocit; Hynkar-Xhamia në Dibër; riparimi i kubesë së Xhamisë së Mustafa

Pashës; dhe fillimi i revitalizimit të Xhamisë së Murat Pashës në Çarshinë e Shkupit.

Drejtori i Qendrës Nacionale për Konservim, z. Memet Selmani, thuhet në komunikatën e BFI-së, e njoftoi Reis'ul-Ulemanë për projektet e kryera deri më tani dhe ecurinë e katër projekteve të lartpërmendura. Me theks të veçantë u bisedua për Xhaminë e Tabanocit, për të cilën Reis'ul-Ulemaja i shprehu drejtorit Selmani gatishmërinë e plotë nga

ana e Bashkësisë Fetare Islame për të kryer gjithçka që kërkohet prej BFI-së, me qëllim që xhamia të rikthehet në gjendjen origjinale sa më shpejt që të jetë e mundur.

Me shtimin e intensitetit të punëve për këtë çështje, dhe për të gjitha vakëfet në përgjithësi, ka shpresë që këto punë, me vullnet të mirë nga institucionet shtetërore dhe BFI-ja, do të zgjidhen në afat të shkurtër, me mbarësinë e Allahut.

BFI NË MBËSHTETJE TË MËSIMBESIMIT FETAR

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikën e Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur një delegacion të mësimdhënësve të mësimbesimit fetar në shkollat fillore të RMV, të cilët e kanë uruar Kryetarin e BFI për zgjedhjen në postin udhëheqës të BFI dhe e kanë njoftuar atë me sfidat dhe rrjedhën e punëve të tyre.

Reis'ul-Ulemaja, thuhet në njoftimin e BFI-së, e përshëndeti vizitën e tyre, tha se e mbështet punën e tyre dhe të gjithë së bashku u dakorduan që së shpejti të organizojnë një takim me të gjithë mësimdhënësit e lëndës Etika e Religjioneve në nivel republikan. (5.01.2021)


PROF. ABAS JAHJA MERR ÇMIM NË TURQI

Ish-profesori i Fakultetit të Shkencave Islame dhe ish-Drejtori i Sektorit për Kulturë dhe Shkencë pranë Rijasetit të BFI-së, prof. dr. Abas Jahja, ka fituar çmimin e "Shkrimtarëve, intelektualëve dhe artistëve të vitit" nga Unioni Turk i Shkrimtarëve, për librin me titull "Zëra të vjetër nga bijtë e çlirimtarëve - Ilahi nga Ballkani".

Bashkësia Fetare Islame, me në krye Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe të gjitha institucionet e saj urojnë profesorin e nderuar për këtë dekoratë jashtëzakonisht të rëndësishme, që është rezultat i punës dhe kontributit të tij të palodhshëm në fushën shkencore e në veçanti në kultivimin e ilahive të vjetra dhe bashkëkohore me motive të nënqiellit tonë.

Jemi të bindur se kjo do të jetë edhe inspirim i një zhvillimi të mëtejshëm të ilahive dhe kasideve me motive fetare-kulturore dhe vlere që duhet të promovohen – thuhet në njoftimin e BFI të RMV. (6.01.2021)

Për më tepër: <https://www.aacom.tr/sq/kultur%3%AB/akademiku-shqiptar-nga-tetova-fiton-cmim-n%3%AB-turqi-p%3%ABr-librin-mbi-ilahit%3%AB-e-fshehura-t%3%AB-ballkanit/2100348>



KOORDINATORËT E HUDAJI-VAKËFIT VIZITONË REISIN

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 11.01.2021 ka pritur në një takim përurues z. Rafet Bilaç, Koordinator për Ballkanin i Hudaji-Vakëfit me seli në Stamboll dhe z. Ahmet Lokçe, Koordinator i Hudaji-Vakëfit për Maqedoni të Veriut, cilët ishin të shoqëruar nga Myftiu i Shtipit dhe Maqedonisë Lindore, Nasir ef. Rexhepi, të cilët ia uruan Kreut të BFI zgjedhjen në postin drejtues dhe i dëshiruan punë të mbarë dhe të suksesshme në drejtimin e institucionit më të lartë fetar islam në Maqedoninë e Veriut.

Fillimisht, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi mysafirët e nderuar për vizitën dhe për respektin e treguar, si dhe për urimet dhe dëshirat e singerta. Ai në formë të veçantë falënderoi z. Rafet Bilaç dhe z. Ahmet Lokçe, si dhe Fondacionin Hudaji-Vakëf për gjithë angazhimin dhe mbështetjen që ia japin Myftinisë së Shtipit, posaçërisht Paraleles së Shtipit të Djemve të Medresesë Isa Beu në qytetin e Shtipit, duke premtuar se bashkëpunimi i ndërsjellë, mes BFI dhe Hudaji-Vakëfit, do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

ENES IBRAHIM (THP) VIZITON BFI-në

Kryetari i Partisë së Lëvizjes së Turqve (Türk Hareket Partisi), z. Enes Ibrahim, me anëtarë të kryesisë së partisë, kanë qëndruar në BFI. Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i ka pritur mysafirët dhe ka zhvilluar një bisedë të shkurtër me ta. Kryetari i THP është edhe deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ai ka qenë i shoqëruar nga z. Menfi Iljaz dhe z. Maksud Ali, anëtarë të Kryesisë.

Reis'ul-Ulemaja i mirëpriti mysafirët që kishin ardhur për ta uruar me rastin e zgjedhjes në krye të BFI-së dhe i falënderoi për vizitën. Në një takim të përzemërt, ata u njoftuan me zhvillimet dhe funksionimin e Bashkësisë Fetare Islame dhe me planet që Kryetari i ka për të ardhmen e këtij institucioni, thuhet në njoftimin e BFI-së. (22.12.2020)

URIME PËR DITËN E ARSIMIT TURK NË RMV

Kryetari i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka uruar komunitetin turk në Maqedoninë e Veriut me rastin e 21 Dhjetorit – Ditës së arsimit turk në RMV. Në letër e urimit thuhet:

"Në emrin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, në emër të të gjitha institucioneve dhe organeve të saj dhe në emrin tim personal, ju urojmë 21 Dhjetorin-Ditën e arsimit në gjuhën turke në Maqedoninë e Veriut, e cila për turqit e këtij vendi është festë nacionale.

E drejta e arsimit në gjuhën amtare është e drejtë elementare e çdo komuniteti, nga që gjuha është nga elementet më të rëndësishme që përcakton personalitetin e një individi. Gjuha është elementi kryesor që na mundëson të komunikojmë me njëri-tjetrin, për t'i shërbyer vetes e të tjerëve. Një jetë pa gjuhë, do të ishte e paimagjinueshme. Prandaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme që çdokush të ketë të drejtë të edukohet dhe të arsimohet në gjuhën e vet.



Me këtë rast, urojmë të gjithë komunitetin turk në Maqedoninë e Veriut për Ditën e arsimit në gjuhën turke në Maqedoninë e Veriut, me shpresë se edukimi

dhe arsimimi i mirëfilltë i tyre do të ndihmojë edhe më tej në zhvillimin dhe forcimin e shoqërisë sonë në përgjithësi." (20.12.2020)

PËRCILLET PROCESI ARSIMOR NË FSHI

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 11 janar, 2021, ka vizituar Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup, me ç'rast është takuar me stafin akademik të këtij fakulteti, të udhëhequr nga dekanin prof. dr. Shaban Sulejmani. Ata kanë biseduar rreth çështjeve aktuale në Fakultetin e Shkencave Islame, organizimin e procesit arsimor dhe sfidave me të cilat përballlet ky institucion i lartë arsimor në kohën e pandemisë globale, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Reis'ul-Ulemaja u informua nga afër rreth procesit arsimor dhe nevojave të stafit akademik të këtij fakulteti, me qëllim që të krijohen kushte optimale, që do të mundësojnë zhvillimin e aftësive dhe pranimin e sfidave dhe mundësive që i ofron shekulli 21, si dhe integrimin e teknologjive informative në procesin e mësimdhënies.

Kreu i BFI-së në këtë takim prezantoi rreth temave të integritetit të mësimdhënies, aktiviteteve kreative dhe shkëmbimin e ideve të cilat do të mundësojnë përgatitjen e studentëve për të ardhmen, ku më lehtë do të mund të ndërtojnë karrierë në sferën e shkencave islame, që të punësohen në institucionet e BFI-së të RMV.

Themelues i Fakultetit të Shkencave Islame është Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe misioni i tij është që të eksplorojë, të zhvillojë dhe të promovojë mësimdhënien dhe hulumtimin në projekte të ndryshme shkencore, me qëllim avancimin e dijeve, të aftësive dhe të shkathësisë të studentëve. FSHI ka vizion të qartë në ndërtimin e një kuadri të përgatitur mirë, të gatshëm t'u përgjigjet sfidave të kohës në fushën e shkencave islame, përfundon njoftimi i BFI-së.



REISI NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË MEDRESESË

Më 6 janar, 2021, i shoqëruar nga Drejtori i Sektorit Fetaro-Arsimor pranë BFI-së, prof. Jusuf ef. Zimeri, në prezencën e Sekretarit të SHMI "Medreseja Isa Beu" – Shkup, prof. Lutfi Nexhipi, administratoreve të Paraleleve të Vajzave në Shkup, Tetovë dhe Gostivar dhe kujdestarëve të klasave, në organizim të Drejtorit të Përgjithshëm të SHMI "Medreseja Isa Beu" – Shkup, prof. Ibrahim ef. Idrizi, pata kënaqësinë të prezantoj në Mbledhjen e rregullt përmbyllëse të gjysmëvjetorit të parë të vitit akademik 2020/21 të Këshillit edukativo-arsimor të SHMI "Medreseja Isa Beu" – Shkup, ka shkruar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në Facebook.

Mbledhja u hap nga Drejtori i Medresesë, i cili pasi përshëndeti të pranishmit e prezantoi rendin e ditës të përbërë nga pikat në vijim: 1. Raport me shkrim nga kujdestarët e klasave për suksesin, sjelljen e nxënësve dhe mungesat për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2020/21; 2. Raport nga profesorët e lëndëve për realizimin e planprogramit; 3. Raport me shkrim nga Këshilli i eduka-

torëve për realizimin e rendit shtëpiak; 4. Verifikimi i rezultateve nga sesioni i janarit 2021 për nxënësit me korrespondencë dhe ato të diplomës, 5. Fillimi i gjysmëvjetorit të dytë; 6. Të ndryshme.

Pas prezantimit të rendit të ditës, Drejtori më nderoi me një fjalë rasti, në të cilën përurova të pranishmit për përmbylljen e suksesshme të këtij gjysmëvjetori, nga më të vështirët në historinë e Medresesë, dhe vlerësova lart suksesin e arritur nga Qendra dhe të gjitha Paralelet e Medresesë.

Ky sukses është një e arritur e madhe, që dëshmon fuqishëm se Medreseja ka afinitetet dhe mundësitë të organizojë mbarëvajtjen e procesit mësimor me prezencë fizike edhe në rrethana të jashtëzakonshme si kjo e pandemisë së Covid-19 dhe kjo është rezultat i kontributit dhe përkushtimit të udhëheqjes, administratës dhe të gjithë profesorëve të Qendrës dhe të gjitha Paraleleve të Medresesë.

Pas hyrjes, fola edhe për një çështje që është mjaft aktuale dhe është nga prioritetet e udhëheqjes sonë: akreditimi i SHMI "Medreseja Isa Beu" dhe zgjidhja përfundimtare e statusit të saj. Në këtë

pikë treguam se në fund të shkurtit, Bashkësia Fetare Islame pret përgjigje nga institucionet shtetërore, me ç'rast do të merren edhe hapat e radhës për fazat tjera.

Ndër të tjera, përmendëm se bazuar në ajetin kuranor që urdhëron të "ndihmoheni mes vete në të mira dhe devotshmëri e jo për mëkate e armiqtësi", të gjithë duhet të angazhohemi dhe të japim maksimumin tonë për të çuar përpara proceset në Medrese. Në fund, me sinqeritet këshillova veten dhe të gjithë të pranishmit që të kenë bindje dhe besim në Zot, sepse të gjitha punët do të rregullohen dhe, gjithsesi, do të vijë ndihma e Zotit.

Pas fjalës së rastit u zhvillua mbledhja dhe u diskutuan një nga një të gjitha pikat e rendit të ditës.

Ky gjysmëvjetor kurorëzoi punën e madhe të të gjitha organeve të BFI-së dhe punën e zellshme të të gjithë nëpunësve dhe kolektivit të SHMI "Medreseja Isa Beu" – thuhet në njoftimin publik të Kryetarit të BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

MIRË SE VINI, BASHKATDHETARË TË DASHUR!



Të dashur bashkatdhetarë, të nderuar mërgimtarë!

Ju dëshirojmë përzemërsisht mirëseardhje në vendlindjen tuaj!

Ardhja juaj i jep shpirt këtij viti të vështirë që lëmë pas dhe Bashkësi Fetare Islame ju dëshiron të gjithëve qëndrim të rehatshëm dhe pushim të këndshëm.

Ju keni qenë dhe mbeteni shtyllë e fuqishme e shoqërisë sonë në përgjithësi, po edhe e institucionit tonë në veçanti. Prandaj, Bashkësi Fetare Islame do të jetë në shërbimin tuaj për çdo nevojë që keni.

Allahu ju bekoftë dhe ju dhashtë shëndet e mbarësi juve dhe familjeve tuaja!

Me respekt,

Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (22.12.2020)

FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME NXJERR MAGJISTRIN E PARË

Koordinatori i Qendrës Islame Shqiptare "El Furkan" në Mynih (Gjermani) dhe imam i Xhamisë së Re në fshatin Çe-gran të Gostivarit, h. Latif ef. Ameti, më 26 dhjetor, 2020, ka mbrojtur me sukses tezën e masterit në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup.

Teza e magistraturës mban titullin: "Ritet e dasmës në përjasje me të drejtën e shariatit në rrethinën e Gostivarit" dhe është mbrojtur para komisionit në përbërje: prof. dr. Abdulxhemil Nesimi, kryetar; prof. dr. Ismet Osmani, anëtar; dhe prof. dr. Shaban Sulejmani, mentor.

Në mbrojtje ka qenë prezent edhe Kryetari i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me bashkëpunëtorë, i shoqëruar nga u.d. Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli dhe referentët, prof. Sherif ef. Dehari, mr. Eljesa ef. Asani dhe h. Mallzim ef. Zendeli. Në fjalën e tij të rastit, Reisi ka uruar imam Latif Ametin, si student i parë që u magjistrua në FSHI.

Ai po ashtu ka uruar FSHI-në si institucion i lartë i studimeve islame në RMV për punën që bën në promovimin e kuadrin fetar në RMV dhe më gjerë.

Në punimin e magistraturës "Ritet e dasmës në përjasje me të drejtën e shariatit në rrethinën e Gostivarit" kandidati Latif Ameti ka vënë në spikamë faktin që populli ka zhvilluar një jetë të pasur shpirtërore, ku në mënyrë të qartë ka ditur ta paraqesë dhe ta përfytyrojë artistikisht, estetikisht dhe në përputhje me traditat edhe fenë islame. Pa dyshim, kjo temë paraqet një kontribut për zbardhjen e një pjese të riteve të dasmës shqiptare të kësaj ane në përjasje me shariatin islam.

Me këtë rast, dekani i FSHI-së, prof. dr. Shaban Sulejmani, uroi që FSHI të vazhdojë me regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve. Ai theksoi se FSHI punon edhe në akreditimin e studimeve të ciklit të tretë (studimeve të doktoratës).

REAGIM I DOMOSDOSHËM

Shumë të dashur gurbetqarë!

Dëgjoj se këto ditë keni qenë shëndësuar e sulmeve të paarsyetueshme të do individëve që, dorën në zemër, nga këto veprime, duket se nuk ia duan të mirën shqiptarisë dhe shoqërisë sonë.

Por, ju mos u ligështoni, sepse asnjë individ s'mund ta zvogëlojë as sa një grimcë suksesin tuaj historik.

Historik, pa dyshim, sepse në çdo çështje të madhe të fesë dhe të kombit tonë ju ishit adresa e parë e vendlindjes.

Kur ishte në pyetje Universiteti i Tetovës, JU ISHIT ATJE!

Kur u bë lufta në Kosovë, në Serbi, po edhe në Maqedoni, JU ISHIT ATJE; dhatë ndihma milionëshe për UÇK-në, po edhe jetën tuaj!

Kur duhej strehuar refugjatët, ju hapët shtëpitë tuaja për vëllezërit tuaj dhe nuk thatë as një gjysmë fjale ankese!

Ju ishit dhe jeni atje ku lypet prej jush për të ndërtuar xhami, medrese, mejtepe, shkolla, ambulanca, spitale. Ju ndihmoni dhe mirëmbani qindra e mijëra xhami; atje ku jetoni, po edhe në vendlindje.

Sa herë që ne ju thërrasim, nuk hasim në vesh të shurdhër; sa herë që ju kërkohet, ju e hapni derën; keni qenë dhe do mbeteni, këtu, në vendlindje dhe në zemrat tona, sepse ju jeni vetë zemra jonë, ju e mbani të gjallë trupin tonë, ju jeni ne dhe ne jemi ju.

Prandaj, mos u mërziqni e as mos u ligështoni! Ata që ju shajnë, e bëjnë për t'u faktorizuar vetë nëpërmjet emrit tuaj të madh: MËRGIMTAR, që në përkthim shpirti do të thotë: AT-DHETAR I PËRBETUAR.

Bashkësi Fetare Islame me të gjitha institucionet e veta, myftinitë, medresetë, Fakultetin, xhamitë e mejtepet ka qenë dhe është në shërbimin tuaj plotësisht. Ju lus që, për çdo nevojë që keni, sado e vogël të jetë, mos ngurroni të na drejtoheni neve.

Të mirën e kthejmë me të mirë dhe gjithmonë do të jemi këtu për ju, ashtu siç keni qenë ju gjithmonë këtu për ne.

Me respekt të thellë dhe mirënjohje të sinqertë,

Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (24.12.2020)

"PËRQAFIM MES VËLLEZËRVE"

Myslimanët anekënd botës kanë mirëpritur vendimin për normalizim të plotë të marrëdhënieve mes Mbretërisë së Arabisë Saudite, me tri aleatët e saj, dhe Shtetin e Katarit.

Ky vendim shumë i vlefshëm fetarisht është zyrtarizuar në Konferencën e 41-të të shteteve të Gjirit Arabik, të mbajtur në El-Ula të Arabisë Saudite.

Ne, si Bashkësi Fetare Islame, e përshëndesim këtë vendim kaq të madh dhe unë, në emrin tim, të institucionit të BFI-së dhe të gjithë besimtarëve të vendit, urojmë shtetet mike të Saudisë me aleatët dhe Katarin dhe të gjithë myslimanët!

Në pajtimin mes këtyre dy vendeve, që do të ndikojë dukshëm në stabilitetin e Lindjes së Mesme dhe të rajonit, rol të madh ka luajtur ndërmjetësimi i Kuvajtit dhe i SHBA-ve.



Na qoftë për hair, e gjithmonë kësi lajmesh dëgjofshim!

Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (6.01.2021)

MBLEDHJE RAPORTUESE E MYFTINISË SË SHKUPIT

Më 28 dhjetor, 2020, realizuam me sukses Mbledhjen raportuese, të fundit për këtë vit, me anëtarët e Myftinisë së Shkupit – ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, Qenan ef. Ismaili, në rrjetin social Facebook.

Në këtë mbledhje vlerësuese, na nderoi prezenca e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili iu drejtua të pranishmëve me fjalë rasti. Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në fjalën e tij para anëtarëve të pranishëm e çmoi lart punën e Myftinisë së Shkupit, duke thënë se Myftinia e Shkupit, si njëra prej trembëdhjetë myftinive sa ka BFI gjithsej, ka bërë përpjekje të vazhdueshme

që të sjellë një frymë të re, duke e shndërruar Myftininë e Shkupit në një shembull organizimi të jetës fetare në vend.

Në këtë mbledhje vlerësuese, në mënyrë të detajuar prezantuam raportin e aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2020. Nga shumë pika të përmendura, krahas gjendjes së rënduar dhe sfidave që e shoqëruan këtë vit si pasojë e përballjes me pandeminë, u përmendën shumë arritje në veprimtarinë e gjerë të Myftinisë së Shkupit, siç janë: Puna e suksesshme mediatike, mbarështimi i Vakëfit, kontributi për rregullimin e statusit të nëpunësve fetarë, ndjekja e mësimbesimit

nëpër mejtepet tona dhe shumë aktivitete të tjera. Krahas raportit, u paraqit edhe Plani strategjik afatshkurtër i vitit 2021.

Pas një diskutimi të hapur dhe shkëmbimi të mendimeve mbi Raportin 2020 dhe planin vjetor për vitin 2021, të njëjtat u miratuan unanimitisht nga ana e të gjithë anëtarëve të pranishëm.

Pa dyshim se suksesi nuk arrihet vetë, por vetëm me punë serioze e bashkëpunim mund t'i arrijmë synimet tona për të qenë në shërbim të besimtarëve.

Mbi të gjitha, i lutem Allahut fuqplotë që ta pranojë punën tonë - ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit Qenan ef. Ismaili.

OH "HILAL" DHE EVN NDAJNË NDIHMA NË SHKUP

Në koordinim me Myftininë e BFI-Shkup, organizata humanitare e Bashkësisë Fetare Islame "Hilal", në bashkëpunim me kompaninë EVN-Maqedoni, shpërndanë 100 paketa për familjet në nevojë në territorin e Myftinisë së Shkupit.

Me këtë rast, kryetari i OH "Hilal", h. Fadil ef. Ramadani, për mediat tha se qëndrimi në krah të nevojtarëve është

prioritet i kësaj organizate dhe në veprimtarinë e tij ai do të ketë kënaqësinë që të zbatohet planin e përgjithshëm të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe organizata e BFI-së të jetë, kështu, vazhdimisht strehë për të gjithë nevojtarët e shtetit.

Zëdhënësjja e EVN Maqedoni, znj. Vjosa Selimi, përmendi se ky donacion është pjesë e projektit të madh vjetor që

EVN e organizon në gjithë Maqedoninë e Veriut dhe si i tillë do të vazhdojë edhe vitet e tjera, për të dëshmuar kështu solidaritetin e kësaj kompanie me të gjithë njerëzit në nevojë.

Paketat u pranuan nga disa imamë dhe këshillat e xhamive të Myftinisë së Shkupit, prej ku do mund t'i marrin të gjitha familjet në nevojë, thuhet në njoftimin e BFI-së. (22.12.2020)

“PRANË XHEMATIT...” NË SH TIP E STRUMICË

Më 25 dhjetor, 2020, Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në kuadër të projektit të tij javor “Pranë xhematit...”, ka vizituar Myftininë e BFI-Shtip dhe të Maqedonisë lindore, thuhet në njoftimin e BFI-së.

I shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i BFI të RMV, anëtarë të Rijasetit dhe disa hoxxhallarë, ai vizitoi Myftininë e BFI-së në Shtip dhe Myftiun e saj, mr. Nasir ef. Rexhepi.

Në suaza të vizitës, u vizituan Shtipi, Radovishi dhe Strumica. Të gjithë mysafirët, me në krye, Reis'ul-Ulemanë, u shpërndanë nëpër xhami të ndryshme të qytetit dhe të fshatrave të Myftinisë së Shtipit: Reis'ul-Ulema Shaqir ef. Fetahu - Xhamia Muhamed Nurul Arabi, Strumicë; Sekretari i Përgjithshëm Irsal ef. Jakupi - Xhamia Muhammed Nurul Arabi, Strumicë; Drejtori për Diasporë pranë BFI prof. dr. Selver ef. Xhemaili - Xhamia Bilbil në Radovish; Referenti në Myftininë e BFI-Gostivar, h. Mallzim ef. Zendeli - Xhamia e f. Bansko, Strumicë; teologu nga Tetova mr. Fejzullah ef. Sadiki - xhamia “Jeni Xhami”, Radovish.

Agjenda e ditës parashihte pritjen e Reis'ul-Ulemasë nga Myftiu i Shtipit, vizitën Myftinisë dhe Paraleles së Shtrirë të Medresesë në Shtip dhe takimin me xhematin në namazin e xhumasë.

Pjesë e kësaj vizite ishte edhe vizita e



tre vakëfeve, për të cilat ka konteste dhe BFI tenton t'i zgjidh përfundimisht: “Orta Xhamia”, Strumicë; Xhamia e Husamedin Pashës në Shtip; dhe Varrezat e Vjetra në Strumicë.

Pas namazit të xhumasë u vizituan të tri vakëfet dhe u zhvillua një takim mes Reis'ul-Ulemasë dhe Drejtorit të Muzeut në Strumicë. Pas kësaj, Reis'ul-Ulemaja me shoqëruesit vizituan hapësirat e

SHMI “Medreseja Isa Beu” – Paralelja e Shtrirë e Djemve në Shtip, ku u mirëpritën nga Myftiu mr. Nasir ef. Rexhepi, Drejtori i Përgjithshëm i Medresesë, prof. Ibrahim ef. Idrizi dhe profesorët.

Pas takimit, që të tre dhanë një deklaratë të përbashkët për media. Në fund, mysafirët hëngrën një darkë të përbashkët në kuzhinën e Medresesë. (25.12.2020)

VAKËFI ËSHTË AMANETI YNË

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në kuadër të vizitës në Maqedoninë lindore, takohet me z. Ace Maninski, drejtor i Muzeut të Strumicës. Vizita kishte paraparë shikimin e tri vakëfeve, për të cilat ka konteste të hapura dhe Bashkësia Fetare Islame me në krye Reis'ul-Ulemanë ka për qëllim që, me ndihmën e Allahut, t'i zgjidh njëherë e përgjithmonë.

“Orta Xhamia” është një xhami jashtëzakonisht e bukur në Strumicë, e ndërtuar në shekullin XVII, për të cilën ka kontest dhe ende nuk ka kaluar në pronësi të BFI-së. Për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, kubeja e Xhamisë ka çarje të mëdha dhe në mungesë të in-

tervenimit, rrezikon edhe shembjen. Bashkësia Fetare Islame dha pajtimin që të iniciohen menjëherë projektet e sanimit të Xhamisë, si hap i parë, e pastaj të merret vendimi për rindërtimin e plotë dhe kthimin e hijeshisë së kësaj xhamie.

Drejtori i Muzeut të Strumicës, Ace Maninski, e informoi Reis'ul-Ulemanë për gjendjen e Xhamisë dhe shfaqti gatishmëri për zgjidhjen e këtij problemi.

“Varrezat e Vjetra” në Strumicë janë po ashtu vakëf, statusi i të cilit shpresojmë të zgjidhet shumë shpejt. Kryetari i BFI-së ishte edhe aty dhe e vizitoi personalisht vendin.

Xhamia e “Husamedin Pashës” në Shtip, xhami e ndërtuar në shekullin XVI

- perlë arkitekturore dhe vlerë jashtëzakonisht e madhe islame dhe kulturore për të gjithë shoqërinë, është vakëfi i tretë që u vizitua dhe për të cilin është duke u punuar intensivisht për të gjetur një zgjidhje.

Vakëfi është amaneti ynë, atë do ta mbrojmë dhe do ta zhvillojmë në bashkëpunim me të gjithë faktorët relevantë në vend.

Bashkësia Fetare Islame falënderon publikisht të gjithë individët dhe institucionet që shprehin gatishmëri dhe ndihmojnë që e drejta e myslimanëve të kthehet ku duhet, thuhet në njoftimin e BFI-së. (25.12.2020)

FILLON RINDËRTIMI I XHAMISË “HAXHI HAJREDINI”

Më 2 janar, 2021, në prani të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në koordinim të Myftiut të Myftinisë së BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili, u hodh gurthemeli i rindërtimit të xhamisë “Haxhi Hajredini” në lagjen Seravë të Komunës së Çairit, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Ceremoninë e nderuan me pjesëmarrjen e tyre Kryetari i Grupit Parlamentar të BDI-së në Kuvendin e RMV, deputeti z. Izet Mexhiti, Kryetari i Komunës së Çairit z. Visar Ganiu, Sekretari i Përgjithshëm i BFI të RMV, h. Irsal ef. Jakupi, Myftiu i Myftinisë së BFI-Dibër, h. Reshat ef. Kaçallniku, Kryetari i OH “Hilal” h. Fadil ef. Ramadani dhe një numër i konsiderueshëm i xhematit.

Manifestimi filloi me një pjesë nga Kurani fisnik, lexuar nga Bexhet ef. Dernjani.

Pas leximit para të pranishmëve u paraqit me një fjalë përshëndetëse Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Me fjalë përshëndetëse të pranishmëve iu drejtua edhe Fatmir Aliu, kryetari i Këshillit të xhamisë. Më pas, tubimin e përshëndeti edhe Kryetari i Komunës së Çairit, z. Visar Ganiu, si dhe deputeti z. Izet Mexhiti.

Fjalën e rastit e mbajti Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i BFI-së, i cili foli për rëndësinë e ndërtimit dhe të rindërtimit të xhamive - një veprimtari kjo tejet e çmuar në ruajtjen e traditës sonë të lashtë fetare. Në fjalën e tij, Reis'ul-Ulemaja, ndër të tjera,



theksoi se kjo nismë vjen si rezultat i imanit në zemrat e secilit që ka kontribuar, duke filluar nga iniciatorët, udhëheqësit që dhanë afirmimin për të nisur ndërtimi dhe realizuesit. Kjo, bazuar në fjalët e Lavdiplotit që thotë: “Xhamitë e Allahut i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zeqatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”

(Teube, 18)

Para përmbylljes së programit, Shefi i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë, Evzal ef. Sinani, lexoi disa ajete kuranore. Duanë e fillimit të punëve e bëri h. Ferid ef. Selimi.

Allahu i shpërbleftë gjithë ata që kontribuojnë në rindërtimin e kësaj xhamie, e cila do të mbetet vlerë e metropolit të Shkupit ndër vite, thuhet në njoftimin e BFI-së.

FALET XHUMAJA NË XHAMINË E KODRËS SË DIELLIT

Më 8 janar, 2021 (e premte), u fal namazi i xhumasë në Xhaminë e Kodrës së Diellit. Kështu do të vazhdojnë edhe xhumatë tjera. Kurse hapja solemne e kësaj xhamie do të bëhet pasi të përfundojnë tërësisht punimet brenda dhe jashtë objektit, ka bërë të ditur Myftinia e Tetovës.

I pranishëm për faljen e namazit të xhumasë ishte Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, bashkë me shumë hoxxhallarë të tjerë. Fillimisht, para faljes së namazit të xhumasë u lexua mukabele nga hfz. Besir ef. Limani dhe referenti

për çështje fetare-arsimor pranë Myftinisë, hfz. Abdurahim ef. Murati. Duanë e hatmeve, jasineve dhe kelime-teuhideve, të kënduara nga xhematë të ndryshëm, e bëri referenti fetar-arsimor mr. Xhemil ef. Memeti.

Pas thirrjes së ezanit nga mr. Xhemil ef. Sadiku, mesazhin e hutbes e bëri Myftiu, i cili falënderoi Allahun fuqplotë, i dërgoi salavate Pejgamberit (a. s.) dhe e luti Allahun (xh. sh.) që donatorët e xhamisë, përkatësisht atyre që kanë vdekur varrin t'ua bëjë një bahçe xheneti, kurse

të gjallëve t'ua japë shëndet, bereqet, muhabet dhe lumturi në jetë dhe të gjithëve të na bashkojë në xhenet.

Po ashtu, Myftiu e luti Allahun e madhërishtëm që sa më shpejt të na shpëtojë nga kjo pandemi, Covid-19, kurse xhematit iu drejtua duke ua rikujtuar që të kenë kujdes në përdorimin e maskave, ruajtjen e distancës dhe dezinfektimin e duarve.

Namazin e xhumasë e fali hfz. Abdurahim ef. Murati, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Tetovës.

NGUSHËLLIME PËR OPINIONISTIN ZEJNI BILALLI

Më 27 dhjetor, 2020, ka ndërruar jetë ish-këshilltari komunal në Komunën e Gostivarit, njëherësh mësimdhës i gjuhës dhe letërsisë shqipe, opinionisti Zejni Bilalli nga Çeçrani i Gostivarit.

Me këtë rast, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, familjes dhe gjithë opinionit i ka drejtur një letër ngushëllimi, në të cilën thuhet:

"U bë për rahmet doajeni i arsimit shqip prof. Zejni Bilalli. Të nderuar miq, kolegë, dashamirë dhe familjarë të profesor Zejniut. Me dhimbje e pranova lajmin e largimit të profesorit nga kjo jetë. Kjo humbje është humbje e madhe jo vetëm për familjen, por humbje për të gjithë ne.

Profesor Zejni Bilalli ishte figurë pikante dhe intelektual i mirëfilltë, me guxim të madh, i cili asnjëherë nuk ishte për fshehjen e të vërtetës. Është nga profesorët tanë të parë që kanë mbaruar albanologjinë në Prishtinë. Ka shërbyer gjithë jetën në SHF "Përparimi" të Çeçranit, në të cilën ka qenë edhe drejtor për rreth dy dekada. Arsimi ishte gjithçka për të, por nuk ishte fusha e vetme ku ai jepte kontribut. Prof. Zejniu ishte aktiv edhe në kauzën shqiptare dhe në organizimin e jetës sociale, në politikë. Për një mandat ai ka qenë këshilltar në Këshillin Komunal të Gostivarit.

Çeçrani, Gostivari, po dhe gjithë shqiptarët, kanë humbur



një njeri të madh. Në emrin tim personal dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame dhe të gjitha institucioneve të saj, i drejtohem familjes, miqve, kolegëve dhe të gjithë shqiptarëve me ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e profesor Zejniut: Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me xhenet!"

KA NDËRRUAR JETË PROF. BAJRUSH EF. AHMETI (1940-2021)

Ka ndërruar jetë Bajrush ef. Ahmeti, ish-profesor shumëvjeçar në medresenë e mesme "Alaudin" në Prishtinë. Bajrush Ahmeti ka qenë i lindur më 1940, në fshatin Orllan, komuna e Podujevës.

Me këtë rast, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i ka drejtuar një telegram ngushëllimi Kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myfti mr. Naim ef. Tërnavë. Në të thuhet:

"Me pikëllim mësuam për ndarjen e profesorit të nderuar Bajrush ef. Ahmeti nga jeta e kësaj bote. Profesor Bajrush Ahmeti ishte një lapidar i arsimit fetar në mbarë nënqiellin tonë. Gjatë gjithë jetës së tij ka kontribuar në edukimin e gjeneratave të mirëfillta të hoxhallarëve dhe intelektualëve. E ndiej veten nga fatlumët që Zoti i ka nderuar të jenë nxënës të profesor Bajrushit. Për plot 5 vjet e kam pasur profesor të Historisë Islame.

Morali dhe sjellja e tij shembullore ishin një joshje e madhe për zemrat e të gjithë nxënësve të Medresesë. Nuk do të harroj asnjëherë orët mësimore, të cilat ai i mbushte me urtësi, me dije e me kulturë. Shpjegimin e materialit mësimor ai e bënte plot zell. Profesori ynë jetoi me nder dhe shërbeu me nder, prandaj Zoti e nderoi që ta japë shpirtin në këtë ditë të bekuar xhumaje (1 janar). Muhamedi (a. s.) na ka mësuar se çdo mysliman që ndërron jetë natën e xhuma, apo ditën e xhuma, Allahu do ta amnistojë nga sprova e ndëshkimit në varr, andaj lutemi që, ashtu siç na i mbushte orët e klasat plot dritë dhe shpirt, dritë t'i bëhet varri e bota tjetër!

Me këtë rast të dhimbshëm, i shpreh ngushëllimet më të sin-



qerta, në emrin tim dhe në emër të të gjithë institucioneve dhe nëpunësve të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, si dhe në emër të të gjithë myslimanëve që përfaqëson ky institucion, familjes dhe të afërmeve, Muftiut të Bashkësisë Islame të Kosovës, mr. Naim ef. Tërnavë, drejtorit të Medresesë Alaudin, mr. Fadil ef. Hasani, dhe të gjithë besimtarëve për humbjen e profesorit tonë dhe lutem që Zoti fuqiplotë ta bëjë prej xhenetlinjve!

Qoftë prej atyre që Zoti u thotë: "O ti shpirt që ke gjetur prehen! Kthehu te Zoti yt i kënaqur me veten dhe i kënaqur Zoti me ty! Hyr ndër robërit e Mi, hyr në xhenetet e Mia!" E Allahut është ajo që e jep, e Tij është ajo që e merr; e çdo gjë tek Ai është me afat të paracaktuar.

Të Allahut jemi dhe tek Ai, doemos, është kthimi" – thuhet në telegramin e ngushëllimit të h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Reis'ul-Ulema i BFI të RMV. (1.01.21)

15 VJET PA HOXHË JAKUP ASIPIN


Nga Evzal Sinani

Para vepres heshtin fjalët! Jakup Asipi lindi në fshatin Sllupčan më 2 shkurt 1951. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, atë të mesëm në Damask të Sirisë, studimet i kreu në Universitetin Al-Az'har të Egjiptit, ndërsa studimet postdiplomike i vazhdoi në Bejrut të Libanit.

Gjatë viteve 1985-1990 punoi si imam në një xhami në Leverkusen të Gjermanisë, ku ka dhënë kontribut të çmueshëm në kultivimin e vlerave fetare, morale, kulturore e kombëtare.

I vetëdijshëm për situatën në trojet tona, në vitin 1990 kthehet në vendlindje për të kontribuar në gjendjen e rëndë të popullatës. Në ligjëratat e tij ishte shumë i përpiktë dhe i guximshëm, kështu që u ka bërë ballë kërcënimeve dhe marrjeve të shumta në pyetje nga ana e policisë vendore.

Në vitin 2001, gjatë luftës në Maqedoni, Jakup Asipi u paraqit si njëri ndër strategët kryesorë në organizimin dhe përkrahjen e luftës, sepse ishte i bindur se vetëm përmes kryengritjes popullore do të ishte në gjendje të arrinte liritë dhe të drejtat e veta.



Pas përfundimit të luftës, në vitin 2003, në zgjedhjet e rregullta të Bashkësisë Islame në Kumanovë, u zgjodh Myfti për komunat Kumanovë dhe Likovë.

Ndërroi jetë më 7 janar 2006, në një aksident rrugor në autostradën Shkup - Kumanovë.

(Autori është Shef i Kabinetit të Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë Veriut)

SHEMBULL PËR TË MIRË

Hoxhë Jakup Asipi, aq sa jetoi, ishte shembull për të mirë se si punohet dhe si veprohet në mesin e shoqërisë. Ai ka dhënë kontribut të çmueshëm në kultivimin e vlerave kombëtare dhe fetare. Ka pasur ndikim të gjerë në të gjitha hapësirat shqiptare, sidomos te rinia.

Në ligjëratat ishte shumë i përpiktë dhe i guximshëm. Ai ka organizuar mbi 5.000 ligjëratat, kontribut ky që e shihet dritën çdo ditë përmes ruajtjes multimediale.

Ai ishte motivues shumë i mirë, sidomos për rininë. Shumë njerëz me nostalgji kujtojnë afërsinë që kishin me hoxhë Jakup Asipin. TS



LUTJE PËR FERIZAJIN: Këtë ka shkruar Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut në faqen e saj zyrtare në Facebook, pas shpërthimit të bombolës së gazit në një qendër tregtare në Ferizaj (Kosovë) më 5 janar, 2021, me ç'rast, siç ka konfirmuar Policia, janë lënduar 42 veta, prej të cilëve 12 më rëndë, 3 prej të cilëve në gjendje kritike...

SI E NJOHA MULLA JAKUP ASIPIN

Ishte rebel ndaj stereotipeve, e refuzonte traditën e deriatëhershme të interpretimit të fesë, e cila në vitet tetëdhjetë ishte në rol defensiv, ishte i pasionuar pas ripërtëritjes së mendimit dhe diskursit fetar, ithtar i denjë dhe i pasionuar për lirinë e kombit shqiptar (ishte pjesëtar i UÇK-së në konfliktin e 2001-shit) dhe kishte dëshirë të jashtëzakonshme për të thyer mitologjitë dhe besëtytnitë që ishin të shenjta në emër të traditës.

**Nga Nehat Ismaili
(Enkas për HeR)**

Unë nuk kam njohur mendimtar dhe imam shqiptar më të guximshëm se hoxhë Jakup Asipi, Allahu e mëshiroftë! Nuk kam njohur komentues të Kuranit fisnik më të zhdërvjelltë, më të sinqertë dhe më inteligjent se Mulla Jakupi. Ai ishte një mendimtar dhe imam me dituri enciklopedike në epokën moderne. Ai nuk kishte përvetësuar ngurtësinë metodologjike në interpretimin e fesë, por ishte shumë fleksibil sa i përket materializimit të ideve të tij dhe konvertimit të tyre në programe praktike dhe vizione politike.

Ishte një intelektual me një nivel të lartë profesionalizmi, e kjo vërehej sidomos gjatë interpretimit të teksteve të Kuranit fisnik, të cilat te njeriu krijojnë ndjesinë sikur lundron nëpër oqeanë. Idetë dhe mendimet e tij ishin cilësore, ndonëse nuk la shumë libra pas vetes shkaku i natyrës së veprimtarisë së tij, por ato që i la ishin me bollëk njohurish, me fjalë të urta, mesazhe, analiza dhe vizione për të ardhmen, të mbështetura mbi forcën e argumenteve dhe provave, mbi forcën e mendimit.

NJË DRITARE E RE

Ishte i larmishëm gjatë ligjëritimit të tij, teksa komentonte Kuranin fisnik, teksa kombinonte midis qetësisë shpirtërore dhe suksesit, midis teorisë dhe praktikës. Ai i drejtohej rinisë shqiptare bashkëkohore duke i thënë: “Ju duhet të lexoni libra cilësorë; e jo me cilësi të lartë të kopertinës e as me cilësi të dobët të mendimit.” Ishte si një dritare e re që jepte shpresë për një të ardhme më të mirë për rininë shqiptare dhe për shqiptarët e provincës myslimane viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar, që për

të gjithë feja ishte një botë e re deri atëherë, shumë pak e njohur përpos disa njohurive elementare të Ilmihalit dhe një grupi të kufizuar që praktikonin faljen e namazit.

Ai fliste për bukurinë e Kuranit, për magjinë e Kuranit, për qartësinë e Kuranit, për ndikimin e Kuranit dhe për larinë e metodave të Kuranit. Të gjitha këto i interpretonte në një gjuhë të bukur, me një stil unik dhe në një formë të mrekullueshme, prej një oratori të rrallë dhe mendjendritur, Zoti e mëshiroftë.

Ai përfitoi nga filozofi dhe mufesiri i madh Fahrudin er-Razi, të cilin e kishte lexuar disa herë me radhë. Dhe, sa herë që e pyesja për ndonjë ajet dhe domethënie të tij, me shumë kënaqësi dhe buzëqeshje karakteristike, duke e tundur kokën, thoshte: “Kështu e ka komentuar Imam Raziu.”

Mulla Jakupi, përpos që e ripërturi mendimin dhe diskursin fetar ndër shqiptarët, ai nuk ishte vetëm një përsëritës i ideve të vjetra, por ato i diskutoi, i futi nën thjerrën e kritikës shkencore, shumë të tilla i refuzoi dhe disa i pranoi. Nga gjërat më të mira që ai i bëri, ishte që ai e kërkoi jetën e Kuranit në tekstet e tij, në stilin e tij. Ai u ndal në çdo tekst, duke i bërë analizë gjuhësore dhe përmbajtësore. Ai me të drejtë mund të llogaritet një mufesir i rrallë ndër shqiptarët, sepse ai nuk përdori gjuhën e juristëve myslimanë, pasi ajo mbart disa kuptime gjuhësore e as që përdori gjuhën e filozofëve modernistë, duke përfshirë vështirësitë dhe misteret që përmban, por më tepër ai përdori gjuhën e poetit dhe bukurinë e gjuhës së popullit dhe kjo ishte ajo që e bëri të veçantë.

GJENI I VËRTETË PËR RININË SHQIPTARE

Kam pasur nderin dhe rastin të bisedoj shpesh herë për tema më komplekse, por

sinqerisht, ai ishte një gjeni i vërtetë, përplot dituri të thella, teza të ndryshme dhe të llojlloshme. Ai kishte një lexim cilësor të librave të besimeve qiellore; leximi i tij nuk ishte konfuz dhe sipërfaqësor, por me një qëndrim prej intelektualit i diskutonte dhe i analizonte tekstet e librave të besimeve qiellore, sepse kishte një metodologji të rreptë shkencore.

Vetëm një besimtar si ai mund ta bëjë këtë krijimtari me argumente të besimit, një njeri i cili dëshironte që rininë shqiptare ta largojë nga bota e dyshimit në botën e bindjes ndaj Zotit dhe dorëzimit ndaj Tij. Ai kishte marrë përsipër vendosmërinë për t'i çliruar shqiptarët nga injoranca, nga ndikimi i ideologjisë komuniste dhe ateiste dhe për t'i çliruar nga varësia e mendimit marksist-leninist.

Prandaj, oratoria e tij ishte e bukur për nga performanca, stili dhe diskursi i tij ishin shumë të fortë për sa i përket koherencës metodologjike. Ishte rebel ndaj stereotipeve, e refuzonte traditën e deriatëhershme të interpretimit të fesë, e cila në vitet tetëdhjetë ishte në rol defensiv, ishte i pasionuar pas ripërtëritjes së mendimit dhe diskursit fetar, ithtar i denjë dhe i pasionuar për lirinë e kombit shqiptar (ishte pjesëtar i UÇK-së në konfliktin e 2001-shit) dhe kishte dëshirë të jashtëzakonshme për të thyer mitologjitë dhe besëtytnitë që ishin të shenjta në emër të traditës.

Ai nuk dorëzohej lehtë dhe nuk i pëlqente të jetë si të tjerët, sepse ishte unik në ide, në veprimtari dhe metodologji dhe si i tillë edhe ia dorëzoi shpirtin Zotit të plotfuqishëm.

Rahmet pastë shpirti Yt, Hoxhë Jakup Asipi! /7.01.2021/

(Autori është imam në Xhaminë e Bardhë në Aarburg të Zvicrës)

TRE MUAJT E MIRË (REXHEP, SHABAN, RAMAZAN)

Gjatë tyre, tek shikon dritat që depërtojnë nëpër zemrat e njerëzve, vezullimet e minareve, gjallërinë shpirtërore të popullit që shpejton për në faltore, më tepër sesa jetën tokësore, të kujton parajsën dhe për ata njerëz që vërtet ua dinë vlerën, ofrohet një kënaqësi shpirtërore e paparë.

**Shkruan: Dorian Demetja
(Enkas për HeR)**

Koha dhe vendi, të gjitha, vlerën dhe shenjtërinë e tyre e marrin sepse ashtu dëshiron Allahu. Kjo dëshirë hyjnore përfshin mijëra urtësi për krijesat. Veçanërisht, ato ngjarje që ndodhin brenda asaj kohe dhe vendi fitojnë një rëndësi të veçantë. Shenjtëria e disa aspekteve të kohës në Islam është një mënyrë që begatia dhe mirësia e pafund e Zotit të mbërrijë te myslimanët.

Sipas kalendarit hënor, që ka si pikënisje hixhretin e profetit Muhamed (a. s.) muajt Rexhep, Shaban dhe Ramazan (hixhri) janë muaj shumë të dobishëm dhe të bekuar. Në shoqërinë islame këta muaj quhen “Shuhur-u Thelathe” (Tre Muajt). Të gjitha netët e mira, veç Natës së Mevludit, ndodhen brenda këtyre tre muajve. Muaji Rexhep cilësohet si muaj i mbjelljes, muaji Shaban si muaj i ujitjes dhe muaji Ramazan si muaj i korrjes, apo mbledhjes së prodhimeve. Njeriu korr ç’ka mbjell; merr barasvlerësen e asaj që ka bërë. Tre Muajt kanë një shije të vetën, e cila i veçon ata nga muajt tjerë. Secili nga muajt ndjehet me ndjenjat tona të dukshme, ndërsa këta të tre ndjehen me zemër dhe me ndjenja mjaft të thella. Brenda kësaj kohe njerëzit, që i kthehen botës së zemrës, preken shpirtërisht nga rrezet që burojnë nga besimi i tyre dhe u duket se në këtë gjendje ata do të jetojnë përgjithmonë në hare. Ditët, netët, madje dhe orët e minutat gjatë kësaj kohe për ta ecin në një formë të magjishme. E, ashtu duke rrjedhur, pa dyshim që secilit i pëshpërijnë diçka në shpirt.

BOJËRAT E BOTËS SË PËRTEJME

Kur mbërrimë çdo vit në këto kohë të arta të vitit, na duket sikur kemi prekur ato ditë të kaltra të botës së përtejme edhe një herë tjetër. Koha gjatë këtyre muajve ngjyrosët me bojërat e botës së përtejme dhe njerëzit zhyten thellë në qetësi shpirtërore të magjishme, sikur të ishin banorë të botës tjetër. Kujtimet dhe koha e kaluar



gjatë këtyre tre muajve, plot gjallëri dhe gëzim, na e veshin jetën tonë me një bukurie të magjishme dhe ndjenjat tona futen brenda një simfonie të qetë. Ajo kohë përfaqon të gjithë ata që ndjejnë dhe kuptojnë besimin, Islamin, faltoren dhe adhurimin me ngjyrën e dritave në frekuenca të ndryshme, me flladin e saj të ëmbël dhe të butë, duke magjepsur me zërin e saj çdokënd në shpirt. Gjatë tyre, tek shikon dritat që depërtojnë nëpër zemrat e njerëzve, vezullimet e minareve, gjallërinë shpirtërore të popullit që shpejton për në faltore, më tepër sesa jetën tokësore, të kujton parajsën dhe për ata njerëz që vërtet ua dinë vlerën, ofrohet një kënaqësi shpirtërore e paparë.

Muaji Rexhep është muaj i faljes, i amnistisë nga Allahu; muaji Shaban është muaj i shefaatit, ndërmjetësimi për falje; muaji Ramazan është muaj i shtimit të mirësive. Për këtë qëllim Pejgamberi ynë (a. s.) në fillim të muajit Rexhep lutej kështu: “Allahu im! Na i bëj të bekuara Rexhepin dhe Shabanin dhe na bashko me muajin e Ramazanit.” (Ahmed, I, 259) Ndërkaq, në disa thënie të tjera të tij thuhet: “Ai që agjëron ditën e parë, të mesit dhe të fundit të muajit Rexhep, shpërblehet sikur ka mbajtur me agjërim të gjithë muajin.” (Miftahu'l-Xhene) “Rexhepi është një muaj i madh. Të mirat në këtë muaj Allahu i shumëfishon.” (Taberani)

Pas muajit të Rexhepit vjen muaji i Shabanit. Hz. Aishe (r. a.) thotë: “Nuk e kam parë të dërguarin e Allahut të mbajë më shumë agjërim se sa në muajin e Shabanit.” (Muslim, Sijam, 175) “Muaji Shaban i pastron gjynahet” (Axhluni, Keshfu'l-Hafa, 2/9)

Transmetohet nga Enes b. Malik se Pejgamberi (a. s.) pyetet: O i dërguar i Allahut! Në cilin muaj është agjërimi më i

mirë, përveç Ramazanit? Pejgamberi përgjigjet: “Për nder dhe respekt të Ramazanit është agjërimi i mbajtur në muajin Shaban.” (Tirmidhi, Zeqatë, 28) I dërguari i Allahut në një hadith thotë: “Muaji Rexhep është i Allahut të lartë, muaji Shaban është imi, kurse muaji Ramazan është i ymetit tim.” (Ramudhu'l-ehadith, I, 289; Axhluni, Keshfu'l-Hafa, 1/423)

Dijetari i madh dhe i shquar Bediuzaman Said Nursi për këta muaj thotë: “Shpërblimi i çdo të mire, nëse në kohë të tjera është dhjetë, në muajin Rexhep është njëqind, në muajin Shaban më shumë se treqind, në Ramazan ngjitet në një mijë, në netët e Xhumave shkon me mijëra dhe në Natën e Kadrit ngjitet në tridhjetë mijë.” (Said Nursi, Şualar, 416)

PENDIM PËR MËKATET

Gjatë këtyre muajve myslimanët pendohen për mëkatet, zemërimeve dhe mërive u jepen fund, ndjenjat vëllazërore zhvillohen më tej. Kështu, myslimanët bëjnë përpjekje për të hyrë me mendime të mira dhe me kënaqësi në muajin e bekuar të Ramazanit.

Profeti ynë (a. s.) dhe sahabët punonin shumë për të kapur mirësitë e këtyre tre muajve. E shtonin shumë më tepër adhurimin me nafile (namaze shtesë), e shtonin shumë dhikrin (përkujtimin), tesbihun (lartësimin), hamdin dhe shukrin (falënderimin) ndaj Allahut (xh. sh.); kërkonin falje, ndihmonin të varfërit, gëzonin jetimët, të vetmuarit dhe të moshuarit. Gjatë muajve Rexhep dhe Shaban u kushtonin vëmendje agjëritimit të ditëve të hëna dhe të enjte. Theksojmë se agjërimi i mbajtur në muajt Rexhep dhe Shaban është sunnet.

(Autori është Drejtor i Drejtorisë së Kulturës së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Tiranë)

MUAJT E DALLUAR...

Zoti juaj ka thënë: "Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehenem." (El-Gafir, 61)

Nga bujaria e Zotit të madhërishtëm është se kur Ai sheh se dikush nga robërit e Tij mundohet dhe angazhohet për të mirë, e dallon dhe e afron pranë Vetes. E do Ai dhe i porositi edhe Engjëjt e Tij që ta duan atë. Ai e pajisi me mendje dhe e vlerësoi aq shumë krijesën e quajtur njeri, sa që i dha një rol jashtëzakonisht të veçantë - atë të mëkëmbësisë të Tij në Tokë.

Ia mësoi njeriut të gjitha emrat e sendeve dhe se si duhet t'i menaxhojë ato, por dhe se si të jetë falënderues dhe mirënjohës për pozicionin që ka ai në këtë botë. E mësoi se si të lutet kur të lutet dhe me çfarë t'i lutet Zotit të lartësuar.

Ai përmes Kuranit famëlartë dhe Pejgamberit (a. s.) ia tregoi vlerën e disa vendeve, disa muajve, disa ditëve dhe netëve që janë të dalluara, me qëllim që njeriu besimtar ta shtojë adhurimin ndaj Allahut fuqiptotë.

Në Islam janë të dalluara disa muaj dhe net; jo për nga kohëzgjatja, por për nga vlera që kanë.

Muajt e dalluar janë: muaji Rexheb, Shaban dhe muaji Ramadan (Ramazan). Thotë Pejgamberi (a. s.): „Lutjet që bëhen në këto pesë net nuk refuzohen: Nata e Regaibit, nata e pesëmbëdhjetë e muajit Shaban, nata e Xhumasë, nata e Fitër-Bajramit dhe ajo e Kurban –Bajramit." (Ibn Asakir).

Kur hynte muaji Rexheb, Pejgamberi (a. s.) lutej: „O Zot, na beko në muajin Rexheb dhe Shaban dhe na e mundëso ta arrijmë muajin e bekuar Ramazan." (Ahmedi)

REGAIBI, INFORMIM PËR BESIMTARËT

Njëra nga netët e bekuara në Islam është Nata e Regaibit. Regaib është shu-

mësi i fjalës Ragibe, që ka kuptimin si: nata e faljes, e dhuntive, e shpërblimit, nata e kryerjes së punëve të mira dhe e largimit nga ato të ligat. Sipas kalendarit islam (llogaritjes hënore), kjo natë e bekuar është nata e xhumasë së parë të muajit Rexheb.

Vlera e kësaj nate është e madhe, sepse është paralajmërim për hyrjen në Tre muajt e mëdhenj Rexheb, Shaban dhe mbretit të muajve të vitit, muajit Ramazan. Kjo natë është informim për besimtarët që të fillojnë përgatitjet në aspektin shpirtëror dhe psikologjik për pritjen e muajit të devotshmërisë, Ramazanit.

Thuhet se në këtë natë hz. Amineja ndjeu se është me barrë dhe se Zoti fuqiptotë do ta bekojë atë dhe mbarë njerëzimin me lindjen e Muhamed mustafasë (a. s.).

Pejgamberi (a. s.) i vlerësoi shumë këto net, duke e shtuar adhurimin dhe lutjet ndaj Krijuesit të gjithësisë dhe këtë e la porosi edhe për ne si pasues të tij, sepse këto net të bekuara janë një mundësi e artë që të përfitojmë sa më shumë sevape.

ÇKA DUHET TË BËJMË NË KËTO NET TË BEKUARA?

Nuk ka ndonjë namaz të veçantë enkas për këto net. Ne si besimtarë mund të falim namaze të mbetura (kada) apo namaze vullnetare (nafile). Të lexojmë Kuran, salavate për Pejgamberi (a. s.), të japim lëmoshë, të pendohe mi për mëkatet tona dhe shumë lutje tjera të ndryshme.

Një nga nga ngjarjet e shënuara në Islam dhe që bie në muajin Rexheb është Israja dhe Miraxhi - udhëtimi horizontal i Pejgamberit (a. s.) me Xhibrilin (a. s.) në një pjesë të natës nga Mesxhidul Harami në Mekë, deri në Mesxhidul Aksa në Jerusalem. Pastaj udhëtoi vertikalisht,

drejt hapësirave qiellore, me ç'rast vizitoi shtatë kate qiej, duke takuar shumë prej Profetëve (a. s.). Ai udhëtoi deri në ato hapësira ku edhe Xhibrili (a. s.) e kishte të pamundur të ngjitet. Ky nder iu dha Muhamed mustafasë (a. s.).

Kjo natë ka vlerë të veçantë, sepse derisa ishte në qiell Pejgamberi (a. s.), u bë obligim namazi për ne. Tha Pejgamberi (a. s.): „Namazi është Miraxh i besimtarit."

Vlera e muajit Shaban është po ashtu e madhe. Pejgamberi (a. s.) thotë: „Ky është muaji të cilin njerëzit e kanë lënë në harresë, edhe pse është në mes të muajve të bekuar Rexheb dhe Ramadan. Në këtë muaj i shkojnë veprat tona Allahut të madhërishtëm e unë dua që veprat e mia të dalin para Tij duke qenë agjërueshëm." (Nesaiu, Ahmedi dhe Ebu Davudi)

Po ashtu, në disa thënie Pejgamberi (a. s.) na tregoi vlerën që kanë këta muaj. „Muaji Rexheb është muaji i Allahut, muaji Shaban është muaji im dhe Ramazani është muaji i ummeti tim.

Muaji Rexheb llogaritet si muaji i faljes, amnistimit; muaji Shaban si muaj i ndërmjetësimit (shefaatit), ndërsa muaji Ramazan si muaj i bekimit, i shtimit të mirësive. Muaji Rexheb është muaji i shtatë, i cili cilësohet si muaji i mbjelljes; muaji Shaban është muaji i tetë dhe cilësohet si muaj i ujitjes; ndërsa Ramazani është muaji i nëntë dhe cilësohet si muaj i korrijës së bereqetit".

RAMAZANI, MBRETI I MUAJVE TË VITIT

Në muajin Shaban është nata e madhe e Beratit, natë të cilën Pejgamberi (a. s.) e ka vlerësuar shumë dhe ajo duhet të kalohet me lutje dhe me agjërim; kështu

që, është mirë të agjërohet kjo ditë.

Muaji Ramazan është mbreti i muajve të vitit. Çdo adhurim që bëhet në këtë muaj është me vlerë të jashtëzakonshme dhe shpërblehet pafundësisht. Në një Hadith Kudsij Allahu fuqiptotë thotë:

„Agjërimi është për Mua dhe Unë e shpërblej agjëruesin." Në këtë muaj, përveç adhurimit dhe lutjeve, edhe gjumin kur e bën agjëruesi përfiton sevape.

Vlerën më të madhe që e ka ky muaj është sepse në të u shpall Kurani famëlartë, ndërsa fillimi i zbritjes së tij ishte në Natën e Bekuar të Kadrit. Nata e Kadrit është natë e përcaktimeve, sepse gjithçka përcaktohet për fatin tonë.

Thotë Pejgamberi (a. s.): „Atij që e adhuron Zotin këtë natë, duke shpresuar në shpërblimin e Tij, i falen të gjitha gjynahet." Është natë ku çdo gjë shpërble-

het me qindra herë më shumë. Zoti fuqiptotë në Kuran e ka vlerësuar si më të vlefshme se një mijë muaj. Dy reqqate të falura në Natën e Kadrit llogariten sikur je falur 83 vjet namaz vullnetar. Një sadaka e rëndomtë llogaritet sikur ke dhënë 83 vjet diçka të tillë. Lutjen të cilën Pejgamberi (a. s.) ia mësoi bashkëshortes së tij, hz. Aishes, që ta thotë në Natën Kadrit, është: „O Zot, Ti je falës; e do faljen, më fal mua."

Shumë prej netëve të bekuara janë në këta tre muajt të shenjtë: Rexheb, Shaban dhe Ramazan.

Porosia jonë është që mos t'i lëmë në harresë këta muaj dhe këto net të bekuara, por t'i shfrytëzojmë në maksimum, nëse duam të përfitojmë mbarësi e të mira nga Zoti fuqiptotë dhe gjithashtu të na falen mëkatet që kemi bërë brenda vitit.

Sipas kalendarit të këtij viti, 2021, netët e shënuara janë në këto data:

Hyryra në Tre muajt e bekuar: 13 shkurt 2021;

Nata e Regaibit, 18 shkurt 2021;
Nata e Israsë dhe Miraxhit, 10 mars 2021;

Nata e Beratit, 27 mars 2021;
Teravia e parë, 12 prill 2021;
Nata e Kadrit, 8 maj 2021;
Fitër-Bajrami, 13 maj 2021.

Lusim Zotin e lartësuar që të na japë shëndet e mbarësi në familjet tona. Le të përgatitemi shpirtërisht për hyrjen në Tre muajt e bekuar dhe ishallah kemi jetë që ta presim muajin e shenjtë të Ramazanit.

**Menderez Alili,
Imam, Austri**



Hfz. Evzal ef. Sinani, Shef i Kabinetit të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 15 janar, 2021, ka mbajtur ligjëratën e xhumasë "Ti ke nevojë për Zotin, tani!" në Xhaminë e Sahat-Kullës në Dibër. "Ngela pa fjalë nga mikpritja, nga respekti dhe ambienti shumë i ngrohtë. Dua të falënderoj për zemërsisht xhematin e mrekullueshëm, Myftiun e nderuar të Dibërës, h. Reshat ef. Kaçallniku, vëllain e nderuar prof. dr. Kujtim Mirzo, myezinin e Xhamisë, zëmbllin Cenka Mirzo dhe sebepliuin, vëlla Liridon Papraniku. Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë dhe i bekoftë në dy jetët", ka shkruar ai në Facebook.



PAGUXIMI DHE KOPRRACIA

(AR. EL XHUBNU VEL BUHLU)



Shkruan: prof. Jusuf Zimeri

Në hadithin e transmetuar nga Enes ibni Maliki (r. a.) është thënë: I kam shërbyer (i kam bërë hyzmet) të dërguarit të Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-leme] dhe shpeshherë e dëgjoja teksa ai e shtonte thënien: “O Zoti im, kërkoi ndihmën tënde të më mbrosh nga shqetësimi dhe derti, kërkoi mbrojtjen Tënde të më mbrosh nga pamundësia dhe dembelizmi, kërkoi ndihmën Tënde të më mbrosh nga paguximi dhe koprracia.” (Buhariu)

PAGUXIMI

Paguximi dhe koprracia janë dytribute të cilat nëse e shoqërojnë njeriun, shkaktojnë shqetësime te besimtari islam - qoftë si individ, apo si shoqëri: e ulin standardin e lartë të mirësjelljes dhe të karakterit të besimtarit islam. Paguximi, që në terminologjinë e jurisprudencës islame njihet me nocionin “el xhubnu”, siç e definon Fejruz Abadi, është dobësi e zemrës për ta bërë një veprim që detyrimisht duhet të bëhet. Prandaj, si të tillë, Pejgamberi (a. s.) është lutur dhe njëkohësisht na ka mësuar edhe neve që të lutemi në vazhdimësi, apo siç thotë vetë Pejgamberi (a. s.) *pas çdo namazi*, që të na mbrojnë nga kjo cilësi siç është paguximi.

Vlerësohet kështu, ngase guximi i mundëson njeriut që të ketë dinjitet të lartë dhe të mbajë standarde të fuqishme në jetën e përditshme. Guximi, sipas parimeve të shariatit islam, është parimor dhe bazë për realizimin e qëllimeve të larta dhe të shenjta me të cilat është ngarkuar njeriu si krijesë më e përsosur. Guximi si forcë e brendshme e njeriut që buron nga kuraja e shpirtit dhe e besimit, i mundëson njeriut që ta shtyp hidhërimin e tij, ta shtyp egon e tij. Vlerësohet kështu ngase guximi siguron një fuqi stabiliteti të brendshme te njeriu. Prandaj, Pejgamberi (a. s.) kur e definoi këtë forcë të brendshme, e definoi duke thënë: “*I fuqishëm*

nuk është ai i cili mposht të tjerët fizikisht, por i guximshëm është ai i cili përmbahet dhe e kontrollon veten e tij në momentet kur hidhërohet.”

Në hadithin që e transmeton Ebu Hurejreja (r. a.) thuhet: E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut (s.a.v.s.) duke thënë: “*më e keqja që është te njeriu është koprracia e alarmuar* (koprracia e cila e pengon njeriun që të kryejë edhe obligimet e tij, të cilat i ka si obligim ndaj shoqërisë) *dhe frika* (paguximi) *i tepruar* (që e bën personin si me i dalë zemra nga vendi).”

Kadi Ijadi në veprën e tij “Ikmalul maalim bi fevaiddil muslim”, duke iu referuar hadithit të Pejgamberit (a. s.) thotë se Pejgamberi (a. s.) na mësoi si duhet të kërkojmë ndihmë nga Allahu (xh. sh.), që të na mbrojnë nga paguximi dhe koprracia, të na japë guximin për të kryer detyrimet tona, për të realizuar dhe mbrojtur të drejtat tona, për ta thënë të vërtetën, për të ndihmuar ata që janë të shtypur dhe për t’u përballur me zullumqarët e kriminelët, pavarësisht të cilës natyrë janë ata; për ta luftuar të keqen dhe padrejtësinë.

Shumë dijetarë islamë kanë folur për cilësinë e paguximit dhe kanë radhitur edhe pasojat e kësaj cilësie në shoqërinë islame. Nga pasojat e mosguximit, dijetarët islamë kanë radhitur:

Paguximi është cilësi e hipokritëve; prej së cilës cilësi besimtari islam e ka për detyrë të lirohet menjëherë. Vlerësohet kështu, ngase njeriu i paguximshëm, shpeshherë për shkak të frikës së tij, miraton veprime apo ide të cilat e dinë se janë të dëmshme, por shkak i paguximit për ta thënë të vërtetën, pajtohet me të pavërtetën dhe kjo është shenjë e hipokrizisë.

Paguximi është simptomë e dobësitimit të besimit tek Allahu Një, sepse në mungesë të besimit, ai frikësohet nga faktorë të tjerë, të cilët mund ta dëmtojnë dhe e harron ajetin kuranor që thotë: “**Kurrë nuk mund të ndodhë me ne diç tjetër,**

përveç asaj që ka përcaktuar Allahu (xh. sh.) për ne; Ai është Mbikëqyrësi ynë dhe vetëm Allahut duhet t’i mbështeten besimtarët.” (Teuve : 51)

Paguximi ndikon në humbjen dhe reduktimin e kryerjes së obligimeve dhe në përfitimin e të drejtave, ndoshta edhe ato më elementare, të njeriut.

Paguximi mbjell shtrëngim dhe ngushtim të gjoksit, humbjen e rehatisë dhe të qetësisë shpirtërore, po pse jo edhe fizike e psikike, duke humbur shijen e kënaqësisë dhe gëzimit, për shkak të përzjerjes së gjërave.

Paguximi shpie edhe në humbjen e lejjimit e të ndalimeve, apo në ndalimin e lejjimeve, dhe në humbjen e vatanit dhe gjithçka që ndërlihet me të.

Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha këto pasoja dhe shumë të tjera, vërtetohet fakti se i dërguari i Allahut (s.a.v.s.) me plot të drejtë na porositi që pas çdo namazi të kërkojmë ndihmën e Allahut (xh. sh.), që të na ruajë dhe të na largojë nga kjo cilësi e shëmtuar.

Nëse shfletojmë literaturën islame, me theks të veçantë biografinë e Pejgamberit (a. s.) dhe të sahabëve, me lehtësi gjejmë se Pejgamberi (a. s.) në vazhdimësi, jo vetëm në mënyrë teorike, por edhe praktike, ka dëshmuar për guximin si element vendimtar për të nxjerrë të vërtetën dhe të drejtën mbi sipërfaqe. Vetë fillimi i komunikimit të Islamit, në ato kushte dhe rrethana të pafavorshme, janë argument për guximin e Pejgamberit (a. s.), për vendosmërinë e tij, për të bërë ndryshime, fillimisht - në çështjet e besimit dhe, për rrjedhojë, edhe ndryshime sociale, shoqërore, ekonomike, morale etj.

KOPRRACIA

Koprracia është një tjetër cilësi, për të cilën Pejgamberi (a. s.) na mësoi se duhet kërkuar ndihmën e Allahut (xh. sh.) për t’u mbrojtur nga kjo veti e shëmtuar. Koprracia, e cila në terminologjinë islame njihet me nocionin “el buhlu”, është veti

që sjell pasoja të rënda si tek individ, ashtu edhe në shoqërinë njerëzore; si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në jetën e botës tjetër. Prandaj, edhe Kurani famëlartë koprracinë në forma të ndryshme e përmend shtatë herë, në gjashtë sure të Kuranit famëlartë. Me nocionin *koprraci* në terminologjinë e shariatit islam nënkuptojmë të kundërtën e fisnikërisë.

Koprracia nuk mund të jetë asnjëherë cilësi e pranuar te besimtari i mirë, sepse Pejgamberi (a. s.) në një hadith thotë: “**Dy cilësi nuk mund të gjenden asnjëherë te besimtari islam, që janë: koprracia dhe edukata e keqe.**”

Koprraci përkufizohet si njeri dorëmbullur, dorështrenjtë, i cili nuk ka ndjenja të mjaftueshme të ndihmës dhe të humanizmit. Ai bën përpjekje të grumbullojë sa më shumë pasuri në jetën e tij, gjithnjë duke u ekspozuar si njeri i varfër. Kjo kategori e njerëzve janë të urryer jo vetëm te njerëzit, por edhe tek Allahu (xh. sh.). Këta nuk shprehin gatishmëri t’i ndihmojnë të tjerët; bile, as familjet dhe të afërmit e tyre, saqë shkojnë deri në atë shkallë sa, nga frika e tyre e thellë se do t’u pakësohet pasuria, ata nuk janë të gat-

shëm të paguajnë as obligimet materiale, siç janë zeqati, sadakaja etj. Për këtë kategori të njerëzve Allahu (xh. sh.) në Kurandin famëlartë thotë:

“**Ata të cilët bëjnë koprraci me atë nga të mirat e veta që u dha Allahu, të mos mendojnë kurrësi se ajo është në dobi të tyre. Jo, ajo është në dëm të tyre. Pa dyshim, koprracia do t’u ngarkohet atyre në qafë Ditën e Kiametit. Allahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka, Allahu është i njohur mirë me atë që veproni.**” (Ali Imran : 180)

Në një ajet tjetër, në suren El Hadith, Allahu (xh. sh.) thotë:

Për të mos u dëshpëruar për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë juve, Perëndia nuk i do lavdëruesit dhe vetëmburrësit. Ata që janë koprracë dhe nxisin edhe të tjerët në koprraci. E ata që i shmangen urdhrat. Me të vërtetë, Perëndia është i pavarur (i pasur) dhe i lavdërueshëm. (El Hadid: 23-24)

Në një hadith Pejgamberi (a. s.) thotë: “**Keni frikë padrejtësinë (zullumin), sepse padrejtësia Ditën e Kiametit do të**

paraqitet e shumëfishuar; kini frikë koprracinë, sepse koprracia ka shkatërruar ata që ishin para jush dhe i hodhi në gjakderdhje dhe në lirimim e gjërave të ndaluara.” (Muslimi)

Në një rast të dërguarit të Allahut (xh. sh.) dikush nga sahabët ia përmendi një grua të cilën e lavdëronte se vërtet ajo agjëronte shumë dhe falte shumë namaz, por kishte një mangësi: ishte koprrace. Atëherë Pejgamberi (a. s.) tha: “**E cila është mirësia e saj, pra?!**”

Prandaj, duke marrë parasysh faktin se koprracia si cilësi është diametralisht në kundërshtim me parimet e besimit, të moralit, të fisnikërisë dhe të humanizmit, atëherë me të drejtë Pejgamberi (a. s.), për të mos rënë pre e kësaj cilësie, na mësoi që gjithmonë, pas çdo namazi, t’i lutemi Allahut (xh. sh.) që na mbrojnë nga kjo cilësi e shëmtuar e besimtarit islam.

Për ta përfunduar këtë temë të shkurtër, po e mbyll me thënien e motrës së Omer ibn Abdulazizit (r. a.), e cila ka thënë: “Mjerë për koprracin; sikur koprracia të ishte këmishë, kurrë nuk do ta kisha veshur; e sikur të ishte rrugë, kurrë nuk do të kisha ecur asaj rruge.”



MADHËSHTIA E REKOMANDIMEVE TË PEJGAMBERIT (A. S.)



Sot, kur i gjithë globi, por edhe ne si pjesë e tij, po jetojmë në ankthin e pandemisë globale, e gjithë bota mbarë, institucione dhe ente të ndryshme, në disa vende edhe me ligj, u bëjnë një shërbim të hatashëm, me vetëdije ose pa vetëdije mësimeve të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi vese-l-em], gjë që e dëshmon vërtetësinë e misionit të tij.

Shkruan: Prof. dr. Faredin Ebibi
(Enkas për HeR)

Të zgjedhurit e Krijuesit të gjithësisë ishin të pajisur me kompetenca hyjnore. Secili në epokën e vet ishte i përshtatshëm për të udhëhequr popullin të cilit i ishte dërguar. Kështu, edhe Muhamedi [sal-lallahu alejhi vese-l-em] e kreu misionin e tij për mrekulli, duke lënë gjurmë të pashlyera në historinë mbarënjëzore.

Mësimet praktike të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi vese-l-em] janë frytdhë-

nëse, pjellore dhe plot produktivitet, ashtu që mendësia e shëndoshë përfiton dhe vazhdon të përfitojë nga ky erudit i madh njerëzor.

Përvoja e ndritshme dhe e begatë e Muhamedit [sal-lallahu alejhi vese-l-em] vazhdon të shërbejë si kandil ndriçues për gjenerata të tëra.

Mënyra unike e menaxhimit të proceseve, si në planin e organizimit, të udhëheqjes, edukimit dhe vetëmohimit, ka dëshmuar kapacitetin e tij të jashtëzakonshëm.

Sa i përket planit në menaxhimin e si-

tuatave, në përputhje me urtësinë dhe vigjilencën e tij, ka afruar zgjidhje adekuate, ashtu që shoqërinë islame e ka ruajtur nga ndikimet e mosdijes së të tjerëve. Jo vetëm që e ka siguruar, por ka sjellë prova bindëse duke përfutur nga rezultatet e tyre dështuese në planin e organizimit dhe të ndërtimit të jetës cilësore.

DËSHMOHET VËRTETËSIA E MISIONIT

Sot, kur i gjithë globi, por edhe ne si pjesë e tij, po jetojmë në ankthin e pan-

ISLAMI, ME SHUMË LARMI INTELEKTUALE

Zoti “nuk i ngjan askujt (asgjëje)”, por ka një mënyrë, do të thotë, me të cilën Ai komunikon, ashtu që nuk është e vërtetë në vete, e pakapshme dhe e largët, por e pranishme dhe e afërt. Në fakt, shfaqet e Zotit në Kuran janë të ndryshme. Ato tregojnë në mënyrë të barabartë për transcendençën e Tij (tanzih) dhe imanencën e Tij (tashbih) në raport me botën dhe njeriun.

**Shkruan: Hasan Xhillo
(Enkas për HeR)**

Ilmul-kelami është një disiplinë e rëndësishme islame, e cila paraqitet në shekujt e parë të historisë islame. Bëhet fjalë për një veprimtari origjinale islame, që përfshin më shumë teori teologjike, të cilat shtrihen në drejtime të ndryshme. Me kalimin e kohës, këto teori thellohen, interpretohen me një metodologji të veçantë dhe e kundërshtojnë njëra-tjetrën varësisht nga prirjet shpirtërore të njeriut, nga mënyra e të kuptuarit të ajeteve kuranore dhe nga të kuptuarit e sfidave me të cilat përballesh në më shumë dekada të traditës filozofike-teologjike, e pranishme në rajonet në të cilat shtrihet kultura islame. Këto, pra, do të shndërrohen në diskutime të vërteta teologjike-filozofike shumë të rëndësishme.

Me paraqitjen e ilmul-kelamit formohet edhe terminologjia e parë filozofike-teologjike në gjuhën arabe, sipas së cilës kjo shkencë do të diferencohet nga fikhu, sufizmi dhe filozofia (në kuptimin grek). Ilmul-kelami bazën për debate racionale, mes tjerash, e gjen në problematikën e *usulul-fikhut* (metodologjia e të drejtës së shariatit), të cilën e zhvillojnë Imam Shafiu dhe Ebu Hanifeja, ku edhe përdoret analogjia (*kijasi*) kur shpjegohen aspektet praktike të Sheriatit, si dhe në këndvështrimet e disa shkollave tjera teologjike. Më vonë edhe filozofët nën ndikimin e filozofisë greke e përdorin nocionin *kijas*, por në kuptimin e silogjizmit. Zhvillimi i këtij nocioni do të japë fryte në arritjet e rrepta filozofike të filozofët e frymëzuar nga helenizmi. Në fakt, analogjia bëhet mjet për shpjegimin e marrëdhënieve mes Zotit dhe botës edhe te Toma Akuini në filozofinë skolastike mesjetare, mësi-



met e të cilit Kisha katolike do t'i promovojë në mënyrë zyrtare. Filozofët myslimanë, Farabiu dhe Ibn Sina, përdorin nocionin *vuxhud* (ekzistencë) në kuptimin analogjik. Për shembull: Zoti ekziston, edhe njeriu ekziston; njëri është Qenie e domosdoshme, ndërsa tjetri qenie e mundshme. Në këtë mënyrë, krijohet relacioni mes këtyre dy realiteteve. Analogjia, do të thotë, është tek ekzistenca. Këtu duhet shtuar edhe fakti vijues: nocioni *kijas* ose analogjia paraqitet para ardhjes së kulturës islame në kontakt me trashëgiminë filozofike greke dhe këtu analogjia në fikh konsiderohet si procedurë e rëndësishme racionale, e cila nuk është nën ndikimin e racionalizmit grek.

PËR BESIMIN SI AKT TEORIK

Diskutimet në ilmul-kelamit zhvillohen në mënyrë succesive. Pasi bëhet fjalë për besimin si akt teorik, së pari paraqiten

diskutimet se në çfarë mënyre kjo manifestohet: a thua kjo është çështje e zemrës, e intelektit apo bëhet fjalë për një akt deklarativ. Relacioni i mëkatit dhe besimit, veprat e mira dhe të këqija, statusi i mëkatarit, të parit e Allahut në Ditën e Gjykimit, argumentet për pejgamberinë, çështjet për hilafetin ose imametin, për eskatologjinë, për marrëdhëniet e shpirtit dhe të trupit, për ringjalljen trupore dhe shpirtërore - a thua është kusht që besimi të shoqërohet me vepra të mira, apo kjo është e mjaftueshme vetvetiu; a thua besimi rritet, apo zvogëlohet etj. – të gjitha këto ishin tema qendrore që nga fillimi i mendimit islam. Për këto tema më së shumti diskutonin murxhitë, harixhitë, kaderitë etj.

Meqenëse ilmul-kelami merret me aspektet teorike të strukturës fetare, më saktësisht me besimin dhe mënyrën se si kuptohet (trajtohet) në burimet kryesore islame, nuk do të gabohej nëse do të konfirmohej se historia intelektuale në Islam

demisë globale, e gjithë bota mbarë, institucione dhe ente të ndryshme, në disa vende edhe me ligj, u bëjnë një shërbim të hatashëm, me vetëdije ose pa vetëdije mësimëve të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi vese-l-em], gjë që e dëshmon vërtetësinë e misionit të tij. Kjo gjë që mund të përket në një farë forme që Krijuesi i gjithësisë, kohë pas kohe, krijon rrethana të atilla që mësimet, përkatësisht udhëzimet e Muhamedit [sal-lallahu alejhi vese-l-em] domosdo të jetësohen ose t'i praktikojnë ata që atij ndoshta nuk i besojnë.

Jemi dëshmitarë të apeleve, të thirrjeve, të afishimeve të mediave të shkruara dhe elektronike, të cilët bëjnë thirrje për mbajtjen e higjienës dhe të pastërtisë. Ky proces as që diskutohet, por nuk paraqet diçka të re sa i përket shoqërisë myslimane. Pastërtia për ta është diçka e rëndomtë dhe e zakonshme, ngase është komponent shumë i rëndësishëm, është thelbësor, pa të cilin as që mund të imagjinohet struktura cilësore e besimit të cilit i përkasim.

Në vazhdim të këtij teksti do t'i hedhim një sy porosive shumëdimensionale të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi vese-l-em], për të parë dhe për të mësuar vizionin e tij në shumë sfera të jetës.

Në planin e pastrimit dhe të pastërtisë, ashtu siç ka parashtruar Muslimi në përmbledhjen e vetë, i dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] ka thënë:

“Pastërtia paraqet gjysmën e besimit.”

Sipas hadithit, pastërtia paraqet kulmin e kulturës së një populli. Jo rastësisht Islami këtë element e ka bërë kusht për vlefshmërinë e shumë adhurimeve të tij.

Ky komponent ka vlerë shumë të madhe, pavarësisht nëse bëhet fjalë për pastërti fizike, apo shpirtërore. Në këtë drejtim Sunneti, përkatësisht feja islame, paraqet modelin më unik sa i përket pastrimit dhe pastërtisë. Shumë hadithe flasin për atë se pastërtia e ruan shëndetin, ndikon pozitivisht në zhvillimin fizik, ndikon pozitivisht në ruajtjen e ambientit. Njashtu, kontribuon shumë në parandalimin e sëmundjeve. Duke marrë parasysh këto rrethana, feja islami pastërtisë dhe pastrimit i ka kushtuar vëmendje serioze. Jo rastësisht, literatura e Sunnetit është e stërmbushur me hadithe dhe me libra të shumtë që iu janë përkushtuar pastrimit dhe pastërtisë. Strategjia e Sunnetit kundrejt pastrimit dhe pastërtisë është në harmoni të plotë me direktivat dhe me mësimet e sektorit të shëndetësisë bashkëkohore, sipas të

cilave mbrojtja nga sëmundjet është më e mirë se shërimi prej tyre.

Në këtë relacion, Krijuesi i gjithësisë ka lavdëruar faktin dhe i lartëson ata që janë të pastër dhe që pastrohen. Në Kuran është theksuar:

“Allahu i do ata që pendohen, dhe ata që ruhen (që janë të pastër) prej punëve të ndyta e të neveritshme.” (Kuran, 2:222).

Literatura e Sunnetit ka rezervuar një kënd me porosi dhe me udhëzime për një lloj pastrimi, i cili në terminologji quhet “avdes”.

Hadithet që trajtojnë avdesin, përveç aspektit profesional, janë analizuar dhe studiuar edhe nga aspekti shëndetësor dhe është konstatuar që hunda, respektivisht kanalet e saj, të atyre që marrin avdes, janë shumë më të shëndosha se të atyre që nuk marrin avdes. Siç dihet, pastrimi i gojës dhe i hundës gjatë procesit të marrjes së avdesit është prej sunneteve të Islamit.

SHPELARJA E GOJËS KA SHUMË KUPTIME

Kur bëhet fjalë për avdesin, jo rastësisht edhe pastrimi ose shpëlarja e gojës është pjesë përbërëse e këtij lloj pastrimi. Gjatë procesit të marrjes së avdesit shpëlarja e gojës ka shumë kuptime. Në aspektin fetar, atë që merr avdes avdesi e paralajmëron të ketë kujdes nga fjalët, të ketë kulturë të denjë fetare dhe të mos flasë fjalë që nuk i përkasim myslimanit. Nga ana tjetër, ky veprim shtesë është në funksion të ruajtjes së shëndetit, me efekte mbrojtëse nga infektimet e mundshme.

Meqë jemi tek avdesi, sipas praktikës dhe udhëzimeve të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi vese-l-em] ekzistojnë rregulla të veçanta sa i përket larjes së gojës. Me gishtin tregues të dorës duhet fërkuar ana e majtë e gojës, kurse me gishtin e madh duhet fërkuar ana e djathtë e saj. Në këtë kontekst, i dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] ua rekomandon myslimanëve pastrimin e dhëmbëve me “misvak”. Nuk i përket këtij artikulli të flasë për rolin e “misvakut” në aspektin shëndetësor, për faktin se një trajtim i tillë i takon sektorit kompetent. Ndërkohë, për vlerën e tij në aspektin fetar flasin shumë hadithe. Sa për ilustrim po theksoj që Ibni Maxheh ia ka kushtuar një kaptinë të tërë, në të cilin ka parashtruar disa hadithe që flasin rreth këtij fenomeni. Një nga hadithet e tilla po e theksoj në këtë tekst.

“Po të mos frikësohesha se mos, vallë, po e rëndoj ‘ummetin’ tim, do

t'i urdhëroja ata që ta përdorin ‘misvakun’ për çdo namaz.” (Sahih)

Ajo që bie në sy nga hadithi, shfaqet edhe një vlerë tjetër tejet e rëndësishme: mëshira që kishte i dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] ndaj ummetit të vet; ishte i kujdesshëm për mosngarkimin për tepër me detyrime. Pejgamberi [sal-lallahu alejhi vese-l-em], sipas hadithit, frikësohej mos, vallë, po i rëndonte tepër ndjekësit e tij, deri në atë masë sa ata të mos pajtoheshin me urdhrat e tij. Megjithatë, përdorimi i misvakut vazhdon të ketë statusin e aktit të rekomanduar. Përdorimi i tij nuk është parakusht për vlefshmërinë e avdesit. Sipas hadithit, nëse “misvaku” nuk është përdorur para marrjes së avdesit, rekomandohet i njëjti të përdoret para se të fillojë falja e namazit. Nëse pastrimi i dhëmbëve dhe përdorimi i brushës është vlerë që i përket kulturës kur të zgjohemi nga gjumi, sipas Sunnetit kap vlerë fetare, ndërkohë edhe vlerë shëndetësore dhe vlerë kulturore.

Nga ana tjetër, duart janë prej gjymtyrëve që kanë kontakt më tepër me papastërtitë. Jo rastësisht pastrimi i duarve është pjesë përbërëse e procesit gjatë marrjes së avdesit. Por, jo vetëm me kaq: larja dhe pastrimi i tyre, sipas Sunnetit rekomandohet para dhe pas ngrënies së ushqimit, kur të ngrihem nga gjumi etj. Sipas një hadithi që ka transmetuar Selman Farisiu, i dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] është shprehur:

“Bekimi i ushqimit është në marrje të avdesit para (ngrënies) dhe në avdesin pas ngrënies.”

Sipas studiuesve, me avdesin e theksuar në hadith fjala është për pastrimin ose larjen e duarve para dhe pas ngrënies së ushqimit.

Sipas një hadithi tjetër, të cilin e ka parashtruar Tirmidhiu, të transmetuar nga Ebi Hurejre, i dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] ka thënë:

“Djali vërtet është shumë i ndjeshëm dhe lëpirës, andaj ju kini kujdes për vetet tuaja prej tij. Ai që ka bujtur dhe në dorën e vet ka erë pislleku (ose erë të yndyrës), nëse i ndodh diçka, atëherë të mos e mallkojë (askënd), përveç vetes.”

Në përmblyllje të këtij artikulli vlen të theksohet fakti që gjallëria e haditheve, përkatësisht udhëzimet pejgamberike, vazhdojnë të jenë aktuale si në vend, njashtu edhe në kohë. Të tilla do të mbeten për mot e jetë sa të ekzistojë jeta, për atë se burimi i tyre është i shenjtë - hyjnor.

fillon me debatet e kalamistëve, të cilët, më së pari, ishin të motivuar nga ajetet kuranore për të menduar, vëzhguar, humlumtuar... të cilët e përlëvdojnë urtësinë dhe diturinë. Sipas këndvështrimit kuranor, këto dy nocione paraqesin sinonime. Thëniet e Muhammedit (a. s), gjithashtu, urtësisë dhe diturisë i japin një vend të veçantë në praktikën dhe përvojën fetare dhe këto merren parasysh në kuptimin e tyre tekstual, që nënkupton pikërisht, ibadetin ose përvetësimin e përvojës fetare, apo kënaqësinë, mëshirën dhe dashurinë ndaj Zotit.

Në dallim nga filozofia islame (*el-felsefeh el-Islamije*), e cila është e ndikuar nga tradita greke dhe helenistike, teoritë e ilmul-kelamit nuk janë të ngarkuara me racionalizmin grek, por përfaqësuesit e tyre motivet e veprimtarisë së tyre, së pari, i kërkojnë në formacionet e shpirtit njerëzor, që dalin nga kërshëria e tij, e që në kapjen definitive përfundojnë në mënyrën e të kuptuarit dhe të interpretimit të ajeteve kuranore, nga njëra anë, dhe në debatet e dijetarëve të së drejtës në fushën e aspekteve praktike të Sheriatit - Imamëve në fikh - nga ana tjetër. Megjithatë, më vonë nuk do të shmangen edhe teoritë e caktuara greke, e në veçanti mësimi për atomizmin dhe për qenien e mundshme dhe reale, në mënyrë që të thellohet koncepti i krijimit.

Temat për të cilat diskutohet në ilmul-kelam, me të vërtetë, janë të shumta, siç janë edhe shkollat e shumta të cilat merren me to. Ndonëse temat duket se janë të ndryshme nga njëra-tjetra, megjithatë vërtetimi nga aspekti i brendshëm, ose më i thellë, tregon se ato prezantojnë një tërësi organike, e në veçanti kur bëhet fjalë për bazat e besimit. Mirëpo, për të arritur te ky unitet, më së pari duhet perceptuar mendimet e ndryshme për problemet e caktuara teorike fetare. Të gjitha këto mendime dhe teori të ndryshme janë përfshirë në debatin e konstruktuar sistematik teologjik që do të emërtohet ilmul-kelam. Prandaj, teoritë dhe shkollat e shumta flasin për larminë intelektuale që u zhvillua në historinë islame që nga fillimi i saj.

Periudha e mëvonshme e ilmul-kelamit u shënuar si periudhë filozofike-teologjike. Kategoria thelbësore në të gjitha këto shkolla dhe debate të tyre ishte të kuptuarit e Njësisë së Zotit (*tevhid*). Në të njëjtën kohë, bëhet fjalë edhe për kategorinë më abstrakte edhe në disiplinën e tjera, siç ishte sufizmi dhe filozofia (*felsefeh*). Pa e kuptuar konceptin mbi Njësinë e Zotit nuk mund as të imagjinohet besimi i një muslimani. Arsye për këtë është numri i

madh i ajeteve në Kuran që kanë të bëjnë me këtë çështje. Konceptimi i vërtetë mbi Zotin është supozimi i parë i teologjizimit në ilmul-kelam. Interpretimet e ndryshme të këtij problemi në ilmul-kelam u motivuan, mes tjerash, nga disa ajete kuranore ku flitet për cilësitë e Zotit dhe për relacionin e Tij me botën dhe njeriun. Teoritë u potencuan edhe nga disa mësimet filozofike greke dhe nga trashëgimia teologjike-filozofike e traditës krishtere.

Problem të rëndësishëm, që kërkon interpretim më të thellë, paraqet marrëdhënia e Zotit dhe e botës, dhe marrëdhënia e Zotit dhe njeriut. Në çfarë mënyre të shpjegojmë se Zoti nuk është e vërtetë statike, e që është në anën tjetër të botës dhe të njeriut, dhe njëkohësisht të mos shtrembërojmë faktin se bëhet fjalë për të vërtetën dinamike, për një komunikim të caktuar të Zotit me botën dhe njeriun. Pra, Ai “nuk i ngjan askujt (asgjëje)”, por ka një mënyrë, do të thotë, me të cilën Ai komunikon, ashtu që nuk është e vërtetë në vete, e pakapshme dhe e largët, por e pranishme dhe e afërt. Në fakt, shfaqjet e Zotit në Kuran janë të ndryshme. Ato tregojnë në mënyrë të barabartë për transcendençën e Tij (*tanzih*) dhe imanencën e Tij (*tashbih*) në raport me botën dhe njeriun, dhe kjo kërkonte debate të gjera dhe të thella për cilësitë e Zotit.

KËRKOHEM KONCEPTI I PRANUESHËM RACIONAL

Njëjtë si në Dhiatën e Vjetër, ashtu edhe në Kuran hasim përshkrime të caktuara antropomorfe, që janë në kundërshtim me ajetet në të cilat theksohet transcendenca absolute e Zotit dhe, si të tilla, ato kërkojnë koncept të pranueshëm racional, të bazuar në argumente të cilat, pa dyshim, do të themeloheshin edhe në përgatitjen më të thellë për t'u përballur me sfidat që dalin nga traditat e ndryshme filozofike-teologjike. Relacioni i Zotit me botën imponon gjithashtu teorinë e krijimit - kjo ide revolucionare sipas së cilës religjionet e shpallura, mes tjerash, dallojnë nga filozofia greke dhe nga disa religjione të Lindjes. Koncepti mbi krijimin nënkupton relacionin mes Krijuesit dhe të krijuarës (*halkun* dhe *halikun*). Njëja e Zotit, e botës dhe njeriut, për çka u angazhuan disa tradita filozofike, prishet me aktin e krijimit, me parimin krijues që mund t'i përshkruhet vetëm Zotit. Në këtë mënyrë prishet “blloku ontologjik”, sipas të cilit Zoti, bota dhe njeriu janë një, dhe se nuk ekziston ndarje mes botës fizike dhe asaj metafizike. Tërheqja e dallimit ontologjik mes Zotit dhe botës

është karakteristikë themelore e religjioneve të shpallura - as krijuesi nuk mund të bëhet krijesë, e as krijesa krijues. Parimi krijues është karakteristikë vetëm e Zotit. Ky problem në traditat e religjioneve perceptohet duke vështruar cilësitë e Zotit. Zoti nuk është thjesht një sekret i fshehur - Ai fshihet dhe zbulohet, Ai është i Pari dhe i Fundit, i Dukshëm dhe i Padukshëm. Kjo do të tërheqë debatin në ilmul-kelam edhe për raportet mes Qenies së Zotit dhe cilësive të Tij. Në këtë drejtim, pavarësisht nga numri i pakufishëm i cilësive të Zotit, të cilat nuk reduktohen vetëm në disa sish, dominon koncepti i Njësisë së Zotit (*tevhid*). Por, kjo kërkon të argumentohet me diskutime rigorozë racionale. Këtij argumentimi më vonë do t'i bashkohet të gjithë filozofët me teoritë e tyre, që do të tërhiqen në drejtime të ndryshme. Këtu dominojnë shumë çështje për cilësitë e Zotit, për hyjninë ose realitetin e tyre, për atë se a thua ato janë të përjetshme apo të krijuara, a thua janë brenda esencës ose qenies së Zotit apo, megjithatë, e kanë realitetin e tyre të jashtëm. Cilësia e Zotit *kelam*, që ka të bëjë me Kuranin, nxit diskutimin se a thua Kurani është i krijuar apo i përjetshëm. Në çfarë mënyre “fjala” dhe “dëshira” fituan statusin real. Në çfarë mënyre Kurani, si fjalë e Zotit, që shfaqet në histori ose kohë, rrjedh nga “Pllaka e Ruajtur (*Levhi mahfuz*)” në qiell, në fakt, nga pozicioni i tij para-ekzistues?

Disa shkolla pretendojnë se Zoti ka cilësi, e të tjerat i mohojnë cilësitë e Tij. Qëllimi i të parëve është që të tregojnë se Zoti është koncept dinamik, e jo i zbrazët ose statik. Të tjerët, megjithatë, i mohojnë cilësitë e Zotit në mënyrë që të theksojnë transcendençën e Zotit. Këtu paraqitet problemi i Njësisë në raport me shumësinë: a thua Njëja është në shumësi, apo megjithatë, shumësia është tek Njëja.

Pra, relacioni i Zotit me botën dhe njeriun sjell teorinë e krijimit. Këtu paraqitet edhe problemi i botës dhe shfaqja e saj nga hiçi (*ex nixilo/min adem*). Për rikrijimin e saj në çdo çast të ekzistimit ose aktualizimit e saj të vazhdueshëm, se a thua, vallë, kjo ndodh sipas ndërhyrjes së Zotit (okazionalizëm), apo në vete përmban një mundësi të tillë, të krijuar nga Zoti dhe vepron sipas rrugës natyrale, si rezultat i shkakut të krijuar nga Zoti (kausaliteti). Disa e pranojnë okazionalizmin, e të tjerët kausalitetin, kështu që argumentet kryqëzohen dhe themelohen në procedura të rrepta racionale.

(Shqip: Hamdi Ilazi)

(Vazhdon)

FOTOREPORTAZH



Kryetari i BFI të RMV ka pritur në Rijaset ish-Deputetin e Parlamentit të Maqedonisë, njëherësh edhe Komandant i Policisë Ushtarake të UÇK-së, z. Abedin Zymberi, i cili e ka uruar efendi Shaqir ef. Fetahun për zgjedhjen në postin e Reis'ul-Ulemasë. Mysafiri është pritur në shoqëri të Drejtorit të Agjencisë Hallall, h. Muhamer ef. Veseli dhe Drejtorit për Marrëdhënie me Jashtë, h. Mustafa ef. Dauti. (5.01.2021)

Thirrësi i mirënjohur shqiptar, imami i Xhamisë Dine Hoxha në Tiranë, dr. Ahmed Kalaja, viziton në Rijaset h. hfz. Shaqir ef. Fetahun, për ta uruar me rastin e zgjedhjes së tij Reis'ul-Ulema i BFI të RMV. (9.01.2021)



Kryetari i Kuvendit të Komunitetit Shqiptar të Bashkësisë Islame të Austrisë (ALKIG) dhe imam në Tërnicë, h. Emin ef. Limani, i shoqëruar nga dy djemtë e tij, hfz. Besir dhe hfz. Mujdin Limani, urojnë Kryetarin e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në detyrën e Reis'ul-Ulemasë. (1.01.2021)

Kryetari i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur Shkëlqesinë e Tij, Ambasadorin e RMV në Oslo dhe ambasador jo-rezident në Islandë, z. Serxhim Muhamed, të shoqëruar nga stomatologu z. Adnan Jahja. Në shenjë respekti, Kryetari i ka dhuruar Ambasadorit një mirënjohje dhe disa libra. (30.12.2020)





Kryetari i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur anëtarët dhe operativën e Myftinisë së BFI-Kumanovë, me në krye Myfti h. Abedin ef. Imeri, që kishin ardhur për ta uruar me rastin e marrjes së detyrës së re. (21.12.2020)



Kryetari i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur prof. dr. Halil Snopçen, deputet në Kuvendin e RMV dhe Kryetar i Akademisë Politike të Aleancës për Shqiptarët, bashkë me nënkryetarin e Forumit Rinor të Aleancës për Shqiptarët (FRASH), z. Faton Bilalli, kryetarin e FRASH-Gostivar, z. Besir Memedi dhe z. Semi Memeti, anëtar i FRASH-it. (5.01.2021)

Krerët e Lëvizjes Anti-Bixhoz vizitojnë Reis'ul-Ulemanë e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar. Me Xhemal Abdiun (Kryetar) dhe anëtarët e Kryesisë: h. Nuhi ef. Ganija, z. Jushi Emurllai dhe z. Zeqir Aliti është biseduar, po ashtu, për shumë projekte që mund të zhvillohen në luftë kundër dukurisë së shëmtuar të bixhozit, që është duke sulmuar haptazi shoqërinë tonë. (13.01.21)



Kryetari i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur në një takim urues hfz. Adnan ef. Elmazin, hfz. Nesim ef. Bajramin, hfz. Irfan ef. Sulejmanin, hfz. Ramadan Ibrahimin, Sabri Ramadanin, hfz. Nuhi ef. Ganinë, Xhevat Imerin dhe Behar Xheladinin. (29.12.2020)



Besim ef. Memedi dhe Fatih ef. Azizi, anëtarë të Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze, kanë uruar Kryetarin e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për detyrën që ka marrë. (6.01.2021)



Javën që lamë pas, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu e kanë vizituar edhe dy efendilerë të rinj nga Tetova: Blendë ef. Imeri dhe Arian ef. Ajrullai, për ta uruar. (18.01.2021)

Kryetari i Bashkësisë Islame Shqiptare (BISH) Vjenë, Senat Asani, ka vizituar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar për ardhjen në krye të BFI-së. Në shenjë respekti, kryetari Asani i ka dhuruar Reis'ul-Ulema një mirënjohje për përkrahjen që i ka dhënë kësaj qendre në të kaluarën. (30.12.2020)



Gjykatësi i Gjykatës Themelore në Shkup, z. Lulzim Saliu, i shoqëruar nga Xhemil ef. Rexhepi, kanë vizituar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e zgjedhjes Kryetar i BFI të RMV. (30.12.2020)





Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu ka pritur z. Bajram Idrizin, z. Akik Muratin-pronar i kompanisë 'Bashkim Tours', z. Zuraf Bilallin, z. Besir Shabanin dhe z. Besnik Shabanin, të cilët kishin ardhur për të uruar Kryetarin e ri të BFI të RMV. (29.12.2020)



Hafëzi nga Shkupi, Sabaatin Nuhiu, i shoqëruar nga dashamirët e fesë z. Abid Mamudi dhe z. Muametali Mustafi, kanë vizituar Kryetarin e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar pas ardhjes në krye të Bashkësisë Fetare Islame të RMV. (1.01.2021)

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu ka pritur grupin e teologeve, në përbërje: Haxhere Veseli Sulooxha, Sermijete Ismaili Biba, Sara Abedini, Mualla Musoska, Hasibe Saliu, Sumeja Neziri, të cilat kanë ardhur për të uruar Kryetarin e BFI-së. (29.12.2020)



Hoxha i nderuar me punë në Graubynden të Zvicrës, h. Vullnet ef. Bajrami, i shoqëruar nga hoxha i ri Dijar ef. Ajdari dhe gjyshi i tij, dashamiri i Reis'ul-Ulemasë, h. Çelebi Ajdari, kanë uruar Kryetarin e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (21.12.2020)



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu ka pritur grupin e përbërë nga z. Bajram Idrizi, pronar i ëmbëltores 'Elida' në Prishtinë; z. Akik Murati - afarist i mirënjohur në Rovinj të Kroacisë; Bashkim Ramadani, pronar i kompanisë 'Bashkim Tours'; z. Zuraf Bilalli - afarist i mirënjohur në Poreç, Kroaci; z. Besir Shabani dhe z. Besnik Shabani. (29.12.2020)



Harbin ef. Jonuzi, Sheip ef. Ibishi, Ibrahim ef. Selmani, Imran ef. Ibishi, Bekim Selmani, Shauki Jonuzi dhe Neim Selmani nga Tetova kanë vizituar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar për ardhjen në krye të BFI të RMV. (22.12.2020)

Hafëzi i mirënjohur i Shkupit, hafëz Isa ef. Bekteshi - imam në Xhaminë Haxhi Jonuz në Shkup dhe nxënësi i tij, hafëz Gazmend Tairi - imam në fshatin Gërçec, kanë vizituar Reis'ul-Ulemanë e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e marrjes së detyrës së re. Në takim ka qenë edhe Drejtori i OH "Hilal", Fadil ef. Ramadani. (5.01.2021)



H. Abaz ef. Memedi dhe hfz. Blerim ef. Limani, të shoqëruar nga kryesia e Xhamisë Ebu Bekr Es-Siddik, me në krye mutevelin z. Bafti Bilalli, arkëtarin z. Nazim Buqi dhe xhematlinj të tjerë, vizitojnë Reis'ul-Ulemanë për ta uruar për detyrën e re. (30.12.2020)





Imami i fshatit Koponicë, h. Muhamed ef. Berzati, i shoqëruar nga dy teologët e rinj, Musanif ef. Rufati dhe Fejzullah ef. Sadiku, nga Tetova, vizitojnë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e zgjedhjes Kryetar i BFI të RMV. (21.12.2021)



Imami i Xhamisë së Mustafa Pashës në Shkup, h. Abdusamed ef. Zeqiri, i shoqëruar nga myezini i xhamisë Furkan ef. Jahja dhe muteveliu z. Selajdin Mani vizitojnë Kryetarin e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e zgjedhjes së tij Reis'ul-Ulema i BFI të RMV. (13.01.2021)

Imami i Xhamisë së Bardhë të fshatit Hotël të Kumanovës, h. Rrahman ef. Aziri, muteveliu i Xhamisë, h. Mina Mustafa dhe anëtari i Këshillit, h. Fazli Zendeli, vizitojnë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e zgjedhjes në krye të BFI të RMV. (18.01.2021)



Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kroacisë, hafëzi i mirënjohur në rang botëror, Aziz ef. Alili, i shoqëruar nga dr. Bajram ef. Ajeti, hafëz po ashtu i mirënjohur ndërkombëtarisht, dhe z. Idriz Sulejmani, afarist dhe aktivist në jetën politike të shqiptarëve në Kroaci dhe më gjerë, kanë vizituar Kryetarin e BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e zgjedhjes në krye të BFI-së. (2.01.2021)



Imami i Qendrës Kulturore Islame Shqiptare në Gifhorn të Gjermanisë, h. Xhezair ef. Durmishi, i shoqëruar nga disa anëtarë të Kryesisë së Xhamisë, vizitojnë Kryetarin e ri të BFI të RMV. Në pritje, edhe Drejtori për Diasporë i BFI, dr. Selver Xhemaili. Mysafirët i dhurojnë Reis'ul-Ulema Shaqir ef. Fetahu një dhuratë dhe një mirënjohje në shenjë respekti për mbështetjen e tij të vazhdueshme për Qendrën. (31.12.2020)



Kryetari i Këshillit Vendor të Bashkimit Demokratik për Integrim-Çegran, z. Imer Abduraimi, i shoqëruar nga përfaqësues të Forumit Rinor të BDI-Çegran, të udhëhequr nga Kryetari i FR-BDI Çegran, z. Juled Neziri, mr. Ardian Ismaili, mr. Ramadan Salju, mr. Milaim Abduraimi, Genti Bilalli, Trashëgim Asani, Florim Ismaili, Bujar Ollomani dhe Isen Iseni, vizitojnë Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar për zgjedhjen në krye të këtij institucioni. (22.12.2020)

Imami i Xhamisë së Lenzburgut në Zvicër, Besir ef. Emini, i shoqëruar nga babai i tij, aktivisti i jetës fetare h. Emin ef. Emini dhe i vëllai, Irfan Emini, vizitojnë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e ardhjes në krye të Bashkësisë Fetare Islame. Mysafirët janë familja e hafëzit të mirënjohur, hfz. Sefer ef. Emini - imam i kamotshëm i fshatit Koritë, Gostivar. (1.01.2021)



H. Mallzim ef. Zendeli, përgjegjës për financa në Myftininë e BFI-Gostivar dhe vëllai i tij, Bashkim Zendeli, vizitojnë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar. Në pritje është edhe Sekretari i Përgjithshëm i BFI-së, Irsal ef. Jakupi. (29.12.2020)





Këtë javë, bëhet e ditur nga BFI, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur në takim Myftiun e Myftinisë së BFI-Manastir, h. Amit ef. Rasimi, të shoqëruar nga operativa e Myftinisë, të cilët e uruan Reis'ul-Ulemanë për detyrën e re dhe i dhuruan një pllakë të bukur me gravurë të Sahat-Kullës dhe të Xhamive të Is'hak Çelebiut dhe të Hajdar Kadisë. (16.01.21)



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur në një takim përurues Myftiun e Myftinisë së BFI-Prilep, h. Shefket ef. Imeri, i shoqëruar nga operativa dhe imamë të Myftinisë së Prilepit. (6.01.2021)

Myftiu i Myftinisë së BFI-Shtip dhe Maqedoni lindore, h. Nasir ef. Rexhepi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, vizitojnë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e zgjedhjes në krye të BFI të RMV. (23.12.2020)



H. Nesip Demiri, referent në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup dhe h. Muharrem Idrizallari, bibliotekar i Fakultetit, vizitojnë Reis'ul-Ulemanë e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për t'i uruar detyrën e re. (18.01.2021)



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur në takim Myftiun e Myftinisë së BFI-Kërçovë, mr. Qamil ef. Rushiti, të shoqëruar nga operativa e Myftinisë, imamët e Kërçovës dhe imami i Xhamisë së Regensdorfit në Zvicër, mr. Ferit ef. Zeqiri. (29.12.2020)



Kryetari i xhamisë "Ebu Hanife" (Troisdorf, Gjermani), haxhi Mahir Mustafa, bashkë me haxhi Ferat Feratin dhe Abdulsafet Mustafën, vizitojnë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu për ta uruar për detyrën e re. (28.12.2020)

Kryetari i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur operativën e Myftinisë së BFI-Strugë, me në krye Myftiun e saj, mr. Salim ef. Sulejmani, që kishin ardhur për ta uruar me rastin e detyrës së re. (22.12.2020)



Kryetari i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me Drejtorin e Diasporës pranë BFI-së, dr. Selver ef. Xhemaili, ka pritur Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Zvicrës, hfz. Mehas ef. Alija, dhe Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të Italisë, mr. Reshat ef. Ibishin, të shoqëruar nga hoxhallarët e xhamive të diasporës mr. Bekim ef. Alimi (Wil), Rijad ef. Aliu (Gjenevë), Bunjamin ef. Azizi (Basel), Azir ef. Aziri (Thun), Nimetullah ef. Veseli (Schaffhausen), h. Abdullah Abdullahu (Wil), h. Sherif Tupani (Fribourg) dhe z. Afet Sallmani, Thun. (28.12.2020)





Përfaqësuesit e Odës së Avokatëve të RMV, z. Fadil Xhelili dhe z. Besim Rexhepi, vizitojnë Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar në emër të Odës së Avokatëve për detyrën e re dhe për t'i dëshiruar shëndet e mbarësi. Në pritje, edhe Sekretari i Përgjithshëm i BFI-së, Irsal ef. Jakupi. (30.12.2020)



Prof. dr. Fadil Hoxha, rektor i universitetit ndërkombëtar "Vision" në Gostivar; prof. dr. Mensur ef. Nuredini, prorektor; prof. dr. Hasan Oktaj, prorektor dhe z. Mefail Rexhepi, zv/kryetar i Vakëfit, vizitojnë Kryetarin e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e zgjedhjes së tij Reis'ul-Ulema i BFI të RMV. (21.12.2020)

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu pret në vizitë urimi z. Ilija Nikollovskin, deputet në Kuvend dhe Kryetar i Partisë së Pensionistëve të Maqedonisë së Veriut; z. Mefail Ramadanin, drejtor i Shtëpisë së Pensionistëve; dhe gjeneral Zijadin Tushin, themelues i Partisë së Pensionistëve të Maqedonisë së Veriut, të cilët e përgëzojnë Reisin për zgjedhjen në postin drejtues të BFI-së. (6.12.2021)



Shoqata kulturore-artistike "Jahi Hasani" nga Çegrani (Gostivar) viziton h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar për detyrën e re, Reis'ul-Ulema i BFI të RMV. Janë kryetari z. Zani Memedi, koreografi z. Berat Xhelili dhe 3 artistë të kësaj shoqërie kulturo-artistike. (5.01.2021)



Miku i studimeve, Ramiz Alija, me të birin, Llukman Alija, kanë uruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (21.12.2020)



Kryetari i shoqatës "SOS VITA", Ertan Shakiri, njëherësh edhe këndues i mirënjohur i ilahive, ka vizituar Kryetarin e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar për ardhjen në krye të Institucionit. Mysafiri është pritur bashkë me Sekretarin e Përgjithshëm të BFI-së, h. Irsal ef. Jakupi. (23.12.2020)

Kryetari i BFI, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pritur në një takim hafëzin e ri Xhevat ef. Zendeli, nxënësi i hafëzit të mirënjohur të Evropës, hfz. Aziz ef. Alili dhe familjarët e tij: h. Zufer Zendeli, h. Nexhbi Zendeli dhe Samir Bajrami. Hafëzi e ri nga fshati Çegran i Gostivarit ka mbaruar hifzin në Zagreb të Kroacisë dhe e ka mbrojtur me sukses provimin e hifzit në Sarajevë. (29.12.2020)



Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Islame, Shkup, i udhëhequr nga dekanin prof. dr. Shaban ef. Sulejmani, uron Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (31.12.2020)





Studentët e Fakultetit të Shkencave Islame Sulejman Haliti, Mukrem Rushiti, Amir Selimi dhe Venhar Ismaili vizitojnë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar për ardhjen në krye të BFI të RMV. (23.12.2020)



Z. Xhezmi Iseini, përgjegjës i kompanisë EVN-Maqedoni për rajonet Çeçran, Forinë e Çajle dhe z. Fidan Ismaili, inspektor i lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, vizitojnë Reis'ul-Ulemanë për ta uruar për detyrën e re. (18.01.2021)

Z. Ilir Ramadani, drejtor i TV Uskana-Kërçovë, viziton Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për ta uruar me rastin e zgjedhjes Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të RMV. (18.01.2021)



Javën që lamë pas, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahun e ka vizituar edhe artisti dhe regjisori i ri dhe premtues Alban Fetai. Ai është regjisor i filmit "Shokët e vërtetë", i shfaqur për publikun në korrik të vitit 2018. (18.01.2021)



H. Vesel ef. Xhaferi, koleg studimesh i Shaqir ef. Fetahut, uron Reis'ul-Ulemanë për detyrën që ka marrë. (18.01.2021)

Mr. Amet Memeti, hoxhë dhe aktivist i njohur në mbarë Zvicrën dhe më gjerë, uron Reis'ul-Ulemanë e BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për detyrën e re, i shoqëruar nga anëtarë të kryesisë së Xhamisë Buhara, Kradolf. (28.12.2020)



Rektori i Universitetit të Tetovës, prof. dr. Vullnet Ameti, uron Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu për zgjedhjen në krye të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut. (6.01.2021)



Telegram urimi nga Unioni i Studentëve Shqiptarë të Ez'herit, Kajro, Egjipt, për Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.



VARREZAT MYSLIMANE NUK LIHEN REHAT NGA KOMUNAT



Në Veles të thonë: Ne si Myftini nuk kemi ndonjë karakteristikë të veçantë. Ne jemi një nga myftinitë më të varfra nga të trembëdhjetë myftinitë e tjera dhe mezi ia dalim mbanë. Por, veçantia e vetme që kemi ne është harmonia dhe lidhja jonë e ngushtë me të gjitha xhamatet tona dhe në këtë mënyrë ne sfidojmë dhe rezistojmë me këmbëngulje për të ruajtur karakterin e një myftinie me të gjitha nishanet e saj.

Myftinia e Velesit, sipas Kushtetutës së BFI-së, është pjesë përbërëse e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Relacioni BFI – Myftini, dhe anasjelltas, është në një nivel të lakmueshëm dhe gjithmonë bashkërisht kemi arritur të përballemi me të gjitha sfidat, thonë në Myftininë e Velesit.

Bashkësia Fetare Islame në Veles ka 18 xhami dhe katër mesxhide, prej të cilave një xhami qendrore në Veles, kurse të tjerat ndodhen në vendbanimet si: Jabollçisht i Epërm dhe i Poshtëm, Vranovc i Epërm, Melnicë, Sogle, Orizare e Epërme, Slivnik, Kllukovec, dy xhami në Buzallkovë, Cërkvinë, Koçillar, Vodovrat, Kavadarci i Epërm, Kureshnicë, Çelevec dhe në fshatin Bistrenc. Mesxhidet janë në komunën Gradsko, Negotinë e Epërme dhe në fshatrat Pepelishtë dhe Krivollak.

Kryesisht, të gjitha këto xhami janë funksionale, përveç xhamive në fshatrat Sogle, Çelevec dhe Bistrenc, kurse mesxhidet në Negotinë e Epërme, në fshatrat Pepelishtë dhe Krivollak funksionojnë vetëm në kohë të caktuara: gjatë xhumave, në Ramazan dhe gjatë faljes së Bajrameve.

Sa i përket aspektit të ndërtimit të xhamive të Myftinisë në Veles, shumica e tyre janë rindërtuar nga themeli, kurse një pjesë e vogël e tyre janë ndërtuar krejtësisht të reja.

XHAMITË

Xhamia "Fazil Ahmet Pasha" në Velesin e Epërm, ose xhamia qendrore, në dhomat ndihmëse të së cilës ndodhet Myftinia e BFI-së në Veles, është xhamia e vetme në qytetin e Velesit, e cila shërben për të bërë ibadet besimtarët dhe tje-

tër xhami nuk ka. Këtë xhami e ka ndërtuar Fazil Ahmet Pasha, i cili ka qenë vezir i Shtetit Osman, sipas gojëdhënave: diku në shekullin e 17-të.

Gjatë kohës së RSFJ-së, kur saktësisht nuk dihet, është ndërprerë puna e saj, por pas rrënimit të Xhamisë së Bar-

dhë në vitin 1972, ajo u adaptua përsëri nga qeveria e atëhershme dhe u lëshua në shërbim të njerëzve, deri në vitin 1994, kur iu vu zjarri për arsye të panjohura, por me përpjekjet e popullatës dhe të BFI-së u bë riparimi i pjesës së jashtme dhe të brendshme të Xhamisë dhe përsëri



Xhamia e vetme në qytetin e Velesit, aty ku ndodhet edhe selia e Myftinisë.



Jemi ndër myftinitë më të varfra: h. Nejazi ef. Murati, Myfti i Myftinisë së Velesit.

u lëshua në shërbim. Kjo xhami quhet edhe Xhamia e Zezë, kurse emrin e ka marrë me siguri sipas materialit nga i cili u ndërtua.

Xhamia në f. Jabollçisht i Epërm nuk dihet saktësisht se kur është ndërtuar, megjithatë rindërtimi i saj nga themeli u bë në vitin 2000. Riparimi i fundit u bë në vitin 2016. Pjesa e brendshme dhe e jashtme u riparuan në vitin 2020. Xhamia në f. Jabollçisht i Poshtëm - Xhamia e Vjetër nuk dihet se kur është ndërtuar, por popullata e ka bërë rindërtimin e saj nga themeli në vitin 1998.

Xhamia në f. Vranovc i Epërm është muze, nën mbrojtje të ligjit. Xhamia në f. Melnicë është ndërtuar në vitin 1892. Disa herë është bërë rikonstruktimi i pjesës së brendshme, por rindërtimi i saj nga themeli është bërë në vitin 2014. Xhamia në f. Slivnik, së pari në vitin 1963 u ndërtua si mesxhid dhe në vitin 1999 u rrënuar mesxhidi dhe u vu gurthemeli i xhamisë së sotme.

Xhamia në f. Kllukovec është ndërtuar në vitin 1994. Ky është fshat i sapoformuar; më parë nuk ka pasur asnjë xhami dhe xhemati në atë kohë nuk ka mundur të marrë dokumentacionin e duhur për ndërtimin e xhamisë dhe e filluan atë si shtëpi dhe më pas e lëshuan në funksion dhe tani me ligjin për legalizim u legalizua. Xhamia në f. Buzallkovë nuk dihet saktësisht se kur është ndërtuar, por në vitin 1996 u bë rikonstruktimi i saj nga themeli. Xhamia e dytë në f. Buzallkovë, Xhamia e Re, u ndërtua nga themeli në vitin

2012. Ajo funksionon, por ende nuk është bërë hapja solemne e saj.

Sanxhak-Xhami quhet xhamia në f. Cërkvinë. U ndërtua në vitin 1998 si mesxhid. Autoritetet e atëhershme nuk lejuan ndërtimin e minares, por në vitin 2004 u ndërtua edhe minarja. Xhamia në f. Koçillar gjithashtu u ndërtua së pari si mesxhid. Për xhaminë në f. Vodovrat nuk ka të dhëna se kur është ndërtuar. Kjo është nga koha e osmanëve dhe ka qenë



Xhamia në Jabollçisht të Epërm

mesxhid. Këtu në këtë vend u vendosën boshnjakët - Sanxhakli dhe ata e shfrytëzuan ndërtesën e vjetër. Në vitin 1992 bëjnë rikonstruktimin e saj nga themeli dhe atëherë ndërtojnë minaren dhe, nga mesxhidi, bëhet xhami.

Xhamia në Kavadarciin e Epërm është e vjetër më shumë se 400 vjet. Dhe, është e vetmja xhami në Kavadarciin e Epërm. Kjo xhami ka qenë e mbrojtur me ligj në kohën e ish-Jugosllavisë, por gjithashtu në atë kohë është keqpërdorur shumë dhe kështu i është dhënë me qira si depo Monopolit të atëhershëm të duhanit, e pastaj kooperativave bujqësore, deri në vitin 1971. Në këtë kohë kryetar i Këshillit të xhamisë emërohet z. Amet Fazliovi, i cili arrin ta marrë nga Muzeu i galerisë së qytetit të Kavadarciit, ku ishte e mbrojtur me një pllakë bronzi. Z. Ameti në vitin 1988 arrin ta riparojë, edhe atë me mjetet e veta, deri në vitin 2015, kur u bë rikonstruktimi i saj nga themeli dhe ende në krye të Këshillit të xhamisë është z. Amet Fazliovi.

Xhamia në f. Çelevec, nuk dihet saktësisht se kur është ndërtuar, por është rinovuar në vitin 2014. Xhaminë në f. Kureshnicë në vitin 1663 e ndërtoi Ibrahim Pasha dhe ka funksionuar deri në vitin 1963, deri në shpërnguljen e banorëve të vendit për në Turqi. Pjesa tjetër e kësaj popullate, që mbeti aty, në vitin 2004 bëri rikonstruktimin e kësaj xhamie nga themeli.

Xhamia në f. Bistrenc u ndërtua në vitin 1231 hixhri dhe funksionoi deri në vitin 1963. Tani edhe kjo xhami u rinovua në vitin 2014. Xhamia në f. Orizare e Epërme është ndërtuar në vitin 1978. Xhamia në f. Sogle nuk ka të dhëna se kur është ndërtuar, por në vitin 2016 është rinovuar.

MESXHIDET

Mesxhidi në komunën Gradsko u ndërtua i ri, sepse aty nuk ka ekzistuar asnjë objekt fetar; organet qeveritare nuk lejuan ndërtimin e xhamisë aty. Më në fund, Myftinisë iu kujtua dhe propozoi që të blejnë një shtëpi, të cilën do ta rindërtojnë dhe do ta kthejnë në mesxhid dhe kështu ndodhi: në vitin 2018 tashmë objekti ishte i gatshëm për kryerjen e obligimeve fetare.

Mesxhidi në Negotinën e Epërme: i njëjti problem ndodhi edhe me këtë xhematë - nuk mund të merrnin kurrfarë leje për ndërtimin e një objekti fetar. Në fund e blenë një


shtëpi, edhe kjo ishte në gjendjen e njëjtë të asaj më parë, vetëm se lokalet përdoren për kryerjen e detyrave fetare, e një pjesë e tyre për mbajtjen e mësimbesimit fetar.

Mesxhidi në Krivollak është përshtatur për kryerjen e rregullave islame. Nuk dihet saktësisht se kur është ndërtuar, por rregullisht dhe vazhdimisht po riparohet dhe rikonstruktohet.

Mesxhidi në f. Pepelishtë: i njëjtë është rasti edhe me mesxhidin në Pepelishtë-edhe ai nuk dihet se kur është ndërtuar, por xhamati po e rinovon gradualisht dhe kështu e mbajnë atë në formë.

Të gjitha këto xhami kanë varrezat e veta, për të cilat kujdesen Këshillat e xhamive të vendeve përkatëse. Sa i përket Myftinisë, në këtë drejtim, nuk ka ndonjë problem më të madh: çdo gjë funksionon në rregull, përveç problemit që na paraqitet në lidhje me varrezat në vendet e banuara, të cilat nuk i përkasin domenit tonë. Bëhet fjalë për vendet që nuk ka myslimanë, vende prej të cilave janë shpërngulur myslimanët dhe në ato vende shpesh bëhet përpjekje për uzurpimin dhe përdhosjen e tyre etj. Në këto vende Myftinia arrin t'i ndalojë dukuritë e këtilla, por nuk mund të ketë sukses kudo, sepse në disa vendbanime ku nuk ka pronësi të parcelave të këtilla, atje nuk mund ta zgjidhë këtë problematikë. Më shumë probleme të këtilla bëjnë vetë komunat: vendet i trajtojnë si pronë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ato i shtypin projektet e tyre në shenjë të pafuqisë sonë.

Myftinia e Bashkësisë Fetare Islame në Veles theks të veçantë u ka kushtuar ditëve dhe netëve të mëdha (Mubarek): të Ramazanit, të Bajramit, për të cilat përgatit posaçërisht programet e veta perio-



Xhamia në Buzallkovë-pamje e brendshme.

dike. Gjatë festimit të netëve dhe (muajve) gjithmonë kontakton me imamët dhe Këshillat e xhamive, mban mbledhje, në mënyrë që të kuptohet më mirë roli i BFI-së në jetën tonë, që do të thotë se në këtë mënyrë ne arrijmë t'u kundërvihemi të gjitha negativiteteve që paraqiten në lidhje me zbatimin e planit dhe programeve tona. Në këtë drejtim ne si Myftini mund të themi lirisht se kemi sukses dhe harmoni, shpjegojnë në Myftininë e Velesit.

Sa i përket bashkëpunimit të Myftinisë me myftinitë tjera, lirisht mund të themi se ky bashkëpunim është në një nivel të lakmueshëm: përndajmë përvojat mes vete dhe ndihmojmë njëri-tjetrit për çdo plan atje ku ka nevojë, vizitojmë njëri-tjetrit dhe, që është më e rëndësishme, ne shumë e respektojmë njëri-tjetrit. Në fushën e solidaritetit solidarizohemi. Në këtë nivel që ndodhen myftinitë, në aspektin e bashkëpunimit të

tyre, me siguri është për shkak se udhëheqësit, do të thotë Myftitë, iu përkasin gjeneratave shkollore të afërta dhe për këtë arsye edhe pikëpamjet e tyre janë të tilla, nënvizojnë në Myftininë e Velesit.

“Rijaseti, dora e djathtë dhe amza jonë”

Sa i përket bashkëpunimit Myftini – Rijaset, edhe këtu po ashtu nuk ka asnjë negativitet. Gjithmonë Rijaseti për Myftininë ka qenë dora e djathtë dhe si amza jonë: gjithmonë ka qenë me ne, me Myftininë, kur ka pasur nevojë. Gjithashtu edhe Myftinia gjithmonë i është përgjigjur thirrjes së Rijasetit dhe pa rezervë ka qëndruar dhe qëndron krah për krah me Rijasetin.

Ne si Myftini e BFI-së në Veles, thonë, vazhdojmë ekzistencën tonë

në një pozitë të atillë ku përqindja e popullsisë së krishterë është e madhe, kurse edhe në Veles, si qytet, nuk ka shumë media dhe shtëpi botuese, por edhe ato që janë nuk janë të interesuar të bashkëpunojnë me ne, sepse ndjekësit e tyre janë të besimit tjetër. Pothuajse gati nuk kemi asnjë paraqitje si Myftini në media, përveçse ndonjëherë kur ndodh ndonjë ngjarje jo e mirë, e padëshiruar.

Lidhur me Vakëfin, tregojnë në Myftininë e Velesit, nuk kemi shumë informacione: e dimë se ku ndodhet Vakëfi, por a thua është kthyer dhe sa është kthyer, atë nuk e dimë, sepse në pjesën më të madhe të Anavardarit Rijaseti i BFI e zgjidhte këtë problem drejtpërdrejt dhe tani, si është situata, ende nuk e dimë, por edhe si Myftini kur kemi kërkuar nga organet shtetërore, gjithmonë na kanë refuzuar për shkak të dokumentacionit jo të plotë. Tani është edhe më keq, sepse pjesën më të madhe të pronës sonë, të uzurpuar nga ana e individëve, shteti, si ndërtime të paligjshme, ua ka legalizuar atyre pronën dhe tashmë kjo punë është mbyllur.

Në fund, në Veles të thonë: Ne si Myftini nuk kemi ndonjë karakteristikë të veçantë. Ne jemi një nga myftinitë më të varfra nga të trembëdhjetë myftinitë e tjera dhe mezi ia dalim mbanë. Por, veçantia e vetme që kemi ne është harmonia dhe lidhja jonë e ngushtë me të gjitha xhamatet tona dhe në këtë mënyrë ne sfidojmë dhe rezistojmë me këmbëngulje për të ruajtur karakterin e një myftinie me të gjitha nishanet e saj.

Përgatiti: Adem Çoreski; përktheu nga maqedonishtja: Hamdi Ilazi



Xhamia në Slivnik

ZULLUMI DHE GËNJESHTRA E SHKAPËRDERDHI POPULLIN

Asnjë thirrës i mirëfilltë nuk është distancuar e as ka hequr dorë nga populli i tij. Kështu ndodhi edhe me banorët e shpellës: vërtet u tërhoqën nga rreziku dhe pamundësia për të vepruar, por nuk e përfunduan jetën pa u kthyer dhe pa e parë se populli është udhëzuar në rrugë të Zotit.

Shkruan: Dr. Ziber Lata

﴿وَإِذْ أَعْتَرَلْتُمُوهُمْ وَمَا يَعْبُدُونَ إِلَّا اللَّهَ فَأَوَّا إِلَى الْكَهْفِ نَبِشْرُ لَكُمْ رَبُّكُمْ مِنْ رَحْمَتِي وَيَهَيِّئْ لَكُمْ مِنْ أَمْرِكُمْ مَرْفَقًا﴾

Kur u tërhoqët prej tyre e ç'adhuronin veç Allahut: “Strehohuni në shpellë! Zoti juaj e hap për ju Mëshirën e Vet dhe ju bën lehtësi në çështjen tuaj.”

Ajeti 16, përmes pjesëzës *إِذْ*, shpall një çast të rëndësishëm nga ngjarja e djelmoshave të shpellës, më konkretisht momentin kur ata u distancuan nga popullata për shkak të zullumit dhe të politeizmit. Parimisht, largimi dhe lënia e një populli nuk është veprim që e pëlqejnë mësimet islame, megjithatë, siç është thënë më parë, ata nuk u larguan nga plogështia apo mllefi që kishin për politeistët, por për shkak të trysnisë dhe rrezikut që u kanosej nga pushtetarët dhe populli zullumqar. Pra, ata bënë një tërheqje të detyruar strategjike, për të menduar, planifikuar dhe për t'u rikthyer përsëri. Këtë dëshirë e zbuloi Zoti (xh. sh.) me vetë kthimin e tyre në mesin e popullit pas treqind viteve.

Asnjë thirrës i mirëfilltë nuk është distancuar e as ka hequr dorë nga populli i tij. Muhamedi (a. s.) migroi në Medinë, por nuk vdiq pa e çliruar Mekën. Musa (a. s.) u largua në Medjen, por nuk e la këtë botë pa u kthyer për t'u ballafaquar me Faraonin; Ibrahim (a. s.) e shmangte Nemrudin, por nuk vdiq pa debatuar publikisht dhe pa e sfiduar atë. Jusufi (a. s.) e humbi familjen dhe popullin në fëmijëri, por Allahu ia ktheu ata pas shumë viteve. Junusi (a. s.) u largua i hidhëruar me popullin e vet, por Allahu (xh. sh.) e futi në bark të peshkaqenit dhe përsëri e ktheu në gjirin e tyre.

Kështu ndodhi edhe me banorët e shpellës: vërtet u tërhoqën nga rreziku dhe pamundësia për të vepruar, por nuk

e përfunduan jetën pa u kthyer dhe pa e parë se populli është udhëzuar në rrugë të Zotit.

Këta shembuj të pejgamberëve të Zotit japin të kuptohet se largimi nga e keqja, prej së cilës lëngon populli, është krejt e gabuar, por duhet qëndruar për t'u ballafaquar me të, derisa nuk rrezikohet drejtpërdrejt jeta.

Muhamedi (a. s.) u largua nga Meka vetëm atëherë kur mekasit u përgatitën për ta vranë atë. Banorët e shpellës nuk u larguan nga populli i tyre pa e ngritur dhe pa e shpalosur platformën e tyre doktrinare.

Fillimisht është ajeti kuranor *إِذْ قَامُوا فَقَالُوا “kur u ngritën e thanë...”*, pastaj në fund është *إِذْ أَعْتَرَلْتُمُوهُمْ “kur u larguat prej tyre...”*. Pra, njëherë vepruan e punuan, në fund u larguan nga pamundësia për të vazhduar veprimtarinë. Kjo tregon se çdo largim nga populli apo masa, pa provuar të ndryshohet diçka, është i gabuar.

LARGIMI, PËR SHKAQE TË RREZIKUT FIZIK

Ajeti paraprak (i pesëmbëdhjetë) flet për devijimin e popullit në masë, për mospasjen e një *sultani* (argumenti) të qartë dhe për zullumin që ka ardhur si rezultat i gënjeshtrës, pastaj menjëherë ajeti i radhës fillon *إِذْ أَعْتَرَلْتُمُوهُمْ “kur u larguat prej tyre...”* d.m.th. zullumi dhe gënjeshtra kolektive janë faktorët kryesorë që i shkapërderdhin njerëzit nga gjiri i popullit të tyre.

Në ajete janë theksuar dy gjëra nga të cilat janë distancuar banorët e shpellës: populli dhe atë që ata adhuronin përveç Allahut, “*Kur u tërhoqën prej tyre dhe ç'adhuronin përveç Allahut*”. Tërheqja së pari nga populli, pastaj nga ajo që ata e adhuronin, flet se largimi është bërë për shkaqe të rrezikut fizik, sepse

përndryshe fillimisht do të tërhiqeshin nga besimi i tyre e pastaj nga vetë ata.

Po ashtu, kjo tregon se njeriu nuk mund t'u largohet veseve të këqija pa u larguar fillimisht nga njerëzit e këqij, prandaj banorët e shpellës njëherë e shprehën largimin nga ata (politeistët), pastaj largimin nga ajo që ata adhuronin.

Fraza *“...dhe nga ajo që adhuronin përveç Allahut”* tregon se djelmoshat e shpellës u larguan edhe nga adhurimet e idhujve që ishin të përhapura në mjedisin e popullatës. Kjo pjesë e ajetit mund të zëvendësohet me fjalën “nga zotat e tyre”, “nga ajo që ata adhuronin (pa fjalën *përveç Allahut*)”, apo ndonjë fjalë tjetër, mirëpo vetëm përmes kësaj që Allahu ka përzgjedhur në këtë ajete mund të thuhet krejt ajo që është dashur të thuhet. Kjo formë tregon se ata u distancuan nga krejt populli (fizikisht) dhe nga ajo që ata adhuronin përveç Allahut, sepse kishte edhe njerëz të tjerë që e kishin fshehur besimin tek Allahu, por nuk ishin në grupin e djelmoshave.

Thënë shkurt, ata nuk u distancuan nga krejt ajo që e besonin populli, sepse në mesin e tyre kishte besimtarë tek Allahu, por u distancuan vetëm nga ajo që adhurohej në vend të Allahut. Nëse e shohim më thellë, atëherë vërejmë se aq sa kjo pjesë e ajetit shpreh tërheqje dhe distancim, po aq shpreh lidhshmëri me ata që adhurojnë Allahun, sikur ata thanë “ne largohemi fizikisht nga ju dhe nga ajo që adhurojnë politeistët, por shpirtërisht jemi të lidhur fuqimisht me ju që adhuron Allahun”.

Po ashtu, ky ajete na mëson formën dhe mënyrën e tërheqjes. Asnjëherë nuk duhet tërhequr nga çdo gjë, por çdoherë të jemi të kujdesshëm në shmangien e gjërave, apo edhe të njerëzve.

Kjo gjithashtu ishte një thirrje drejtuar popullit të vet: “ne jemi tërhequr nga ju deri atëherë kur ju

TË JESH MYEZIN...

Ezani i bukur, i thirrur nga një myezin me zërin joshës, është bota jote, është flladi që përkëdhel ndjenjat tua, është gjaku që shtyp zemra jote. Në ato momente ndalesh dhe mendon se nuk e di kujt i ke bërë një të mirë kaq të madhe që Zoti të bekon me këtë zë që të thirr në takim me Zotin!

Shkruan: Dr. Husein Rizai

Ç' do të thotë të jesh myezin? Ç' kuptim ka kjo fjalë? Ç' vlerë ka ky njeri?

Kuptimi leksikor i myezinit do të thotë: njoftim, të njoftuarit, të thirrurit apo të informuarit për diçka. Ndërsa në kuptimin terminologjik, myezini është personi i cili njofton, informon, thërret në namaz, në kohën e lutjes, të cilat janë 5 herë në ditë.

Pra, myezini është personi që thërret ezanin dhe bën ikametin, është zëri i myezinit që thërret në namaz dhe namazi siguron tubimin dhe afrimin e myslimanëve brenda shoqërisë islame. Thirrja e myezinit, është thirrja e ezanit, që me një fuqi të shenjtë ndal gjithçka.

...Dëgjohej vetëm ezani.

Dhe duke dëgjuar ezanin, myslimani shpreson në shefaatin (ndërmjetësimin) e Pejgamberit (a. s.), në Ahiret.

Ezani nuk është vetëm thirrje për namaz, meqenëse ai, në të vërtetë, është sekret i lartësisimit dhe i ngritjes së myslimanëve.

Ezani është një ftesë e hapur që u bëhet pesë herë në ditë myslimanëve të devotshëm, në çdo vend të botës, për të përmbushur detyrimet ndaj fesë islame.

Dhe, është pikërisht ai zë kumbues i myezinit, që ngre lart zërin e së vërtetës dhe të gjitha krijesat që e dëgjojnë këtë zë, do të dëshmojnë për besimin e tij Ditën e Gjykimit.

NJERIU PRANË NESH

Myezini është një njeri i zakonshëm, që jeton pranë nesh dhe ndoshta njerëzit nuk e vlerësojnë e nuk i japin rëndësinë

e duhur, por është pikërisht ai që ka për detyrë t'i udhëzojë njerëzit në çështjet e besimit dhe të adhurimit. Pra, njerëzit në asnjë çast nuk duhet të harrojnë misionin e myezinit, profesionin e tij...

Koha që jetojmë është aq dinamike, ditët vrapojnë me shpejtësi marramendëse. Ne jemi aq të ngarkuar me lloj-lloj punësh dhe obligimesh, aq sa shpesh na duhet të mbajmë agjendë për të shënuar programin tonë, takimet, obligimet. Falë teknologjisë, tani kemi mjete të ndryshme që na rikujtojnë se çfarë duhet të bëjmë. Njerëz me poste të ndryshme kanë njerëz të posaçëm të punësuar, pikërisht për t'iu kryer këto punë. Ne ju jemi gjithmonë mirënjohës këtyre njerëzve apo mjeteve që na rikujtojnë për morinë e punëve njerëzore të përditshme sonë, po a kujtohem ndonjëherë ta falënderojmë myezinin tonë?

Është ai, që pesë herë në ditë, që nga mëngjesi i hershëm e deri në mbrëmje vonë, në kohë saktë, na rikujton detyrat tona ndaj Krijuesit, na fton në namaz, duke bërë që ne t'i harrojmë punët dhe hallet e kësaj bote dhe ta pastrojmë shpirtin tonë me adhurim ndaj të madhit Zot.

Momenti i thirrjes së ezanit nga myezini është koha kur në trurin tonë bie një zile, është zilja e ndërgjegjësimit, kur ne i themi vetes: O njeri, mjaft punove për trupin, për punët e pafundme të kësaj bote! Mendo pak për shpirtin tënd, për qetësinë e tij!

Myezini thërret ezanin dhe ti hyn në një botë tjetër; është bota e adhurimit, është momenti i përkushtimit, i paqes, i reflektimit.

Është momenti kur shpirti i njeriut përjeton një dimension tjetër; ai do të

adhuroni dikë tjetër pos Allahut, por nëse ju adhuroni Allahun, ne jemi pranë jush". Pra, në një mënyrë, lanë një formë të afrimit dhe u treguan se largimi prej tyre është për shkak të veprimit të gabuar dhe jo për shkakun e vetë atyre.

Sipas një versioni, këto ajete përfaqësojnë fjalët e udhëheqësit të djelmohave, i cili pas tërheqjes, me inspirim nga Allahu (xh. sh.), i urdhëroi që të strehohen në shpellë, sepse aty do të gjejnë mëshirën e Zotit.

Ky prononcim i udhëheqësit të tyre tregon se çfarë shpirti optimist duhet pasur udhëheqësit. Edhe pse e kishin çdo rrugë të mbyllur, mundësinë e fundit që e kishin para vetes - shpellën, e shndërroi në rrugëdalje dhe zgjidhje të dertit të tyre.

Pra, udhëheqësi i denjë ka shpirt optimist dhe përpiket me vendosmëri që çdoherë kur të mbyllet një rrugë, të gjejë një tjetër.

Vetë thirrja për t'u strehuar, flet se ikja dhe tërheqja e djelmohave të shpellës ishte për shkak të pasigurisë dhe mospasjes së strehimit. Fjala *strehohuni* (فُؤُوا - fe'vu) në vete përmban shmangien e rrezikut, sigurinë dhe qetësinë, prandaj kur këto elemente të mungojnë në një mjedis të caktuar, vjen në shprehje largimi dhe lënia e atij mjedisi.

Nëse analizohet situata në të cilën ishin djelmohat e shpellës, ku shihet se luftonin për të mbetur gjallë, mund të vijmë në përfundim se njeriu në situata të tilla zakonisht vetëm kërkon të shpëtojë kokën, mirëpo prej liderit të tyre, apo prej vetë atyre, u kërkua që krahas shmangies së rrezikut, të gjejnë edhe siguri e qetësi.

Kjo gjithashtu na mëson se në raste rreziku, asnjëherë nuk duhet të sigurojmë vetëm shmangien e rrezikut, por edhe sigurinë dhe qetësinë shpirtërore.

"Strehohuni në shpellë! Zoti juaj e hap për ju Mëshirën e Vet..." Kjo pjesë e ajetit përmban një fjali kushtore, ku shihet se pa strehim nuk ka as përhapje të mëshirës, apo thënë më ndryshe, aq sa në një mjedis apo shoqëri të caktuar ka siguri dhe strehim, aq Zoti i madhërishëm do të lëshojë edhe mëshirë. Pra, është e pamundur të kërkohet mëshira e Zotit në një hapësirë ku mungojnë dy komponentë: siguria fizike dhe qetësia shpirtërore (strehimi).

NGADHËNJIMI VJEN NGA ZOTI

Kur jemi këtu, parashtrahet një pyetje: përse historikisht shpella ka qenë strehë për besimtarët? Muhamedi (a. s.) para shpalljes vetmohej në shpellën Hira, gjatë hixhretit u fsheh në shpellën Theur, djelmohat u strehuan po ashtu në shpellë

etj. Këto fakte tregojnë edhe formën ndryshe të të menduarit të besimtarit.

Jobesimtarët duke qenë të nënshtruar tërësisht ndaj ligjit të kauzalitetit (shkak-pasojë), atyre nuk u shkonte ndër mend të kërkonin në shpellë, sepse sipas tyre është e palogjikshme që ai i cili ik nga vdekja të futet në një shpellë pa dalje dhe ku do të kapej me lehtësi, mirëpo besimtari e sfidon këtë logjikë, sepse pasi t'i ketë shfrytëzuar të gjitha mundësitë, është i vetëdijshëm se ngadhënjimi nga Zoti vjen aty ku të tjerët shohin vetëm dështim.

Pra, këtu shohim se besimtari i vërtetë, përveç shfrytëzimit të logjikës dhe kushteve që i ka në dispozicion, është i pajisur edhe me bindjen dhe nënshtrimin ndaj Zotit, ku kjo e fundit do t'i mundësojë epërsinë ndaj atyre që nuk e kanë.

Emri i Allahut رَبُّ *rabbun*, çdoherë në Kuran është përdorur në lidhjen gjinore me një emër apo përemër, p.sh. رَبُّ مُوسَى "Zoti i Musës", apo siç është në këtë ajet رَبُّكُمْ "Zoti juaj". Kjo nuk do të thotë se Ai është vetëm Zot i Musës, apo i dikujt veçmas, mirëpo, në çdo vend ku përmendet një atribut i Zotit (përveç fjalës Allah), krahas kuptimit për Qenien Absolute, ekziston një atribut i favorizuar, varësisht se çfarë synohet. Pra, fjala رَبُّ *rabbun* (Zot), siç kemi thënë më parë, përfaqëson Zotin (e Përsosur), i Cili i edukon dhe kujdeset për robërit në formën e përkryer.

Kur e kemi parasysh këtë kuptim, atëherë kuptojmë se përse Allahu (xh. sh.) emrin e Vet رَبُّ *rabbun* çdoherë e ka sjellë të lidhur me një emër apo përemër, jo sepse Ai është Zot vetëm i atij me të cilin është lidhur emri *rabbun* (emër apo përemër), por sepse mënyra e edukimit dhe e kujdesit të Zotit për atë (emër apo përemër) është e veçantë për të. Kjo na tregon se çdo njeri ka stil të veçantë të jetesës, prandaj edhe mënyra dhe forma e edukimit është e veçantë për çdokënd. Përdorimi i frazës رَبُّكُمْ "Zoti juaj", në këtë ajet, është një garanci për shpëtimin e djelmohave të shpellës, sepse sado që instruksionet të jenë enigmatike nga Edukuesi Absolut, ato përsëri në fund do të jenë të dobishme.

RAHMET PAS ZAMETIT

Sado që tregimet e sures Kehf janë të dhimbshme, sepse përmbajnë sakrificat të ndryshme, ato përsëri në vetvete ngërthejnë një frymë shpresdhënëse dhe ngjallin shumë optimizëm. Nëse i referohemi ngjarjes së djelmohave të shpellës, shohim se fjala رَحْمَةٌ *rahmetun* (mëshirë)

përmendet dy herë, kurse në gjithë suren përmendet shtatë herë.

Përse Zoti (xh. sh.) u tha (يُنشُرْ لَكُمْ) "përhap për ju Zoti juaj nga mëshira e Tij" e jo "ju mëshiron"?

Nëse do të përdorej folja يَرْحَمُكُمْ "ju mëshiron", atëherë do të kuptohej vetëm shpëtimi i djelmohave nga shpella, ndërsa përdorimi i fjalës يَنْشُرْ *jenshur*, e cila do të thotë përhap apo shpërndan, nënkupton mëshirën e tyre dhe reflektimin e asaj mëshire të besimtarët tjerë, sepse dihet bukur mirë se ngjarja e banorëve të shpellës nuk ishte mëshirë vetëm për ata, por ishte mëshirë edhe për besimtarët tjerë, të cilët kur panë, pasi dolën nga shpella, u bindën në ringjalljen.

Po ashtu, mëshira nuk mbeti vetëm tek ata, e as vetëm te populli që i shikoi pas zgjimit, por tregimi i tyre do të mbetet mëshirë për mbarë njerëzimin, për sa të ekzistojë bota.

Gjithashtu, nëse shihet fraza مِنْ رَحْمَتِهِ "nga mëshira e Tij", tregon se zgjimi i tyre pas treqind vjetëve, edhe pse është çudi për të gjithë ne, nuk është asgjë e madhe për Allahun, madje është vetëm një pjesë e mëshirës së Tij.

Parashtrahet pyetja: përse djelmohat në këtë ajet (16) dhe në ajetin e dhjetë (10) nuk kërkuan shpëtim, rrugëdalje, ngadhënjim apo diç tjetër, por u fokusuan te mëshira?

Përzgjedhja e fjalëve dhe përmbajtja e lutjes flet për nivelin intelektual, mprehtësinë dhe ngritjen shpirtërore të lutësit. Djelmohat ishin njerëz të zgjedhur të shoqërisë, prandaj kërkuan gjënë më me vlerë për njeriun - mëshirën e Zotit, sepse tek e fundit synimi ynë në dynja është që të arrihet mëshira e Zotit në Botën Tjetër. Mëshira e Zotit e sollti njeriun në dynja, mëshira e Tij e mban gjallë në këtë botë pavarësisht mëkateve dhe zullumeve që bën ai (njeriu) dhe mëshira e Tij do ta shpëtojë dhe do ta fut në Xhenet në Botën Tjetër.

MËSHIRA, E VETMJA CILËSI E ZOTIT

Banorët e shpellës ishin të vetëdijshëm për ndonjë lëshim gjatë jetës apo gjatë largimit të tyre, prandaj mëshira ishte e vetmja cilësi e Zotit, e cila u falte mëkateve dhe u hapte rrugën e suksesit, ngase rahmeti në vetvete ngërthen falje për të kaluarën e të tashmen dhe lehtësi për të ardhmen.

Pjesa (وَيُؤَيِّيْ لَكُمْ مِنْ أَمْرِكُمْ مِرْفَقًا) "dhe përgatit për ju nga (vetë) çështja juaj lehtësi (dobi)". Allahu i madhërishëm është i Gjithëfuqishëm dhe mund t'i mbulonte me mëshirën e Tij pa thënë

"nga (vetë) çështja juaj", por Allahu (xh. sh.) ua vlerësoi punën dhe angazhimin atyre. Zakonisht Allahu i madhërishëm mrekullitë i ka sjellë si pasojë e një përpjekje të zellshme të një pejgamberi. Pra, edhe pse ato ishin mrekulli, përsëri i ka lidhur me një përpjekje të zellshme. Gjithashtu, kjo jep një mësim madhështor, ngase mrekullitë më të mëdha në botë bazën e kanë në përpjekjet dhe në angazhimin njerëzor, ku në fund lejen e mrekullisë e jep vetëm Zoti i madhërishëm. Kjo nuk do të thotë se mrekullitë janë rezultat i punës, por u janë dhënë vetëm atyre që janë simbol i punës dhe i zellit.

Kuptimi i fjalës مِرْفَقٌ *mirfekun*. Rrënja رَفَعَ *refeka* e ka kuptimin e butësisë, të afrisë dhe të shoqërisë (me vullnet); e kundërta e dhunës dhe e vështirësisë.¹ Shoku quhet رَفِيقٌ *refik*, sepse ai fitohet vullnetarisht dhe me të krijohet afri e qetësi. Fjala مِرْفَقٌ *mirfek* ka kuptimin e bërrylit, ngase bërryli është gjymtyra ku njeriu mbështetet dhe rehatohet.

Përveç kuptimit të bërrylit, fjala مِرْفَقٌ ka edhe kuptimin e mjetit që sjell *rifkun*² (butësinë, lehtësinë, shoqërinë dhe afrinë). Pra, sipas kësaj kuptohet se kuptimi i pjesës së fundit të këtij ajeti është thjesht dobi apo lehtësim, por bëhet fjalë për diçka më të madhe. Kështu që, Allahu nga tregimi i djelmohave nuk ka përgatit vetëm disa dobi apo lehtësime të caktuara, por atë e ka shndërruar në një mjet të rëndësishëm, i cili do të prodhojë vazhdimisht qetësi, butësi, dobi, lehtësim, afrim dhe shoqëri për shumë njerëz sa të ekzistojë kjo botë. Pra, ka dallim që një tregim të jetë thjesht dobiprurës dhe të jetë gjenerator i dobive të vazhdueshme.

Tani kur e kemi parasysh se sa njerëz janë në sikletin e banorëve të shpellës, të cilëve u shuhen krejt shpresat dhe u humb motivi për jetë apo punë, është pikërisht ngjarja e banorëve të shpellës e cila mund t'i motivojë për jetë, t'u ngjall optimizëm dhe t'ua hap dyert e suksesit. Kështu, kjo ngjarje shndërrohet në *mirfek*, në mjet që u fal qetësi, lehtësi, shoqërim dhe mbështetje.

¹ Salah Sultan, Sure el-Kehfi: menhexhijjatu fi islahi ve et-teg'jiri, Daru Sultan li en-Neshri, Kajro: 2008, fq. 40

² Hasen El-Mustafevij, Et-tahkuku fi kelimati el-Kur'ani el-Kerimi, vëllimi IV, Teheran, 1393 h., fq. 195-196

³ Po aty, fq. 198

kryejë namazin, do të jetë në praninë e më të Lartit, do të bashkojë duart e do të përkulet para Tij në shenjë mirënjohje e falënderimi për të gjitha të mirat që Ai i ka dhuruar. Njeriu do të përkulet para të madhit Zot dhe do t'i kërkojë ndihmë, mbështetje, qetësi...

Myezini me zërin e tij i thërret njerëzit, robërit e Zotit, në namaz, në shpëtim, në dëshmi.


Pejgamberi (a. s.) thotë: "Çdo xhind, çdo njeri dhe çdo send që e dëgjon zërin e myezinit, e dëshmon Ditën e Gjykimit."

MYEZINËT QË KAM NJOHUR...

Myezini duhet të jetë një person që i njeh mirë rregullat e fesë dhe të jetë njeri i devotshëm. Përgjithësisht, myezinët që kam njohur si: haxhi Emin abia, haxhi Bari efendiu, hfz. Ejup efendiu, hfz. Ferat efendiu, hfz. Rexhep efendiu dhe shumë të tjerë, të cilët tashmë janë bërë për rahmet - Allahu i pastë mëshiruar - kanë qenë prej atyre myezinëve që i kanë pasur të gjitha këto karakteristika. Kjo ma kujton Hz. Bilallin (r. a.) duke e thirrur ezanin me atë zë të këndshëm. Kur e thërriste ezanin Bilalli (r. a.), burrat e linin punën e tyre, gratë dilnin nga shtëpitë e tyre, fëmijët e ndalnin lojën - të gjithë këta, për t'u mbledhur në xhami, për të qëndruar krah për krah, për të adhuruar Allahun.

Të jesh myezin i denjë nuk është lehtë. Myezinët duhet të jenë të përpiktë në punën që e bëjnë. Ata nuk kanë një jetë të lirë dhe nuk e harxhojnë kohën ashtu shkel e shko. Myezinët duhet ta menaxhojnë ditën e tyre sipas kohës së pesë namazeve. Para se ta thërrasin ezanin, ata duhet të meditojnë, të pastrohen fizikisht dhe shpirtërisht, sepse kanë një detyrë shumë të rëndësishme: ata janë planifikues të kohës. Në shoqëritë islame, namazi është baza dhe strumbullari kryesor i jetës fetare, sociale dhe kulturore. Ne çdo manifestim fetar, kulturor apo shoqëror e kemi të lidhur me kohët e namazit. Emërimin e fëmijëve e bëjmë pas ndonjë namazi; po ashtu edhe dasmat, siç janë synetimi, martesat, niqahu, ahengjet e tjera... të gjitha këto janë të orientuara që të bëhen pas ndonjë namazi, qoftë ai i drekës, i iqindisë, i akshamit apo i jacisë. Takimet që i kemi me shokë, me miq e me dashamirë, bëhen pas kohës së kryerjes së ndonjë namazi.

Pa dyshim që këtë orientim në mënyrën më perfekte e bëjnë myezinët, duke e menaxhuar më së miri kohën dhe jetën shoqërore. E shihni që myezini është saktësisht i programuar?! Ai është njeri, por duke qenë i devotshëm dhe tërësisht i përkushtuar në profesionin që ka zgjedhur, ai



nuk ka kohë të vrapojë pas qejfeve dhe argëtimeve. Ai edhe gjumin e ka të programuar, sepse: "Es - salatu hajrum minen neum." (Namazi është më i mirë se gjumi).

Zëri i bukur i një myezini u jep gjallëri shpirtërore të gjithëve: edhe atyre që shkojnë në xhami, edhe atyre që falen nëpër shtëpitë e tyre, por edhe atyre që kanë ndërruar jetë.

Ndërsa për jobesimtarët ky zë mund të jetë, thjesht, një orë kumbuese që mund t'u kujtojë ndonjë takim apo punë që duhet bërë.

Por, ndodh të jetë edhe ndryshe.

Më kujtohen fjalët që thoshin jomuslimanët për ezanin, të cilin e thërriste myezini i Xhamisë së Eskit, Emin abia: 'Kur e dëgjoj këtë zë të bukur, ndalem dhe e dëgjoj deri në fund.' Ka pasur prej tyre që kanë qëndruar para xhamisë e disa kanë dalë nëpër ballkonet e tyre që ta dëgjojnë ezanin e tij. Pra, edhe pse nuk i kanë takuar fesë sonë, magjia e zërit të myezinit i ka tërhequr, i ka bërë ta dëgjojnë dhe të emocionohen. Pavarësisht përkatësisë fetare, pavarësisht besimit, bindjeve, ata me ëndje e dëgjonin ezanin që e thërriste

Emin abia.

Melodia që vjen me ezanin e ngre peshë shpirtin e njeriut, duke e bartur ashtu siç e bartin erërat e mira aromën e këndshme dhe për një çast bota të duket më e lumtur, më e gëzuar.

Zërin e bukur të myezinit nuk mund ta kompensojnë as minarja, as muret, as ndërtime e as arkitektura e xhamisë, sepse myezini me një zë të tillë është shtylla kryesore që i jep karizmën një xhamie dhe atyre që e dëgjojnë.

EJA NË NAMAZ! EJA NË SHPËTIM!

Myezini me zërin e tij të bukur dhe të ëmbël zgjon çdo kujtim, çdo ndjenjë, çdo emocion, duke kënduar dhe përsëritur kodin e thirrjes islame:

"Allahu është më i Madhi.

Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër pos Allahut.

Dëshmoj se Muhamedi (a. s.), është i dërguar i Tij.

Eja në namaz! Eja në shpëtim!"

A mund të ketë këngë që të tingëllojë më bukur se kjo?

Janë këto fjalë të një melosi të papërshtuar, të cilat i ndjen zemra dhe me intensitetin e atyre fjalëve përnjëherë shpeshtohet rrahja e zemrës. Pasi të dëgjohet ezani nga myezini, pasi të dëgjohet ky zë i bukur, trupit për një çast dridhet dhe përhumbet disa çaste në ishullin e dashurisë, atje lart, në botën e pazbuluar, ku askush nuk e cenon brishtësinë e ndjenjave tua.

Është një thirrje që kërkon ta kapërcesh gardhin e realitetit për t'u takuar atje ku frymëmarrja jote e herëpashershme e thyen heshtjen e pacenuar. Kur nuk e dëgjon këtë zë të bukur të ndonjë myezini, sikur brenda në ty diçka vlon, sepse zemra jote tani më është rrëmbyer nga kjo thirrje e bukur me një buzëqeshje dhe me ëmbëlsinë e kësaj buzëqeshjeje. Kjo vazhdon gjatë tërë kohës, deri sa përsëri të thirr ezani tjetër për namazin e radhës.

Ezani i bukur, i thirrur nga një myezin me zërin e bukur, është bota jote, është fladë që përkëdhel ndjenjat tua, është gjaku që shtyp zemra jote. Në ato momente ndalesh dhe mendon se nuk e di kujt i ke bërë një të mirë kaq të madhe që Zoti të bekon me këtë zë që të thirr në takim me Zotin! Thua me vete: o Zot, si mund ta harroj mirësinë Tënde dhe bekimet që m'i ke dhënë. Në ato momente asgjë më tepër nuk kërkon si kundërvlerë, por vetëm ta ndërpresësh punën dhe ta përkujtosht Atë.

Çdokujt do të doja t'ua tregoj këtë gjendje që përjetoj, por askush nuk mund ta shohë dhe ta kuptojë këtë dashuri që kam, sepse çdo kush ka dashuri dhe përjetimin e vet personal.

KU QËNDRON THELBI I KTHIMIT TË ISLAMIT BURIMOR

Duke iu përmbajtur burimeve islame, njeriu bashkëkohor do të mund të realizojë shikimin e vet islam dhe të inkuadrohet në progresin e përgjithshëm.

Shkruan: Prof. Ibrahim Idrizi
(Enkas për HeR)

Për këtë tematikë flitet shpeshherë në publicistikën bashkëkohore islame. Këtë më së shumti e kanë theksuar politicienët dhe dijetarët e botës islame në qëndrimet dhe orientimet e tyre. Kjo çështje për çdo ditë gjithnjë e më tepër bëhet tërheqëse edhe për vëzhguesit në botën myslimane dhe atë jomuslimane.

Çka qëndron në esencë të kthimit të Islamit burimor? Çka është shkaku për aktualizimin e kësaj çështjeje mu në kohën tonë? Këto do të ishin disa nga shumë pyetjet, përgjigjja e të cilave do të na shtyjë në njohjen e tërësishme të kësaj çështjeje aktuale: kthimi Islamit burimor. Në këtë artikull do të mundohemi që t'i cekim disa karakteristika themelore të kësaj çështjeje, si dhe të përgjigjemi në to.

ISLAMI, SHPALLJE UNIVERSALE E TË VËRTETËS

Prej fillimit e deri më sot njeriu ka qenë dhe është për mposhtjen e kundërtënieve- kundërshtimeve të

botës. Nga vetëdija mbi ato kundërtënie-kundërshtime lindi përvoja, sintetizohet urtësia historike; arrin t'i kuptojë njerëzit dhe veten. Shkaku i fundit i këtij kuptimi është ai i cili nga ajo transcendente, arrin deri te burimi i gjithçkaje. Kjo është shpallja e të vërtetës, prezenca reciproke e çdo njeriu, atij që është i mashtuar dhe i mësuar në mposhtjen e kundërshtimeve të botës.

Dhe, kështu me të ecurit nëpër botë, zgjat edhe shpallja e të vërtetës; sa më tepër të jenë të fuqishme dhe të ndërlikuara kundërshtimet, aq është më e madhe mundësia dhe përgatitja që njeriu ta njohë të vërtetën. Në qoshet e errëta të tokës, kur historia kishte rënë në kontrastet e pazgjidhshme dhe kur njeriu u fundos në kundërshtimet e veprës së tij, e vërteta shpallej përmes personave dhe njerëzve të zgjedhur, të cilët si pejgamberë të Allahut u bënë udhërrëfyes të njerëzimit.

Pasi që e vërteta është një, atëherë edhe mesazhi i të dërguarve ka qenë gjithmonë i njëjtë. Për atë shkak qëndrimi islam mbi barazinë e të gjithë të dërguarve të Allahut (xh. sh.) ka qenë i njëjtë; në të vërtetë,

qëndrim me të cilin Islami është thirrje e gjithëpërshkueshme e njeriut kah jetesa e harmonishme, me njohurinë dhe ndjesinë e ligjit të botës. Barazia islame e të gjithë të dërguarve të Allahut (xh. sh.) shpie në esencën e thirrjes dhe të luftës së tyre.

Të gjithë ata, në krahasim të asaj qenësie, kanë pasur situatë të veçantë historike të tyre, rrethana specifike të periudhave historike, të cilat kanë lypur zgjidhje të veçanta; natyrisht, duke iu dorëzuar plotësisht qëllimit të fesë.

Nëse në Kuranin famëlartë thuhet: “Ne nuk bëjmë dallim midis pejgambereve”, dhe duke pasur parasysh se të gjithë pejgambetë me pjesëtarët e vet i kanë zgjidhur kundërshtimet e kohës së vet, atëherë krejtësisht është e qartë se ai qëndrim i tillë kuranor i përket pikërisht përmbajtjes së gjithëdepërtueshme të fesë: të besosh Allahun (xh. sh.) dhe të jetosh për realizimin e të mirës.

Në kohën e Ibrahimit (a. s.) jetonte idhujtari i çoroditur i Mesopotamisë Luti (a. s.), i cili ka qenë i ballafaquar me tmerrshmërinë e ndjenjave të plota amorale në popullin e tij; violenca e faraonit përjetoj humbje në misionin e pejgamberllëkut të Musait (a. s.); Isai (a. s.), ndërkaq, zhvilloi luftë kundër çoroditjes së banorëve farizej...

Në historinë përplot kontradiktakundërshtime të gjithë ata, pejgambetë e Allahut, i kthehen njëherë e përgjithmonë të vërtetës, përkatësisht, asaj: të besosh Allahun (xh. sh.) dhe të jetosh për realizimin e të mirës. Ky është qëllimi universal i fesë, ky është caku i saj. E, mjetet për realizimin e këtij qëllimi janë të ndryshme, varësisht nga rrethanat e posaçme historike.

Në të vërtetë, Kurani është më i përsosur në përkufizimin e qëllimit dhe të mjeteve për të.

MJEGULLIMI DHE MBULIMI I QËLLIMIT TË ISLAMIT

Duke e lënë në trashëgim parimin e amshueshëm fetar, si dhe një numër aplikimesh të zbatimit, në zgjidhjen e kundërshtimeve në disa segmente të historisë, njerëzit dhe breznitë shumë shpesh e kanë humbur shikimin e qartë në kufijtë midis qëllimit të Islamit dhe realizimit të atij qëllimi. Shumë herë ata në periudhën e vizioneve dekadente kanë mbetur qëllime sa për sy e faqe, që në të gjitha rastet do të thoshte “kthim prapa”, kthim Islamit burimor.

Në ato rrethana mbuluese (kamu-

fluese) të qëllimit burimor të Islamit, shumë thjesht jo me kujdes dhe në mënyrë jokritike përvetësohet për të gjithë dhe për gjithçka, si qëllim, “sigurimi”, “argumenti” dhe “mbrojtja” e Islamit.

Kështu, feja rritet në konglomerat të besëtytnisë dhe të humbjes. Në krahët e asaj atëherë lindin drejtime dhe sekte të ndryshme, çka i vështirëson kundërshtimet në relacion botë-njeri, në vend të zgjidhjeve për to - që është qëllimi i fesë së vërtetë.

Islami përmes Muhamedit (a. s.) ka përjetuar përtëritjen e madhe të fundit, të tërësishme, definitive. Thelbi i mësimi të të gjithë pejgambereve të Allahut është sintetizuar në shpalljen e fundit hyjnore, në Kuranin famëlartë. Me një shqyrtim të qartë në rrethanat konkrete të kohës së vet, me vetëdijen dhe ndjesinë në interpretimin e shpalljes, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, Muhamedi (a. s.) dhe shokët e tij, brenda mundësive të tyre njerëzore, për një kohë të shkurtër arritën rezultate të shkëlqyeshme në luftë për qëllimin e Islamit.

Duke depërtuar me pranishmërin e tyre më thellë në botë dhe duke argumentuar dhe realizuar qëllimin e Islamit, myslimanët për një kohë të shkurtër riorientuan kahet e historisë dhe e ndërruan faqen e “botës së vjetër” dhe, kështu, i kontribuuan “rritjes” së qytetërimit bashkëkohor.

Mirëpo, në kundërshtimet e tyre që ia bënë botës dhe aksioni i pranishëm i myslimanëve, për shkak të papërgjegjësive së zhvillimit të mjeteve për arritjen e qëllimeve, plotësisht ngjet i mposhtur dhe i pasivizuar dhe pas pak kohe transformohet në sferën e dekadencës.

Ky segment i historisë, përveç tjerash, në vete përmban: rivendosjen e pushtetit dhe intuita kundër qëllimit të Islamit; jobarazi të besimtarëve, marrje të ideve degraduese për myslimanët etj. Kurani famëlartë për myslimanët në kohën e dekadencës pushon të jetë libri në të cilin qartë ndahet ajo esenciale nga ajo joesenciale, përmbajtja prej formës; ai bëhet objekt i virtuozeve vokalik dhe artistik, i afrueshëm vetëm për të zgjedhurit, e jo “për të gjithë njerëzit të jetë vërejtje”.

Në praktikën e myslimanëve hartimi historik në të arriturit e qëllimit të Islamit nga e kaluara i preferohet vetë qëllimi, derisa vetë qëllimi për myslimanët ekziston vetëm në verbërimin nebuloz dhe konfuzion larg rrjedhës së vërtetë jetësore dhe detyrave që kërkohen prej nesh.

Për të gjitha këto nebulozitete (mjegullina) të qëllimeve islame dhe të dekadencës së saj në segmentet e ndryshme historike të myslimanëve ekzistojnë shumë faktorë, të cilët drejtëpërsëdrejti apo tërthorazi ndikojnë në gjendjen e sotme të gjallërimit dhe kthimit Islamit burimor në përgjithësi.

PËRTËRITJA E PARIMEVE BURIMORE PËRMES ZBATIMIT TË TYRE

Rimëkëmbja e parimeve dhe aksionit islam, e cila fillon në kohën bashkëkohore, në literaturë - jo drejt - shumë shpesh njësohet me lëvizjet çlirimtare në botën myslimane. Prej vetë fillimit mbështetet pikërisht në zgjidhjen e çështjes themelore: afirmimin e përmbajtjes themelore të Kuranit.

Rimëkëmbja është, në të vërtetë, kthimi Islamit burimor, që porositet e tij të na bëhen pjesë e vetëdijes dhe pjesë e shikimit në botën tonë dhe në kohën tonë udhëzim për

pjesëmarrje aktive në misionin pozitiv të njeriut. E kjo supozon marrjen e monopolit në Kuran dhe kthimi i tij jetës dhe mendjes së shëndoshë. Kurani duhet të bëhet program i njeriut në jetë dhe pjesë e lirisë së tij, me të cilën natyra dhe shoqëria me punën-veprimin e njeriut në të do të bëhet shpjegues i tij themelor. Vetëm me parimet themelore islame, me të cilat qartë dallohet ajo e rëndësishmja prej jo të rëndësishmes, e vërteta nga e pavërteta, e mira nga e keqja, qëndron zhvillimi dhe përparimi i myslimanëve në këtë botë, kurse shpëtimi dhe shpërblimi në botën tjetër-ahiret.

Duke iu përmbajtur burimeve islame, njeriu bashkëkohor do të mund të realizojë shikimin e vet islam dhe të inkuadrohet në progresin e përgjithshëm. Me një prezantim të këtillë para myslimanëve bashkëkohorë, qëndron obligimi i shfrytëzimit të të gjitha mjeteve bashkëkohore të civilizimit modern, me qëllim që të realizohet qëllimi islam: të besosh Allahun (xh. sh.) dhe të jetosh për realizimin e të mirës. Kështu, me kthimin e Islamit burimor, gjithnjë e më tepër do t'i drejtohet të ardhmes dhe punës për të ardhmen. Myslimani inspirimet e veta veprues do t'i drejtojë sipas burimeve islame, që të mund ta vërtetojë pozitën e vet në këtë të cilën vetë e zgjodhi.

(Autori është Drejtor i Përgjithshëm i Medresesë Isa Beu, Shkup)



IMAM MUHAMED B. SYTARI:

RRUGA E MESME E FESË DHE RUAJTJA NGA EKSTREMIZMI

Ndërtimi i njeriut është më i rëndësishëm se ndërtimi i gurit.



Para ca kohësh isha ftuar në një konferencë ndërfaqetare, ku folëm rreth familjes dhe vendit të saj në Librat e shenjtë. Teksa përgatitesha për referatin e asaj konference, mendova ta nis me një fakt historik, që lidhet me Kinën e vjetër dhe murin e saj të famshëm. Historia thotë se, kur kinezët e vjetër u angazhuan për ndërtimin e murit të

famshëm, menduan se asgjë nuk do ta cenohte sigurinë e tyre pas ndërtimit të tij. Faktet tregojnë se në 100 vitet e para të periudhës pas ndërtimit të murit gjigant, Kina u përball me tri luftra. Në secilën prej tyre, armiku nuk kishte pasur nevojë të kapërcente murin a të tentonte prishjen e tij; kishte korruptuar rojet dhe kishte hyrë nga dyert e kështjellave... Sepse, ki-

nezët u angazhuan me ndërtimin e murit, por harruan ndërtimin e rojeve! Sepse, ndërtimi i njeriut është më i rëndësishëm se ndërtimi i gurit!

Sot, shpesh ndodh të përballemi me ndërtime e kështjella luksoze, në brendësinë e të cilave shpesh gjenden familje të shkatërruara, familje me probleme! Shtëpi në kulmin e luksit, ku djali nuk komuni-

kon me të atin, ku vajza nuk pyet më për nënën, ku vëllezërit kanë hasmëri me njëri-tjetrin, ku motrat nuk tolerojnë më në mes vete, ku shumë sjellje e tradita të brezit të shkuar nuk praktikohen më dhe janë zëvendësuar me tradita e sjellje shumë larg frymës së besimit!

Kam dëgjuar se dikur thonin: “Nëse dëshiron të shkatërrosh një civilizim, ke tri rrugë: shkatërrimin e familjes, shkatërrimin e arsimit dhe degradimin e shembullit! Që të shkatërrosh një familje, zhbëje rolin e nënës; bëje të turpërohet nga cilësimi: zonjë shtëpie! Që të shkatërrosh arsimin, nënvleftësoje vlerën e mësuesit në shoqëri, pakësoja pozitën, sa të bëhet qesharak para nxënësve të tij. Dhe, që të degradosh rolin e shembullit, sulmo dijetarët dhe mendimtarët, intelektualët. Fol keq për ta. Pakësoje pozitën e tyre, fut dyshime rreth tyre, derisa askush të mos dëgjojë më prej tyre a t’i ketë si shembull udhëzimi në jetë!” Prandaj, kur të mos ekzistojë më nëna si djep edukimi, mësuesi si brumosës me dije e kulturë, këshilltar frymëzues dhe, dijetari si shembull, kush do ta edukojë rininë dhe brezin e ri?

Dr. Sheuki Ebu Khalil, në librin e tij të famshëm: “Kush e humbi Kuranin?”, teksta trajton mirësinë e Kuranit në jetën praktike të myslimanëve, ndër të tjera thekson, se: [Fruti i parë dhe shembullor i mësimëve të Kuranit famëlartë ishte personaliteti i Resulullahut (a.s)... S’ka dyshim se ai ishte njeri me sjellje dhe edukatë engjëlllore. Dhe, Allahu qoftë i kënaqur me nënën e besimtarëve, Zonjën Aishe, e cila, kur u pyet për sjelljen e të dërguarit të Allahut (a. s), tha: “Sjellja dhe morali i tij ishte Kurani, kënaqej me pëlqimin e tij dhe zemërohej me zemërimin e tij.”]

TRE TË RINJ PYESIN RESULLAHUN (A. S.)...

Nga këtu, dua të sjell në vëmendjen tuaj një ngjarje të përmendur shpesh në predikimet fetare të imamëve dhe prijësve tanë islamë, ndër kohëra; atë të tre të rinjve që bashkëbiseduan dhe diskutuan në mes vete rreth adhurimit dhe pozitës së tyre në raport me fenë. Ja, si e paraqet sahabiu Enes ibn Malik (r. a) këtë ndodhi dhe reagimin e Resulullahut (a. s): [Tre të rinj erdhën në shtëpinë e Profetit (a. s) dhe pyetën për adhurimin e tij. Kur mësuan për të dhe e krahasuan me veten e tyre, e gjetën adhurimin e tyre shumë larg dhe thanë: Po ku jemi ne me të dërguarin e Zotit (a. s), atij ia ka falur Allahu krejt gjynahet e bëra dhe të pabëra! I pari prej tyre

tha: “Unë do të falem krejt natën, përgjithmonë!” I dyti tha: “Ndërsa unë do të agjëroj krejt jetën, nuk do të prish asnjë ditë!” I treti tha: “Ndërsa unë do të distancohem nga gratë dhe nuk do të marthohem kurrë!” Kur i dërguari i Allahut mësoi për vendimin e tyre, erdhi, i takoi dhe u tha: “Ju jeni ata që keni thënë këshutu e ashtu? Ndërsa unë, pasha Allahun, jam më i përkushtuari ndaj Allahut ndër ju dhe ai që i frikësohem më së shumti Atij! Por, unë edhe agjëroj (jashtë Ramazanit), edhe jo! Edhe falem natën, edhe flej! Dhe, marthohem! Prandaj, kushdo që devijon nga tradita ime, ai nuk është prej meje!”].ⁱⁱ

Kjo ngjarje ka një mësim të madh për krejt ne, është një shtysë drejt ruajtjes për të mos e keqinterpretuar fenë, për të mos përzier dëshirat personale dhe interpretimet vetjake me thelbin e fesë dhe dome thënien reale të teksteve të shenjta. Sepse, në të kundërt, pasojat do të jenë të palavdëruara: ekstremizim i fesë dhe teksteve të saj, devijim i shpirtit real të teksteve dhe prishje e ekuilibrave social në shfaqjen e myslimanit/ëve në jetën e përditshme.

Dhe, mendoj se në këto 25 vite të fundit ka plot shembuj dhe raste, kur individë a grupe shoqërore kanë devijuar tekste tona fetare, kanë keqinterpretuar e keqprezantuar fenë dhe teksteve të saj, duke krijuar stereotipe me nuancë fetare në realitetet tona.

Unë mendoj se mungesa e edukatorëve të mirëfilltë islamë dhe leximet e paekuilibruara të fesë shkaktojnë sjellje ekstreme në raport me leximin dhe më pas praktikimin e fesë në jetë.

Imam Ebu Hamid el-Gazali tregon për një shpallje hyjnore në *Teurat*, ku Zoti i gjithësisë i drejtohet njeriut me këto fjalë: “O rob i Im, a nuk të vjen turp prej Meje?! Kur të vjen një dërgesë nga një prej vëllezërve të tu, teksta je duke ecur në rrugë, ndalesh, ulesh dhe nis ta lexosh atë fjalë-fjalë, duke u munduar të kuptosh përmbajtjen... Dhe, ja ku është Libri Im, që ta zbrita. Shih si t’i kam sqaruar fjalët dhe t’i kam përsëritur ato, që të meditosh në kuptimet e tyre. Ndërkohë, ti largohesh prej tyre! A isha më pak se vëllezërit e tu, për ty?”

O rob i Im, kur të vjen ndonjë prej vëllezërve, ulesh pranë tij me fytyrë të qeshur, ia dëgjon fjalët me zemër, saqë nëse dikush ndërhyrja a të shqetëson me zhurmën e tij, i bën me shenjë që të heshtë, për të dëgjuar mikun tënd... Dhe, ja ku të afrohem dhe të flas, ndërkohë që ti largohesh me zemër nga Unë! A po më konsideron më pak se një prej vëllezërve të

tu?!”ⁱⁱⁱ

Hafiz Ali Korça (1873-1957), në maj të vitit 1925, shkruan: “Kurani i madhënueshëm është nga ato muxhize që le gjer ditën e sotme që vleftën e ka mbajtur, por edhe sa të jetë jeta ka me e mbajtur... Pra, Hazreti Kurani është një muxhize e përhershme, e përgjithëkohëshme dhe e pavdekshme. Si mund të vdesë, kur folës i tij është Zoti i vërtetë, Vetë!

...

Sa për disa Zotëni që akoma s’dinë pesë fjalë arabisht, qysh mundin të thonë se Kurani është kështu e ashtu!

...

Përse ta zgjatim, sanscrita që mban librin e shenjtë Zind (Zend) vdiq, gërqishtja e vjetër vdiq, latinishtja vdiq, ibranshtja vdiq. Edhe shumë gjuhë të tjera që përmbanin nga një libër të shenjtë vdiqën dhe në vënt të tyne lindën të tjera, por gjuha arabishtë në hije të mirakullisë të H. Kuranit hala rron, edhe sa të jetë bota do të rrojë! Edhe ndaj, populli mysliman do të mbretërojë!”^{iv}

Pra, me fjalë të tjera, ne kemi nevojë të menjëhershme ta lexojmë drejt e ta kuptojmë si duhet fenë, mësimet e saj, moralin e saj, shpirtin dhe thelbin, me të cilin u shpall për njeriun, që jeta e jonë në këtë botë të jetë sa më e qetë dhe individ mysliman, i ruajtur, i matur, mesatar!

ZANAFILLA: PRIRJA MORALE DHE SHPIRTËRORE E SECILIT

Të dashur lexues!

Tema e ekstremizmit dhe mesatarizmit, si dy koncepte diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën, lidhet në zanafillën e saj me sjelljen dhe prirjen morale e shpirtërore të secilit. D.m.th. një individ i edukuar, i ruajtur, i kulturuar, është e vështirë të devijojë në ekstremin e keqpërdorimit të teksteve fetare. Këtë e vërteton edhe realiteti i shumë të rinjve të pashkolluar e të paformuar intelektualisht, që duke u lidhur pas një boshti të caktuar argumentesh dhe faktesh të keqlexuara fetare, nisin dhe e dëshmojnë fenë në aparenca dhe lëvizje, që i bëjnë të dallueshëm nga të tjerët. Të mbyllur, të ngurtë, të ngrysur, të gatshëm për të kundërshtuar, të pamundshëm për të toleruar, të nxituar, me pak fjalë, ekstremisht të paformuar!

Imam Ibn Kajim el-Xheuzije (691-751), teksta ndalet pikërisht tek ndikimi i epsheve dhe egoja në jetën e njeriut, shkruan: [Domosdoshmërisht duhet të dimë se gjynahet dhe devijimet dëmtojnë dhe se dëmi i tyre për zemrën është si



helmi për trupin... Çfarë i nxori dy prindët tanë nga xheneti, vendi i kënaqësive, dritës e gëzimit, drejt vendit të dhembjes, mërzive dhe fatkeqësive? Çfarë e nxori Iblisin nga mbretëria e qiellit, duke e dëbuar e mallkuar?... Çfarë i bëri për mbytjen e bano-rëve të tokës, saqë uji mbërriti deri mbi majat e maleve? Çfarë u bë shkak që erërat e forta të përpinin popullin e Adit, duke i hedhur të vdekur mbi faqen e dheut?...

Çfarë u bë shkak që fshatrat e popullit të Lutit të përmbyseshin mbi ta, duke i shkatërruar tërësisht si popull dhe duke u pasuar ky shkatërrim me gurë që bienin nga qielli, si dëshmi e një ndëshkimi të paprecedent? Çfarë u bë shkak që mbi popullin e Shuajbit të vërshonin retë e ndëshkimit, si hije të forta, prej të cilave dilte zjarr shkatërrues? Çfarë u bë shkak që Faraoni dhe njerëzit e tij të mbyteshin në det...?

... Në “Musned-in” e Imam Ahmedit, transmetohet nga Umi Seleme, që thoshte: E kam dëgjuar Resulullahun (a. s) të thoshte: “Kur të shfaqen gjynahet në ymetin tim, do t’i përfshijë Allahu me një ndëshkim nga ana e Tij” - I thashë: O i dërguar i Allahut, a nuk do të ketë njerëz të mirë atë ditë? - Tha: Do të ketë! - I thashë: Po çfarë do të bëhet me ta? - Tha: Do të goditen nga ajo që do të godasë njerëzit, pastaj do të shkojnë në faljen e Allahut dhe pëlqimin e Tij”].^v

Ja realitetet e botës arabe islame, sot. Ja Egjipti, Siria, Iraku para tyre, ja Libia, ja Tunizia, ja Palestina e shumë e shumë raste e shembuj në këtë kontekst. Sheh Qazim Hoxha (1893-1959), njëri prej shkollarëve të njohur shqiptarë në shekullin që kaloi, në një prej vaseve të

tij të regjistruara me shkrim, thotë: “Pra, vllazën të dashun, n’Ahiret kena me u pyetë për veprimet e kësaj bote. Për veç shumë ajeteve të Kuranit që flasin për ketë llogaritje, ka edhe shumë hadithi sherife që bëjnë fjalë për këtë punë. Do të shkante shumë gjatë me i përmendë këtë ajete e hadithi sherife; por ne po përmendim vetëm një hadithi sherif: “La tezulu kademâ abdin hatta jus-ele ân erbeîn: ân ûmrihî fîme efnâhu, ve ân xhesedihî fîme eblâhu, ve ân îlmihî fîme amile bihî, ve ân malihî min ejne iqtesebehû ve fîme enfekahû.” Don me thanë: “N’Ahiret njeriu nuk mund të luejë asnjë këmbë për pa u pyetë për katër gjana: për jetën si e harxhoi, për trupin në ç’punë e shtiu, për dijen si e harxhoi, për mallin si e fitoi e ku e harxhoi”.

Pika e tretë s’i përket vetëm Hoxhës, sepse gjithsecili mund të dijë diçka e do të pyetet për aq sa di. Bije fjala secili e din se kamata, fajdexhillëku është punë e ligë; pra do të pyetet se a u kallzoi njerëzis që këjo punë është e ligë dhe e ndalueme prej Perëndisë.”^{vi}

Pra, kur flasim për tematika të tilla si mesatarizmi a ekstremizmi në raportet e njeriut me fenë, fillimisht duhet të ndalemi tek edukimi, te leximi i saktë i teksteve fetare dhe te vullneti individual për ta përhapur sa më shumë shembullin fetar në realitetet shoqërore.

Në mbyllje, dua të sjell në vëmendjen tuaj shënimet e studiuesit islam të afirmuar, dr. Salahudin Keftaro, kur thotë: [Sa shumë e dëmtojnë fenë disa praktikantë të fesë!? Ndonjëri prej tyre ndjek me korrektësi faljen e namazeve me xhamat në xhami, por ai është i pasjellshëm me gruan dhe fëmijët e tij! Ndonjëri prej tyre mburret me gjatësinë e mjekrës që mban, por mashtron në shitblerjen e tij!

Shohim një të mbuluar, që ndjek me përpikëri ligjëratat e ndryshme javore, por është e paedukatë me nënën e saj! Shohim një ndjekës të takimeve periodike të edukimit dhe udhëzimit fetar, por që shquhet për thashetheme dhe ndezjen e ngatërresave në mesin e njerëzve! A është kjo feja? Jo, vëllezërit e mi! Origjina e dërgesës së profetit të nderuar dhe qëllimi i saj përmbledhen në thënien e tij (a. s): “Jam dërguar të plotësoj mirësjelljen!”].^{vii}

Stereotipet e ekstremizmit fetar, si në hadithin e lartcituat, duhet të trajtohen me kujdes, ndërkohë, të gjithë ne jemi të ftuar ta jetojmë fenë tonë në normalitetin e kuptimit të saj, larg euforisë dhe ndjenjës së madhështisë individuale mbi të tjerët!

(Autori është Myfti i Zonës Shkodër dhe një ndër hoxhallarët më të njohur shqiptarë. Shkrimi këtu është bërë enkas për “Hënën e Re”).

ⁱ Dr. Sheuki Ebu Khalil, “Men dajjaal-Kuran”, botimi i tretë, Damask, 1986, fq. 96.

ⁱⁱ Transmetuar nga Bukhariu dhe Muslimi, nga Enesi (r. a).

ⁱⁱⁱ Ebu Hamid El-Gazali, vep. e cit., vëll. I, fq. 365.

^{iv} H. Ali, “Muxhizet e Hazreti Kuranit”, revista “Zani i Naltë”, nr. 3, vit’ i II, Tiranë, 1925, fq. 451-458. (Nga kolana “Zani i Naltë”, vëllimi i parë: 1923-1924-1925, botimet KMSH, Tiranë, 2014). (Me përshtatje të lehtë. M.S.)

^v Imam Ibn Kajim El-Xheuzije, “Ed-dau ved-devau”, botimi i parë, Bejrut, 1990, fq. 57-59.

^{vi} Sheh Qazim Hoxha, “Ç’urdhënon Kur’ani?”, tema: “Përse njeriu ka ambicje?”, në revistën “Zani i Naltë”, viti XIII, Kalinduer-Fruer 1938, nr. 1-2, fq. 4-7.

^{vii} Nga publikimet e tij në profilin zyrtar në fb, më 17 shkurt 2016.

SFIDAT E ARSIMIMIT DHE TË EDUKIMIT NË ISLAM (3)

Ekstremizmi, më saktë, mund të definohet si një lloj sjelljeje e atillë sociale që "vegjeton" gjithnjë midis asaj që është e lejuar dhe asaj që është e sanksionuar! Pra, ai është sikur një lloj "parakalimi" mbi një zonë të "minuar"! Për nga numri, ekstremistët asnjëherë nuk janë shumë, por janë zhurmues dhe fanatikë në qëllimet dhe synimet e tyre! Çfarëdo qofshin, dhe prej kujtdo qofshin ato!

Pa dashur të arsyetoj këtë tendencë të re rikonolizuese perëndimore, që botën e arealit islam e trajton kryesisht si "periferi", ndërkaq veten si "qendër", më duhet të analizoj pak a shumë projektin e "kontrollit" apo të "menaxhimit" (për të mos thënë: nënshtrimit!) që ajo i bën gjithë botës. Projekt ky që ndihmohet shumë nga "rezistenca" (tipike naive, e stilit të ksenofobisë: "Islami ka zgjidhje...", por, pa ofruar asnjë alternativë!) autoktone myslimane, që i bëhet dijës, arsimimit dhe vlerave perëndimore në përgjithësi.

Edukimi dhe arsimimi sot, në botën islame, për mendimin tim, përveç tjerash, po ballafaqohet me disa sfida sa interesante, aq edhe të mjegullta.

Njëra sfidë, që kujtoj se është produkt i stereotipeve dhe paragjykimëve, që në start përfshin mënyrën e edukimit dhe të arsimimit në botën perëndimore, për gjoja produktet shekullare që s'mund të kooptohen në jetën dhe në praktikën islame, për shkak se "janë në kundërshtim me vlerat dhe kulturën e komunitetit islam në përgjithësi".

Dhe sfida tjetër, që për mendimin tim gabimisht projektohet dhe identifikohet, në objektivat ka të kaluarën e ndritshme islame (kur, pra, Islami ishte në kulmin e arritjeve të veta, si kulturë dhe si civilizim), si diçka të shenjtë, të paarritshme, ideale; pra, thënë më thjesht, utopike!

Ndërkaq, pak apo shumë pak autorë islamë hasi të cilët zgjidhjen e gjithë kësaj ngecjeje e shohin dhe e projektojnë si diçka të ndërmjetme midis këtyre dy sfidave. E ajo rrugë e tretë, apo alternativë, kujtoj do të ishte një zgjidhje shumë më "ekonomike", në një mënyrë apo tjetër ka të bëjë me një përpjekje të re për ta humanizuar sistemin vleror që ka sa dekada që gjendet në krizë serioze, sidomos në sferën shpirtërore...Pra, cila do të

ishte oferta serioze islame në këtë konkurrencë globale?

Në fakt, unë mendoj që këtë projekt alternativ as që mund dhe as që duhet ta ofrojnë dhe ta negociojnë dijetarët fetarë (i njohur përgjithësisht si kler), por elitat e reja shkencore nga të gjitha sferat e jetës. Rilindja e Islamit duhet të synojë një reformim strukturor fundamental, pra një lloj rizbulimi dinamik të traditës kulturore civilizuese, ku dija, arsimimi ishin alfa dhe omega e gjithë ekspansionit social, politik, ekonomik e kulturor.

RENDI I RI BOTËROR (GLOBALIZMI)

Ne sot po jetojmë në një botë të globalizuar dhe të dominuar nga vlerat dhe kultura perëndimore. Këtu, s'kemi asnjë dyshim, por, për t'i mënjeluar të gjitha ato hipoteza, paragjykimet dhe stereotipi që po mundohen t'ia amputojnë Islamit (jo myslimanëve, sepse bota perëndimore s'e ka problemin me myslimanët, por me Islamin si: botëkuptim, vlerë, sistem jetese, kulturë dhe praktikë fetare globale, por edhe si konkurrencë civilizuese), atij nga vetë elitat kulturore dhe shkencore u duhet një lloj "protestantizmi", pra, një lloj ristrukturimi dhe akomodimi me rrethanat dhe botëkuptimet e reja civilizuese.

Ky proces ristrukturues, apo ky lloj "protestantizmi" i brendshëm në vendet dhe në shtetet e botës myslimane s'mund të bëhet nga jomyslimanët, për shumë arsye.

Njëri, që kam bindjen se është dominues, ka të bëjë me procesin e ish-kolonizimit nga bota perëndimore, që po shihet se kjo "terapi" s'po jap rezultate, por, përkundrazi është duke i shtuar dhe thelluar si paragjykimet, ashtu edhe zbehjen e imazhit ndaj vetë Islamit dhe myslimanëve në përgjithësi. Pra, ristruk-

turim nga standardet dhe kriteret jomyslimane, as që mund të imagjinojmë, edhe për shkak se kemi një "testim", apo një metodologji të sprovuar në shekujt e kaluar, kur vendet myslimane ishin koloni të Perëndimit.

Gjithashtu, një tjetër problematikë shqetësuese ka të bëjë dhe me kontekstin interpretues që i bëhet sot Islamit dhe përgjithësisht mësimëve që dalin nga logjika e interpretimit.

Pra, ka këtu një diskrepancë në masë serioze, që kujtoj se mund të adresohet edhe për faktin se: konteksti i shpjegimit s'është asfara ne koherencë me kohën tone, pra shek. XXI. Konteksti historik, e sidomos ai i idealizuar për se tepërmi, kemi mësuar si leksion se jo gjithmonë është edhe mësim për kohën dhe kontekstin kohor kur shpjegohet apo interpretohet një përvojë e çfarëdo natyre qoftë ajo.

Pra, mbyllja apo hermetizmi, për të mos me thënë konservimi i interpretimit dogmatik, na e ngufat Islamin burimor, nëse me këtë kontekst burimor nënkuptojmë Islamin e praktikuar nga koha e Muhamedit (a. s.) dhe gjeneratave pasuese të tij.

KEQINTERPRETIMI I SHERIATIT

Kjo mënyrë e të gjykuarit për fenomenet, ngjarjet, problemet dhe zhvillimet aktuale është dëshmuar si tejet e ngurtë dhe pa invencion. P.sh. sot shumica e botës myslimane beson që Sheriatit (apo jurisprudenca islame), në fakt, është një ligj hyjnor, ndërkaq, në të vërtetë kjo shumicë absolute fare s'e di se ky ligj, ky kodifikim, është pjellë debatesh, konsultash, negocimesh...etj. të mendjeve me të ndritura islame në kohën kur u formulua.

Tani, legjislacioni i Sheriatit, i ndër-

tuar dhe i legjitimuar në kohën kur kishte motive të bollshme që Shteti Islam të ketë një lloj legjislature sociale, juridike, politike, ekonomike e kulturore ishte tejet fleksibil dhe i arsyeshëm, por për kohën në të cilën po jetojmë ne, ai duket të mbetet vetëm një "këmishë" shumë e ngushtë për nevojat, kërkesat dhe synimet e gjeneratave të internetit, bie fjala!

Shikuar me këtë dioptri, kujtoj që thënia Islami "i rregullon juridikisht të gjitha raportet përmes Sheriatit" 4) ka mbetur peng i interpretimit të këtij legjislacioni johyjnor, "sepse vetëm Kurani është i tillë" 5) dhe "...se ai është i pandare nga jeta e fesë...dhe parakusht esencial për mirëqenie materiale, morale dhe shpirtërore" 6), në këtë normë legjislative (thënë më thjesht, edhe të një kaluar të artë), me këtë tufë legjislative ne, në fakt, e rizbulojmë paaftësinë tonë për t'u akomoduar me atë tolerancën, me hapjen subtile, pra me emancipimin e gjithmbarshëm social, politik, juridik e kulturor të Islamit.

Islami i mirëfillte, në të vërtetë, s'guxon fare të mbetet monopol ekskluziv vetëm i elitave të edukuara pamjaf-tueshëm fetare! Edhe këtë, për disa arsye: njëra, kishte me qenë se të njëjtit në mungesë të një dije kompatible, komplementare dhe shumëdimensionale bashkëkohore për jetën, ekonominë, historinë, kulturën dhe civilizimin islam, do të ishin më shumë në dëm sesa në dobi të vetë Islamit.

Arsyeja tjetër, e këtij lloj "shpronësimi", ka të bëjë me atë se: duke qenë i anatemuar dhe i paragjykuar nga proceset dhe zhvillimet aktuale globale, të njëjtit (pra, elitat ekskluzive fetare!) do zgjonin më shumë përbuzje dhe neveri në publik sesa që do të sillnin dobi. Islami nënkupton një kontekst shumë më të gjerë dijesh dhe njohjesh sesa që janë ato religjioze.

A MUND TË BASHKËJETOJË ISLAMI ME SHEKULLARIZMIN?

Shekullarizmi, tashmë veç është evident, sociologjikisht si një proces i hapur tipik social, i cili ndjeshëm dhe në mënyrë të padyshimtë po e ushtron ndikimin e vet të padikutueshëm. Në fakt, ai është një mënyrë e këndvështrimit se si bota pëson ndryshime (kisha me thënë, të paevitueshme!) sociale, ekonomike, politike etj., ani pse mund të ndodhë që kjo qasje e tillë të lë gjurmë në formacionet dhe konstruktet mentale të vendeve, shteteve të ndryshme. "E ardhmja fatlume e Islamit është kur shkenca të

bëhet krahu më i forte i interpretimit të Shpalljes Hyjnore, të Kuranit famëlartë...Shkenca duhet t'i zëvendësojë hamendjet e dijetareve që bazohen në shkollat e vjetra juridike disashekullore dhe analogjitë që shpeshherë janë burimi i interpretimit të manipuluar fetar..." 7) Mund të supozojmë me doza dyshimi, që s'mund të ndodhë që në një shoqëri të mos këtë të instaluar laicizëm (si te ne p.sh. Neni 8...) e te mos këtë ndodhur procesi i shekullarizimit paraprakisht! Pra, nëse nisemi nga etimologjia e fjalës për këtë term që sot në botën moderne është familjarizuar aq shumë, atëherë shekullarizmi, në fakt përfshin jo sistemin e të menduarit dhe gjykuarit kolektiv të një shoqërie, por vetëm sferën e religjionit, ku ai si imperativ të qëllimshëm e ka ridefinimin e praktikave të një vendi që ka p.sh. probleme të mëdha identitare, sidomos, në periudhën e transformimeve. Andaj, varësisht nga ajo se cili drejtim ideologjik do të dominojë, "do të afirmohet ideja e Islamit të hapur, bashkëpunues, jokonservativ dhe tejet koherent me zhvillimet aktuale globale, ose e Islamit retrograd, totalitarizmit politik apo Islamit të vetëmjaftueshëm kulturor". 8)

Andaj, kujtoj që e ardhmja e Islamit qëndron pikërisht në bazamentet shkencore, pra kur dija dhe shkenca do të bëhen krah i djathtë i Shpalljes Hyjnore, të Kuranit famëlartë, e jo i ideologjive dhe formacioneve të ndryshme, të çfarëdo natyre qofshin ato.

NJË MILION PYETJE E (AS) NJË PËRGJIGJE NË PLANIN (GJITHË)KOMBËTAR!

Një milion pyetje e pak përgjigje, është një projekt gjithëkombëtar, i cili duhet të shtrihet, kujtoj, në dy rrafsh: njërin, siç e quaj unë të brendshëm dhe që ka të bëjë gjithësesi me proceset, problemet, dilemat, sfidat dhe mënyrën se si ne së bashku me shtetin shqiptar, Shqipërinë, duhet t'i sinkronizojmë në kuptimin e formimit të një qëndrimi të vetëm dhe unik në përbashkë me proceset tjera globale, e thënë më qartë proceset integrative evropiane. Rrafshi tjetër që kërkon pa dyshim një agjendë dhe përkushtim tjetërfare, edhe me faktin se kriteret dhe standardet nuk i caktojmë ne, por institucionet në ngritje të BE-së, ndërkaq çështja më e rëndësishme në gjithë këtë debat, që kujtoj në kohë dhe moment të duhur duhet të bëhet edhe publik, ka të bëjë me dilemën se si duhet ta shpejtojmë ritmin e proceseve në fjalë?

Pra, a mund të bëhen pengesa serioze çështja e mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana pesë vendeve evropiane në këtë rrugëtim, a kemi mjaft kapacitete administrative për t'i përmbushur të gjitha obligimet dhe kriteret strikte teknike të parapara nga BE-ja për çdo vend para se të anëtarësohet në këtë konstrukt të ri? A ka ide se si duhet të gjendemi në rast se ky projekt integruar dështon; cilat opsione dhe plane rezervë duhet t'i ketë në tavolinë Kosova? A ka debat se duhet të hyjmë si Kosovë, apo si të bashkuar (me Shqipërinë) në një shtet në BE? Çka e pengon debatin e kësajsoj në nivel politik, cilat janë ato pengesa lokale dhe sosh globale? Çfarë kapacitetesh politike, ekonomike, sociale e kulturore duhet të ndërtohen ndërkohë?

A ka përllogaritje se është më mirë të integrohemi ndaras si dy shtete, apo si një shtet i vetëm unik në Ballkan? Çfarë duhet t'u paraprijë këtyre proceseve të brendshme integruese midis dy shteteve aktuale? Janë elitat politike, ekonomike apo ato kulturore? Sa kohë marrin ato? Çfarë kostoje ka i gjithë ky projekt i integritetit të brendshëm? Në këtë rrugëtim të integritetit të brendshëm a ka, dhe cilat janë ato, sfida të cilat në bazë të një eksplorimi empirik eventualisht mund të bëhen pengesa të pakapërcyeshme në proceset tjera integruese evropiane? Pastaj, cilat interesa lokale përputhen me interesat globale dhe si mund t'i materializojmë në nivel gjithëkombëtar këto interesa, në mënyrë që të mos përsëritet sindroma historike e ngecjes dhe anatemimit nga të tjerët? Cilat potenciale ushtarake, duhet ta fuqizojnë idenë e sigurisë dhe të mbrojtjes...? Me çfarë agjende: politike, ekonomike, ushtarake e kulturore duhet t'i joshim dhe t'i afrojmë interesat e lidërshipit botëror në këtë pjesë të Ballkanit? A duhet të kemi edhe planin B, në rast të kontestimit të këtij Projekti (mbarë)kombëtar?... E një milion pyetje, çështje e dilema që lipsen të kenë përgjigje të duhur, në momentin e duhur dhe në vendin e duhur...

Gjithashtu, çështje që kujtoj se duhet të debatohej apo të paktën të futet ndoshta në agjendë të politikës shkak i dinamiks së proceseve që mund të ndodhin ndërkohë me një shpejtësi mar-marandëse, është pa dyshim edhe ajo se si t'u shpjegohet i gjithë ky projekt dhe ide qytetarëve? Unë këtu nuk aludoj në mënyrën e propagandimit, por në hapat e domosdoshëm (elementarë) që duhet ndërmarrë në këtë drejtim, në mënyrë që ata ta kuptojnë dhe ta ndjejnë interesin e

tyre jo vetëm ekonomik, por edhe social e kulturor.

Një tjetër pistë investigimi pa dyshim që kujtoj se duhet orientuar edhe kah subkulturat e politikave dhe institucioneve ekzistuese, të cilat pa fajin e tyre kanë pak apo aspak informacione lidhur me: procedurat, mënyrën, formën, përmbajtjen dhe efektet dobiprurëse për vendin që mund të ofrojë procesi i integrimeve evropiane. Këtë detyrë të “njohjes” apo furnizimit të parlamentarëve të ardhshëm, si edhe institucioneve tjera, do të duhej ta marrë përsipër shoqëria civile përmes organizimit të tryezave, konferencave, si edhe shtypjes së broshurave dhe mënyrave tjera senzibilizuese e lobuese.

Mendoj definitivisht që Kosova u takon atyre shoqërive të rralla dhe pa dyshim edhe të fundit politike në Evropë, ku gati të gjitha çështjet fundamentale për t’u bërë një shoqëri normale, janë të hapura...Për Shqipërinë kujtoj që duhet një skanim tjetërfare, ngase atje demokracia dhe ndërtimi i shtetit filluan më heret dhe natyrisht që edhe prodhuan procese e zhvillime socio-kulturorë me specifike.

Kur po e bëja gati për botim këtë shkrim, një koleg më tha se shkrimet e mia kryesisht po merren vetëm me diagnoza të shoqërisë sonë, por jo edhe me terapi... Përgjigjja ime ishte, dhe akoma mbetet, se puna e terapisë na takon vetem aq sa ne i pushtojmë dhe i “pronësojmë” ato, në mënyrë që t’i fusim në funksion të synimit të lartecur për integrim në Evropë. Sa kisha të drejtë, le të gjykojnë lexuesit dhe kompetentët së bashku me ata që janë “pronarë” të vërtetë të këtij projekti?!

E VËRTETA SHKENCORE MBI "TË VËRTETËN" ISLAMOFOBE

Është një thënie e njohur diku që thotë: "Urrejtja ndaj Islamit po bëhet gjithnjë më e madhe, sesa dashuria ndaj demokracisë" (!), ose: se dashuria ndaj demokracisë po bëhet gjithnjë më e vogël, sesa urrejtja ndaj Islamit"! Gjithashtu, edhe një tjetër që thotë: "Largohuni nga ekstremizmi në fe, sepse ekstremizmi dhe pamaturia në fe i kanë shkatërruar ata që kanë qenë para jush!"

Qytetarët e rëndomtë shqiptarë nuk kanë ndonjë arsye të theksuar që t’i frikësohen Islamit burimor, ose, nuk kanë arsye ta urrejnë Islamit si fe me parime dhe fundamente monoteiste, paqësore! Ngase, çështja e cilitdo besim mbrohet, garantohet dhe kategorizohet me legji-

slacion dhe me Kushtetutë dhe me ligje. Ata kanë arsye shumë më tepër që t’u frikësohen interpretuesve injorantë, mediave dhe rrjeteve islamofobe dhe sidomos mercenarëve të frustruar islamë e joislamë!

Në kushtet dhe rrethanat e disa proceseve dhe zhvillimeve globale, paragjykimi i Islamit si fe monoteiste (së bashku me Krishterimin dhe Judaizmin), sot në mediat globale dhe rrjetet sociale është në rritje e sipër! Ajo çka është më shqetësuese, është fakti që interpretimet nuk po bëhen nga ekspertët profesional dhe njerëzit kompetentë të fushave dhe lëmenjve përkatës, por nga mediokrit medialë, pastaj nga islamofobët dhe grupet e ndryshme dogmatike të proveniençës islame dhe joislame.

Natyrisht, interpretimet e tilla jo-kompetente sjellin edhe stigmatizim e stereotipizim, që e vështësojnë depërtimin e vizionit paqësor të Islamit të vërtetë! Dhe, si pasojë e gjithë këtij “mobiliteti” dosido antiislam, paraqiten edhe tendenca monopoliste mbi të “vërtetën” e vërtetë islame! Thënë me thjeshtë, paraqiten devijime apo ekstremizma të të gjitha llojeve dhe ngjyrave. S’këndejmi, këtyre tendencave nuk mund t’u ikin as shqiptarët e Ballkanit, e as boshnjakët që rastësisht apo jo rastësisht mbetën myslimanë me përkatësi fetare! Tani, koha e globalizimit (si më tha një mik një ditë: “na çoroditi” krejt!?) është e vërtetë, kohë që ka prodhuar shumë armiq dhe shumë mundësi të keqinterpretimeve, për këto religjione monoteiste, e në veçanti për Islamit! Shqiptarët, s’ka shans që të implikohen në këto “lojëra” morbide dhe të qëllimshme globale, për një arsye shumë të thjeshtë: ndjenja kombëtare gjithnjë ka qenë shumë më e fortë se ndjenja fetare. Por, ata, fakt, që do atakohen edhe për një kohë me stigmatizime e paragjykime nga më të ndryshmet, si nga “qendrat” islamofobe, ashtu edhe nga mediokritet mediatike, të cilat, të frustruara dhe të frymëzuara nga trendet globale, përpiqen t’i konfrontojnë gjoja “dallimet” fundamentale midis religjioneve monoteiste! Midis këtyre qendrave “islamofobe dhe joislamofobe”, pa dyshim që sot më të “afirmuarit” dhe më të zëshmit në sferën e sigurisë politike e sociale, e sidomos kulturore, janë ata që ndërliiden me termat e ekstremizmit dhe të terrorizmit.

Ekstremizmi, si një platformë socio-politike dhe pa dyshim edhe fetare, në fakt ka të bëjë me grupe të atilla sociale, politike dhe fetare, të cilat kanë probleme serioze me identitetin e tyre të lu-

hatur, të kontestuar, apo edhe të humbur për shkaqe të ndryshme sociale, politike, kulturore e civilizuese!

Në fakt, ideja apo synimi i njeriut, që nga fillimet e hershme sociopolitike, ishte dhe mbetet ai i “vetëkërkimit”, për origjinën e tij, se kush është ai, prej nga vjen dhe ku shkon? Një synim identik i “vetëkërkimit” duket se ka të bëjë edhe me grupet, komunitetet, kombet, bilebile edhe religjionet e shtetet (e reja sidomos!)! Pra, imitimi apo identifikimi i shteteve (të reja dhe të vogla sidomos!), me shtetet e mëdha dhe me influencë globale, është pothuajse normal dhe i dukshëm edhe në kohën tonë. Kjo vlen posaçërisht për SHBA, Rusinë, Kinën dhe Indinë. Në këtë proces “vetëkërkimi” identitar, pësojnë më së shumti vendet dhe shtetet e ndara (padrejtësisht e historikisht), shtetet e varfra, ato me territor të vogël, e sidomos vendet dhe shtetet që kanë pozitë strategjike në këmbimet tregtare, sociale e kulturore.

Andaj, pakënaqësitë, mospajtimet lidhur me mënyrat e krijimit të raporteve (lexo: varësive të reja; ekonomike, politike, civilizuese dhe sosh kulturore) është e natyrshme të sjellin edhe mendime dhe gjykime “laramane” në (mos)kycjet e reja me hegjemonët e kohës! Si pasojë, linden edhe pozicionohen grupe të pakënaqura me këto procese e rrjedha; lokale, rajonale, kontinentale e globale. Për të kuptuar më mirë këto trende globale, mendoj që është e udhës të shohim se çka po (nën)kuptohet p.sh. me termin apo konceptin e shpërndarë dhe të njohur gjithandej në glob: çka është fundamentalizmi islam? Nëse dëshirojmë t’i japim një përgjigje tipike shkencore, sociologjike, atëherë patjetër që: fundamentalizmin islam duhet shpjeguar edhe si reagim ndaj krizës së identitetit të krijuar nga (post)modernizmi, ndaj tepërcës së shoqërive të konsumatorizmit, ndaj pafuqisë së imponuar nga padrejtësitë strukturore dhe liberalizimit global të tregut. Faktikisht dhe fatkeqësisht, këtë lloj fundamentalizmi (se janë prezent në skenën globale edhe të tjerët...por, me pak gjithsesi) po e “ushqejnë” ekspansioni marramendës i tregut, (që rezultoi me kolapsimin e komunizmit dhe rënien e Murit të Berlinit) dhe interpretimi i fragmentarizuar që i bëhet Islamit të sotëm.

Duke shikuar, nga ky këndvështrim islami burimor, po bëhet apo të paktën pretendohet të imponohet, jo më si kundërshti ndaj Perëndimit, por si alternativë globale sociale e politike. Ndërkaq, duhet ditur dhe kuptuar që diskursi mbi

fundamentalizmin islamik, në fakt në tregun global është vetëm një katërçip-tëzi e asaj që është në të vërtetë. Këtu, para së gjithash, s’duhet harruar joshjen që mund ta krijojë në të ardhmen rreth temave mbi: egalitarizmin, përgjegjësinë rreth diversitetit (social, ekonomik, etnik, racor etj.); konsultimin dhe konsensusin etj. që realisht i bie një ngatërrim (herë i qëllimshëm, e herë i paqëllimshëm!?) midis asaj që shquhet si edukim fetar dhe histori fetare të religjioneve!

A janë njëjtë edukimi fetar me historinë fetare, dhe pse po ndodhë terrorizmi? Duhet kuptuar digresionin se edukimi mbi etnopsikologjinë fetare dhe çështjet e fakteve rreth historive fetare, nuk janë e njëjta gjë! Ngatërrimi, i këtyre dy kategorive, përveç keqkuptimit social, sjell edhe trauma në sferën shpirtërore (diversitet dhe ndarje komplekse) dhe pasoja në sferën politike (paragjykime dhe stereotipizime absurde). Ato do ndikojnë edhe më tej në formimin, brumosjen dhe kalitjen e secilit individ, edhe për shkakun se njeriu vërtet akoma mbetet një “zoom politik”, social që vulos të tashmen dhe të ardhmen e vet..., pandalur! Terrorizmin nuk e provokon aq shumë feja, sa e bën atë ekspansioni i grykësisë së kapitalizmit grabitqar, dhe shërbimet militante të grupeve mercenare që janë në shërbim të dominimit (kaosit!) global! Pra, kur kërkohen terroristët, thjesht, duhet të kërkohen njerëzit që blejnë armatim të dyshimtë terrorist, e jo sish që i luten me sinqeritet Krijuesit! Ky term, si dukuri dhe fenomen sociologjik, është edhe një formë tejet e komplikuar e “trajnitimit” të dhunës politike. Për të thuhet që është edhe një lloj ekstremizmi me doza politike! Kurse, ekstremizmi, më saktë, mund të definohet si një lloj sjelljeje e atillë sociale që “vegjeton” gjithnjë midis asaj që është e lejuar dhe asaj që është e sanksionuar! Pra, ai është sikur një lloj “parakalimi” mbi një zonë të “minuar”! Për nga numri, ekstremistët asnjëherë nuk janë shumë, por janë zhurmues dhe fanatikë në qëllimet dhe synimet e tyre! Çfarëdo qofshin, dhe prej kujtdo qofshin, ato! Në politikë, ekstremizmi zakonisht manifestohet si “një lloj animimi i qëllimeve të kornizuara ekstreme”, që pretendon gjithnjë të fuqizohet përmes metodologjive normale! Në fakt, ekstremizmi mund të thuhet dhe definohet edhe si një lloj devijimi i skajshëm, edhe për shkak se “vullnetarisht” ikën dhe sistemohehet në normat sociale, sportive, politike, e sidomos ato fetare.

Ajo çka i jep “shpirt” dhe karakter fenomenit, apo “dosjes” së ekstremizmit, janë kryesisht motivet dhe qëllimet politike! Motive dhe qëllime këto, që me karakterin e tyre politik, ekstremizmin e katapultojnë drejtpërdrejt në fushëbeteja dhe ngjyrimet: fetare (monoteiste) e ideologjike (djathtëste e majtiste).

EKSTREMIZMI IDEOLOGJIK, NJË RREZIK PËR RELIGJIONET MONOTEISTE

Tani, ekstremizmi ideologjik djathtëst (ai fetar), e kundërshton globalizimin shkaku i ruajtjes dhe konservimit të fundamenteve fetare; kurse, ekstremizmi majtist (ai social komunist), globalizimin e projekton si gogol, edhe shkaku i rrezikut nga varfëria...! Kështu që procesi i “vetëkërkimit” është goxha kompleksiv dhe shumëdimensional. Kompleksiv, shkaku se problemet identitare shpërfaqën tani si probleme akute, që kërkojnë urgjenca definimi dhe qartësimi! Kurse shumëdimensional, shkaku se dilemat ekzistuese civilizuese, të këto vende e shtete të vogla, dhe të varfra, bëhet shpeshherë problematik dhe i rëndësishëm si për “sponsoruesit dhe arkitektët” e pavarësimeve dhe shteteve që u jepet peshë dhe rëndësi, qoftë rajonale (Ballkani) apo kontinentale (Azia). Kështu që “krizat” identitare të stilit: “kush jemi ne, prej nga vijmë, dhe ku shkojmë”, edhe si shtet, vend e komb, sot janë përditshmëri!

Sipas Samuel Huntigtoni, kjo gjendje dhe “krizë” identitare mund të tejkalohet përmes disa mënyrave. Përmes ndihmës së institucioneve shtetërore, elitave (politike, ekonomike, e kulturore) dhe natyrisht popullsia, e cila duhet të informohet për nevojat, detyrimet dhe kahet e ndryshimeve eventuale, si edhe ndihma nga Perëndimi (aludimi është: Amerika dhe Evropa). Duhet kuptuar që integrimet evropiane korrespondojnë me proceset globalizuese, nevoja për një epistemologji sociale të religjioneve monoteiste. Nëpër shkolla publike, sot në botën postmoderne, s’duhet të mbetet më një cilësim paragjykues dhe tentim stigmatizimi për religjionet monoteiste, ashtu siç ishte, apo edhe është aktualisht, në pothuajse shumicën e vendeve të tranzicionit, por është një nevojë imediate e kohës në mënyrë që t’i shmangemi fundamentalizmave, ekstremizmave dhe terrorizmave të të gjitha llojeve dhe niveleve.

Përvoja evropiane na dëshmon se njohjet shkencore (e jo ato pseudoshkencore) të historive të religjioneve mono-

teiste (një sferë goxha komplekse dhe e ngarkuar shpesh edhe me klishe pseudo-ekumenike) janë treguar si të shëndetshme edhe për faktin se, mes tjerash: a) kanë zbutur mendjet paragjykuese, b) kanë shëruar patologjitë sociale dhe c) kanë reduktuar frustrimet e individëve, grupeve, komuniteteve, por edhe të popujve dhe shteteve të ndryshme evropiane. Pra, kjo iniciativë assesi s’duhet kuptuar dhe interpretuar si tentim për të futur “mësimbesimin fetar” nëpër shkolla publike, por si një koherencë kulturore, pra si një njohje ndërfitetare midis religjioneve dhe si përvojë e qëndrueshme, ku përmes njohjeve reciproke ndërtohen urat mes feve, konfesioneve, racave, civilizimeve dhe kulturave.

Mosnjohja apo mosdija e religjioneve për njëri-tjetrin s’është përparësi, por pengesë që ka prodhuar, po prodhon dhe do të prodhojë pasoja negative në njerëz dhe të mira materiale, si edhe një frustrim deri në nivel kontinental e global! Kjo, tanimë prodhon pa dyshim edhe fenomenin tjetër aktual e me përmasa globale, të shquar dhe të identifikuar si terrorizem. ”Terrorizmi nuk ka as komb, as shtet, as ... e as fe...! Bota në të cilën po jetojmë ne shquhet si botë e rrezikshmërisë (Risikogesellschaft) të shkallës së lartë!” (Ulrich Beck, Risk Society, 3.25.2009)

Dilema “hamletiane”, për mendimin tim, qëndron në atë se: a duhet ne nga pragu ynë lokal ta refuzojmë dhe ta kundërshtojmë këtë të keqe (gjë që jam tërësisht dakord!), që ka marrë përmasa të paparashikuara, apo duhet të mësohemi të “bashkëjetojmë” me të? Përgjigjen (lidhur me terrorizmin)... po e ka problem e gjithë bota ta gjejë! Problemi, (tek shumica e sociologëve bashkëkohorë, të paktën çka kam mundur ta shoh) qëndron te shkaqet e tendencës së dominimit, eksploatimit, ndryshimit, imponimit, subordinimit të kombeve, feve, shteteve, vendeve, rajoneve, kontinenteve...

4) Muhamed Kutub, Sa jemi myslimanë, Furkan ISM Shkup, 1420/1990, shih: Islami i mire, fq. 50-62

5) Cristian H. Hoffman, I shtrirë nga të gjitha anët, Asr, Tetovë, 2003, fq.186

6) Ekmeleddin Ihsanoglu, Zapad i Islam, Sarajevë, El Bejan, 2001, fq. 59-62.

7) Milazim Krasniqi, (2007), “Islami i keqkuptuar dhe fatkeqësia botërore”, Zëri Ynë, fq.138.

8) Fikret Karcic, Razumevanje islamskog vjerozakona (Sheriata) u svremenom muslimanskom svijetu, që mund të gjendet ne: Islamski fundamentalizam, Sta jo to, i përgatitur nga Nusret Cancar & Enes Karic, Sarajevë, 1990, fq.40.

PREJ SHKAQEVE TË EKSTREMIZMIT FETAR

Në shtrembërimin e fesë ekzistojnë shkaqe shpirtërore, psikologjike dhe të tjera shkencore, të cilat shfaqen në thëniet e veprat e njeriut, ku vihen re gjykime të cilat i jep ky njeri mbi persona apo gjëra! Këto shkaqe ndryshojnë nga njëra-tjetra sipas forcës e dobësisë dhe sipas madhësisë; shumë apo pak, por ato sidoqoftë kanë një ndikim të thellë në marrjen e qëndrimeve dhe të drejtimeve!

Ajo që kërkohet nga adhurimet, të cilat i ka obliguar Zotit (xh. sh) për njerëzit, është që këto të pastrojnë ndërgjegjen, ta mbrojnë atë nga sëmundjet e jashtme e të brendshme dhe ta imunizojnë moralin njerëzor nga shtrembërimi, degradimi, padrejtësia, abuzimi. Kjo gjë do të plotësohet detyrimisht kur adhuruesit do ta tejkalonin anën formale të adhurimeve, kur do t'i ktheheshin realitetit të tyre dhe rënia në sexhde trupat dhe të lëvizë gjëja më e shtrenjte në qenien e tyre - zemra e mendja, në kohën kur lëvizin gjuhët e tyre.

Ama, në qoftë se adhurimet do të qëndrojnë në cipën e dukshme dhe në shfaqjen e falsifikuar, atëherë ato nuk do të largojnë të këqijat e, as nuk do të shërojnë sëmundjet. Një ditë prej ditësh duke shkruar për Huteje-n, kur punoja në Thirrje pyeta veten: Çfarë mund të presësh nga një njeri me natyrë të ulët, përveçse këshilla me fjalë therëse dhe shprehje të këqija?

Natyrat e disa njerëzve e shtrembërojnë fenë nga pamja e saj dhe në vend që të udhëzojnë, pengojnë e, në vend që të japin, marrin! Ndërsa, Kur'ani Famëllartë na tërheq vëmendjen ndaj rrezikut të largimit për shkak të priftërinjve hebre e të krishterë, të cilët e kanë bërë fall fenë, ku me të prishin natyrën origjinale duke kërkuar interesat e kësaj bote. **“Me të vërtetë, shume prej priftërinjve (ihttarë të librave) kanë pasuritë e njerëzve padrejtësisht dhe pengojnë nga rruga e Zotit”**.ⁱ

Këta lloj njerëzish janë epidemia e krejt feve dhe për këtë poeti thotë: “A nuk e prishën fenë përveçse mbretërit e prif-

tërinjtë e saj të këqij. Shitën shpirtrat dhe nuk fituan, sepse çmimi i shitjes ishte i lirë”!

Plagët shpirtërore e psikologjike fillojnë që në vegjëli, madje mund të vijnë së bashku me tiparet e trashëgimisë dhe, në qoftë se nuk do t'i shërojë edukimi i mirë, ato rriten me njeriun deri në rini dhe mbesin në gjakun e tij edhe në pleqëri! Shiko një njeri, si p.sh Ebu Sufjani, i cili ka qenë udhëheqës i Mekës dhe plaku i preferuar në xhahilijëⁱⁱ. Nuk i shpëtonte burrave që e njihnin se, ai e do mburrjen dhe se një fjalë e vetme në rendësin e tij, mund të ndryshojë në gjykimin e tij.

Abasi (r.a) i sugjeroi të Dërguarit të Zotit që të bëjë diçka për Ebu Sufjanin, i cili të ndjehet i qetë për pozicionin që ka pas fitores se tevhidit, Islamit mbi Ummil-Kuraⁱⁱⁱ. Pejgamberi (a.s) iu përgjigj mendimit të xhaxhait të tij dhe tha: “Kush hyn në xhami, Qabe ai është i sigurt, kush hyn në shtëpi të Ebu Sufjanit edhe ai është i sigurt dhe, kush qëndron në shtëpinë e tij edhe ai është i sigurt”. Kështu që Ebu Sufjani u qetësua pasi ia përmendi emrin dhe hapi rrugën për dorëzimin e Mekës pa luftë!

Ndoshta sëmundja shpirtërore mund të fshihet pas ndjenjave të zjarrta të cilësive e xhelozisë, ndaj të vërtetës etj. Shembulli më i qartë për këtë punë është njeriu, i cili tregoi rezerva në ndarjen e Pejgamberit (a.s) të plaçkave të luftës, “El-Ganaim”, që tha: “Në këtë ndarje nuk është pasur parasysh kënaqësia e Zotit!”.^{iv} Pejgamberi (a.s) mund t'i zbusë disa njerëz me ndonjë gjë prej gërmadhave të kësaj bote, sepse bindja e plotë nuk ka zënë vend akoma në zemrat e tyre dhe dilte si detyrë për personin që nuk i pëlqen ndarja të pyeste për fshehtësinë e saj, ose të nxitonte duke akuzuar krijesën më të nderuar, Pejgamberin (a.s) dhe kjo për shkak të sëmundjes së shpirtit!

Pejgamberi (a.s) na ka bërë të ditur për këta lloj njerëzish, të cilët falen e lexojnë Kur'an shumë, por ibadeti i tyre nuk ua pastron shpirtin e as nuk ua shëron sëmundjen! Në betejën e “El-Usre”-s Pej-

gamberi (a.s) pyeti për Keab ibn Malik, se çfarë e ka vonuar atë? Një njeri duke e akuzuar tha: “E ka penguar shikimi në burden e tij!”

Kjo ishte fjalë fyese, e cila shprehte smirën! Keabi ishte njëri prej tre personave, të cilët mbeten pa marrë pjesë në këtë betejë dhe Zoti i falë e ua pranoi pen-dimin. Gjatë krizës, Keab-it i erdhi një letër nga mbreti i romakëve, i cili e nxiste të braktisë Medinën dhe ta pasonte e të ndihej krenar në rrethin e mbretit, por ai e konsideroi këtë gjë një fatkeqësi dhe e dogji letrën! Ai priti Mirësinë e Lartë derisa i erdhi, Atij i takon ajo gjë, megjithëse disa njerëz e shikojnë tjetrin me syrin e urrejtjes, duke shfaqë e fshehtë barazinë e lëvdatat, por pret t'i vijë rasti i parë që të nxisë urrejtjen që mbartë.

Një herë, një delegacion erdhi tek i Dërguari i Zotit (a.s). Në mesin e tyre ishte një njeri llafazan, bastard! Sa herë që Pejgamberi (a.s) fliste, ai shprehej me fjalë më letrare dhe përpiqej të dilte, me ato fjalë, mbi Pejgamberin (a.s). Dhe, erdhi komenti hyjnor për të cilin tha se, ky dhe të tjerë si ky që përdredhin gjuhët me fjalë ashtu siç përdredh lopa gjuhën e saj për të përtpur barin, ata kanë zjarr në Ditën e Kiametit! Sa e sa kemi parë prej garuesve të fjalës në fe, që nuk kanë dobi, veçse fjalë pa vlerë e tym në ajër, kështu që këshilla nuk ia arrin qëllimit të saj sado të jetë figurative, në qoftë se atë e shoqëron mjeti mashtrues.

Hasan Basriu dëgjoi një vaiz të fortë që fliste me fjalë të bukura, por nuk u ndikua aspak prej tij, prandaj i tha: “O ti njeri, në zemrën time ose në zemrën tënde, ka diçka”! Sëmundjet njerëzore janë të përhapura tek shumë njerëz, fetar dhe jo fetar. Ndërsa psikologët bëjnë të ditur se këto sëmundje janë më të rrezikshme sesa sjelljet e ulëta materiale.

Është e ditur se mëkatet e zemrës janë më të rrezikshme se mëkatet e gjymtyrëve! P.sh: Mendjemadhësia është më e rrezikshme se pirja e alkoolit, edhe pse feja i ka caktuar dënim të shpejtë për të akuzuar alkoolit, por ia ka vonuar atë mendje-



mëdhjenjve në ditën kur asnjë këmbë nuk ka për të lëvizur. E fshehta e kësaj qëndron se, pirja e alkoolit në shumicën e rasteve, i shkakton dëme vetëm atij që e pi, pasi ai me alkool dëmton organizmin dhe poshtëron mendjen e tij, ndërsa mendjemadhi mbron të drejtat e njerëzve, i bën padrejtësi atyre, duke mos pasur kufi e cak dhuna që shkakton.

Mos mendoni se mendjemadhësia është mbajtja e kokës lart dhe ecja me hapa të rëndë! Këto janë shfaqje feminare! Mendjemadhësia është mohimi i të vërtetës, padrejtësia ndaj njerëzve dhe ecja në atë rrugë, e cila imponon epshet personale mbi një pjesë të madhe njerëzëve të sëmurë, të cilët të drejtën e quajnë dhunë dhe, dhunën e quajnë drejtësi. Musai (a.s) i thotë Faraonit: **“Ju kam ardhur me fakte të qarta prej Zotit, prandaj dërgo me mua beni israilët”**.^v Vjen përgjigjja e dhunshme: **“Me të vërtetë ky është një magjistari i përsosur, që dëshiron t’ju nxjerri nga toka juaj”**.^{vi}

Njeriu, i cili dëshiron t'i shpëtojë së bashku me popullin e tij dënimit akuzohet se, ai ka për qëllim të nxjerrë njerëzit nga toka e tyre. Kur disa prej ndjekësve të së drejtës i besuan Musait (a.s), Faraoni tha: **“A i besuat atij para se unë t’ju lejoj”**.^{vii} Lavdi i qoftë Zotit! Përse të pres lejen tënde!?

Që në kohë të vjetra kanë ekzistuar kësajsoj tipash zullumqarë, që mbajnë emra të mëdhenj, të cilët kanë qenë fatkeqësi për popujt e tyre, duke paguar mijëra e mijëra viktime, sigurimin e lavdisë personale, të cilën e pretendonte njeriu duke

thënë: Unë jam shteti! Ose: Unë e askush tjetër!

Despotizmi politik është ambienti me i përshtatshëm për mbirjen e këtyre faraonëve dhe, ajo që na bën më tepër për të ardhur keq, është fjala se: “Ekzistonin më shumë në Lindje se sa në Perëndim, kjo është pengesa më e madhe në ngritjen e shumë popujve dhe sekretit i përhapjes së të këqijave e poshtërsive. Kur kërkohet për virusin e devijimit në mesin e shumë fetarëve, do të gjejmë këta lloj faraonësh pas shumë rrugëve, të cilat i refuzojmë dhe na vjen keq për pasuesit e tyre.

Disa grupimeve, mendimet e tyre u kanë mbirë nëpër burgje, që ua shtuan entuziazmin e tyre si pasojë e zemërimeve, ditën kur arriti një person i vetëm të urdhërojë arrestimin e 18 mijë vetëve brenda një nate dhe të shtinte tmerrin e llahtarinë në 18 mijë familjeve myslimane!! A më lejohet mbrojtja me këto fjalë nga ekstremizmi? Jo, cili është ai dijetar mysliman, i cili pranon shtrembërimin e ideologjisë dhe devijimet shpirtërore!

Me të vërtetë, ky njeri ka boshllëk në tru, pasi dihet që Mësuesi i Mesazhit, sa herë që i është paraqitur rasti për të zgjedhur mes dy gjërave, ka marrë atë më të lehtë e tyre, ndërsa këta të rinjtë, sa herë që u jepte rasti për të zgjedhur mes dy gjërave, kanë marrë më të vështirën e tyre.

Feja islame pranon argumentin e mohon dhunën, duke mos e pranuar, përveçse e imponuar, ndërsa këta të rinjtë, kanë vështruar mënyrat me të cilat janë sjellë të tjerët me ta, duke lejuar të derdhet

gjaku e të cenohen nderet e tyre. Kështu që, nuk kanë gjetur alternativë tjetër, veçse armën!!

Në mesin e fetarëve ekzistojnë tipa me fukarallëk të madh në kulturën e tyre islame dhe po që se kanë bagazh diturie, e kanë nga fletë të thata e të zverdhura, larg nga mendimi i saktë islam dhe thëniet të vlerësuar të dijetarëve! Ata pëlqejnë hadithin e dobët ndaj të saktit, ose kuptojnë hadithin e saktë jo sipas qëllimit të tij dhe, në qoftë se ekzistojnë në trashëgimin tonë, shumë shkolla intelektuale, ata janë me kuptimin sipërfaqësor kundër shkollës intelektuale^{viii}, janë me “përrjashtime” kundër përparimit.

Kam dëgjuar disa prej tyre që mohojnë rumbullakësinë e tokës dhe rrotullimin e saj. Nuk pushonte lufta e tyre derisa ju bë e ditur se Ibn Kajjim thotë: “Rrotullohet!” Kështu që, të pushojë e të qetësohet zhurma rreth këtij argumenti!! A ekziston te këta njerëz dhe në mes të havariëve të dikurshëm ndonjë afërsi shpirtërore, apo ideologjike?

Ndoshta, megjithëse akuza e havariëve për ndarjen e ymetit, duhet të dëgjohet nga një kalif i drejtë, me të cilin kam për qëllim udhëheqësin e duhur, i lindur nga një konsultim i saktë dhe që e meriton atë post! P.sh në qoftë se udhëheqësi i padrejtë do të akuzonte njerëzit, atëherë përgjigjja do të ishte e ditur, do t'i thuhej: cili është vendi yt tek ymeti, çfarë vlerash ke dhe a ju përgjigjesh interesave të tyre?

Një mjedis i lirë, ai është vendi i vetëm në të cilin ekstremizmi vdes, duke u groposur anëtarët e tij, ngadalë ose shpejt, kryesorja është që ata të zhduken, ose të mos jenë më! Degjenerimi politik nuk e pranon devijimin e besimit, e as edhe shtrembërimin e fikhut, legjislativ se feja nuk është perde për të mbuluar të metat, por ajo është pastruese e tyre dhe shkolla që i lufton ato. Kështu që, nga përvoja kuptoj se ekzistojnë gjëra që më çojnë në neveritje nga fetarizmi mashtrues dhe mbes gjithmonë duke paralajmëruar për rrezikun e tij.

(Shkëputur nga libri: “Probleme në rrugën e jetës islame”) Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

ⁱ Surja Teube, ajeti: 34.

ⁱⁱ Periudha e injorancës paraislamike.

ⁱⁱⁱ Ummul-kura, emër i Mekës i përmendur në Kuran.

^{iv} Surja E’arafë, ajeti: 105.

^v Surja E’arafë, ajeti: 109-110.

^{vi} Surja E’arafë, ajeti: 123.

^{vii} Medresetur-rej

CILAT VLERA I TRADHTOI TERRORISTI I VJENËS

Më 2 nëntor (2020), rreth orës 8 pasdite, një sulmues i armatosur rëndë hapi zjarr mbi njerëzit para një kafeneje në një restorant në Seitenstettengasse në Vjenë, ku nga ky sulm mbetën të vrarë 4 persona dhe 23 të tjerë u plagosën, dhe nga policia u ekzekutua edhe sulmuesi. Sulmuesi i vrarë nga policia u identifikua si Kujtim Fejzullahu, i lindur në Austri. Ai krahas shtetësisë së Austrisë, kishte edhe shtetësinë e Maqedonisë së Veriut. "Shteti Islamik" (Daesh) e mori përgjegjësinë për aktin terrorist.

Në vitin 2019, sulmuesi u dënua me 22 muaj burg në Austri, pasi që u përpoq të bashkohej me një grup terroristësh në Siri. Burimet austriake raportojnë se ai ndoshta u radikalizua në një "komunitet xhamie", i cili nuk funksionon nën ombrellën e Komunitetit Islam të Besimit Islam në Austri (IGGÖ). Ideologjia e veçantë që e shtyu këtë të ri të kryejë këtë akt terrorist do të duhet të shqyrtohet gjatë hetimit. Në këtë pikë duam të përpikemi të gjejmë një përgjigje për një pyetje tjetër: Cilat vlera u tradhtuan nga ky terrorist i ri?

Sipas mendimit tonë, ky i ri, i lindur në Austri, i rritur në një familje shqiptare nga Maqedonia e Veriut, i cili u identifikua si mysliman, tradhtoi këto vlera:

1. statusin e një shtetasi austriak,
2. besimin islam dhe
3. vlerat tradicionale shqiptare.

E para: Kujtim Fejzullahu ishte shtetas i Republikës së Austrisë, të cilin status (të shtetasi austriak) shumë kolegë të tij në Ballkan dhe jashtë Bashkimit Evropian e kërkojnë me dëshirë për ta pasur. Ai kishte të drejtat, detyrat dhe privilegjet e një qytetari të një prej shteteve më të respektuara në Evropë. Një qendër për zhvillimin e shkencës, teknologjisë, kulturës dhe arteve evropiane. Në këtë vend, Islami u njoh si një fe në të drejtën publike në vitin 1912. Bashkësia Islame në



Bosnjë dhe Hercegovinë u themelua brenda sistemit shtetëror të kohës; koncepti i Evropës Qendrore u përhap në Ballkan. Ky është vendi në kryeqytetin e të cilit u pagua qiraja dhe jetesa e Kujtim Fejzullahut, duke dhënë ndihmë sociale që arrin në 917,35 euro në muaj (sipas raporteve në Kronen-Zeitung).

E dyta: akti terrorist tradhtoi besimin islam. Vrasja e një personi të pafajshëm, siç thuhet në Kuran, është e barabartë me vrasjen e të gjithë njerëzimit (Al-Maida 5:32). Në sistemin normativ islam, jeta e njeriut është në ballë të mallrave të denjë për mbrojtje. Ai që vret njerëz të pafajshëm dhe i nënshtron ata ndaj tmerrit, në ligjin islam quhet muharib. Dënimet më të rrepta janë parashikuar për këto akte. I njëjti sistem normativ dënon thellësisht mosrespektimin e detyrimeve kontraktuale që një qytetar ka ndaj një shteti. Dikush nuk mund të gëzojë statusin e një qytetari, të pretendojë mbrojtjen e pushtetit shtetëror, ndihmën e shtetit dhe pastaj të sulmojë qytetarët e atij shteti ose njerëzit që qëndrojnë në territorin e tij.

E treta: akti i terrorit tradhtoi traditën shqiptare, së cilës kulturalisht i takon familja e ekzekutuesit të këtij akti të tmerrshëm. Në traditën shqiptare, të kodifikuar në Kanun (ligj i zakonshëm) i

Lekë Dukagjini, ekzistojnë tri parime kryesore: besa, mikpritja dhe nderi. Besa përfaqëson konceptin më të rëndësishëm të jetës, madje edhe më të gjerë se jeta. Shkeljet ndaj Besës konsiderohen të paimmagjinueshme dhe rezultojnë me përjashtim nga komuniteti. Shqiptarët në mesin e popujve ballkanikë ishin të njohur veçanërisht për qëndrimin ndaj fjalës /

premtimit të tyre. Çfarë tjetër përbën shkelja e kushtetutës dhe ligjit, nëse jo shkelje të Besës?

Në traditën shqiptare, mysafirët konsiderohen të paprekshëm. Mbrojtja e tyre është më e rëndësishme sesa marrëdhënia midis të afërmeve të gjakut. Me hyrjen në një shtëpi shqiptare, ju gëzoni mbrojtjen e kësaj familje. Hebrej të shumtë u shpëtuan nga persekutimi nazist nga familjet shqiptare. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit thuhet: "Shtëpia shqiptare i përket Zotit dhe mysafirit."

Nderi personal është një parim i tretë themelor i traditës shqiptare. Shkeljet e këtij parimi janë të pafalshme. Një shqiptar ka më shumë të ngjarë të pranojë vdekjen sesa të mos mbajë fjalën e tij, sipas studimeve antropologjike që kanë të bëjnë me këtë popull.

Si ndodhi që këto tri themele kulturore - statusi i një shtetasi austriak, besimi islam dhe tradita shqiptare - të fshihen nga mendja e një të riu gjatë procesit të radikalizimit? A janë më të fortë se tre faktorët kulturorë demagogët ekstremistë, të cilët tani nuk kanë më vend në vendet ku morën arsimimin e tyre, të cilët gëzojnë prosperitetin e "Perëndimit të korrumpuar" dhe që "gjuajnë shpirtat njerëzorë", siç kemi përmendur më lart? Shumë udhëheqës përgjegjës për arsimin, integrimin, zbatimin e ligjit, doktrinën dhe punën e të rinjve, do të duhet t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. Sepse, në këtë rast autori i krimin nuk erdhi me valën e migrimit përmes "rrugës ballkanike", por lindi në Austri.

(Prof. dr. Fikret Karčić, "Preporod", 15 nëntor 2020; përktheu: Namik Xhaferi)

NJOHJA E FEVE DHE DIALOGU NDËRFETAR, GARANCI PËR PAQEN BOTËRORE

Kohëve të fundit ka pasur shumë debate për rëndësinë e dialogut me tjetrin për të arritur paqen ndërfetare, pasi shumë nga studiuesit tanë të nderuar kanë hartuar zgjidhje të vlefshme për të arritur qëllimet e këtij dialogu. Ndër ato zgjidhje është që dialogu të bazohet në respekt të ndërsjellë, në pranim të tjetrit dhe distancim nga paragjykimet dhe mosdurueshmëria.

Feja është domosdoshmëri jetike dhe karakteristikë themelore e një individi, që e dallon atë nga qeniet e tjera. Është domosdoshmëri dhe nevojë e patjetërsueshme e njerëzimit dhe një karakteristikë e qenies njerëzore. Ajo është një instinkt i ngulitur thellë në psikën njerëzore. Botëkuptimet e besimtarëve për fenë e tyre përbëjnë një larmi, e cila nuk mund të mohohet, por duhet të njihet dhe të respektohet, dhe këto kuptime – edhe brenda së njëjtës doktrinë – ndryshojnë, pasi është një nga karakteristikat njerëzore dhe burim i njohjes dhe afrimit ndërmjet njerëzve.

Diversiteti si një fenomen natyror dhe njerëzor, në këndvështrimin e Kuranit konsiderohet një nga shenjat më madhështore të Zotit, mrekullitë dhe shenjat e aftësisë së Tij në krijimin dhe mbretërinë e Tij. "O njerëz, Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe u kemi bërë popuj e fise që ta njihni njëri-tjetrin. Më fisniku tek Allahu është ai i cili më së shumti i ruhet Atij; Allahu, me të vërtetë, është shumë i dijshtëm dhe i informuar mirë." (Huxhurat,13)

Diversiteti i racave, gjuhëve, gjinive dhe tipareve të ndryshme midis njerëzve, si dhe shumëllojshmëria në fruta, në të lasha, në tokë, në kodra e male... etj., janë nga shenjat e Tij, të cilat bëjnë thirrje që të mençurit dhe studiuesit të meditojnë dhe të reflektojnë, të shohin përtej botës së tyre, në mënyrë që të kuptojnë madhësinë e Universit dhe forcën e Zotit. "Nga argumentet e tij është edhe krijimi i qiejve dhe tokës, llojllojshmëria e gju-

hëve tuaja edhe e ngjyrave tuaja; këto janë, njëmend, mësim për ata që dinë." (Er-Rum,22)

Universalizmi në kuptimin e hapjes ndaj të tjerëve, respektimi për vlerat dhe zakonet e tyre, njohja e ekzistencës dhe veçorive të tyre si ato etnike, gjuhësore dhe gjeografike, janë vlera sublimë me të cilat karakterizohet gjinia njerëzore. "Ne me të vërtetë i kemi nderuar bijt e Ademit: i kemi shëtitur nëpër tokë e nëpër det dhe i kemi furnizuar me ushqime të mira e me shije, dhe u kemi dhënë përparësi të mëdha ndaj shumicës që i kemi krijuar." (Isra, 70)

Dhe, universalizmi nga një këndvështrim fetar-filozofik islam është i lidhur ngushtë me doktrinën e monoteizmit dhe është i pandashëm prej saj.

Feja dhe besimet kanë një rol dhe funksion të rëndësishëm shoqëror dhe individual, pasi shpesh arrin të krijojë harmoni dhe lumturi për individët dhe kontribuon në kohezionin dhe rritjen e shoqërisë, që do të thotë se ajo ka detyrimet e saj reale, përndryshe nuk do të ishte në këtë masë kjo përhapje dhe rritje e saj.

Studimi i feve ka një rëndësi të madhe, duke përfshirë njohjen e qëndrimit mbi të vërtetën e feve, identifikimin e shkallës së ngjashmërisë dhe kontrastit midis feve dhe përcaktimin e pozicionit të studiuesit mbi këtë apo atë besim, duke shpresuar se do të ketë një bum në studimet e feve krahasuese, veçanërisht që të tjerët kanë njohuri të mjaftueshme dhe dinë më shumë për Islamit sesa myslimanët.

TË GJITHA FETË NDAJNË NJË VLERË TË PËRBASHKËT

Fatkeqësisht, myslimanët kanë informacion të pamjaftueshëm në lidhje me fetë e tjera, në mënyrë që të dinë se çfarë është e përbashkët mes nesh që të jetojmë në paqe, në harmoni dhe tolerancë, veçanërisht pasi që të gjitha fetë ndajnë një vlerë të përbashkët: "njohjen e ndërsjellë, bashkëpunimin dhe bashkëjetesën mes popujve".

Feja është një nga drejtuesit kryesor të racës njerëzore dhe kulturat e ndryshme bashkëkohore mund të kuptohen vetëm nëse i kuptojmë fetë që u përkasin atyre, ndonëse shumësia e feve është një realitet i gjallë. Nuk ka asnjë vend në botë, madje edhe viset më të izoluar, fiset më primitive që nuk ushtrojnë një besim apo dogmë në një mënyrë apo tjetër.

Të gjithë pa përjashtim: hebreu, i krishteri, myslimani, budisti dhe gjithë të tjerët janë pjesë e shoqërisë civile, ndajnë të njëjtën hapësirë gjeografike, me ç'rast multikulturalizmi dhe multikonfesionalizmi janë vlera të shoqërive të zhvilluara me sisteme të rafinuara demokratike, që këtë kolorit e konsiderojnë si vlerë sublimë. I gjithë ky diversitet është dëshmi dhe një prej shenjave të mëdha të Zotit në univers, siç janë diversiteti gjuhësor, etnik, racor dhe religjioz. "Ndhimoheni njëri-tjetrin në bamirësi dhe devotshmëri dhe mos ndihmoni në mëkat dhe armiqësi!" (El Maide, 2)

Çdo fe është e ndarë në grupe dhe

sekte. Islami në vete ngërthen dy grupimet më të mëdha: sunitët dhe shiitët; Krishterimi në vete ngërthen katolicizmin, ortodoksizmin, protestantizmin; e njëjta mund të thuhet edhe për Judaizmin, me ndarjet dhe sektet e ndryshme. Prandaj, studimi i feve është i rëndësishëm për hir të pranimit të idesë së bashkëjetesës nën të njëjtin nënqiell, qoftë të feve të ndryshme apo të sekteve me njëri-tjetrin për paqen, sigurinë dhe mirësinë e gjithë gjinisë njerëzore. Në të njëjtën kohë, pranimi i idesë së ekzistencës së feve të tjera me shumësinë e tyre, me një kuptim të saktë shkencor ndaj feve, ndihmon në zhvillimin e mendimit në përgjithësi, duke kontribuar në krijimin e një botë-kuptimi më të gjerë dhe gjithëpërfshirës për jetën, për natyrën dhe për njerëzimin, si dhe për problemet bashkëkohore të tij.

Këtë mund ta lexojmë drejt në Deklaratën e Medinës, të hartuar dhe të shkruar nën direktivat e Muhamedit, paqja e Zotit qoftë mbi të, menjëherë pas migrimit të tij në Medinë, përkatësisht në vitin 623, e cila llogaritet si dokumenti i parë civil i integruar në histori që vendosi rregullat e shtetësisë, konfirmoi shtyllat e drejtësisë midis përbërësve të shoqërisë dhe sekteve të saj dhe organizoi marrëdhëniet midis tyre, në mënyrë që toleranca dhe dashuria të mbizotëronin dhe njerëzit të hynin në paqe.

Rëndësia e njohjes së feve, doktrinave dhe grupeve të ndryshme është për shkak të arritjes së një niveli të lartë të vetëdijes dhe njohurive gjithëpërfshirëse të feve, ku studiuesi i vendos ato në pozicionin e gjykimit për ta sjellë mendjen e tij në rezultate korrekte dhe të disiplinuar. Në këtë mënyrë ai bën një krahasim të vlefshëm shkencor dhe metodik bazuar në argumente, fakte dhe prova të forta për të provuar njohuritë e sakta që ai ka arritur e që nuk duhet të jetë i njëanshëm dhe të mos karakterizohet nga prirja e fanatizmit. Por, në sajë të një logjike të arsyeshme dhe të pranueshme larg çdo iluzioni ose devijimi mendor, duke shpjeguar se shkenca e feve krahasuese është një shkencë e domosdoshme që çon në tërheqjen e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis feve dhe ndihmon për të njohur të saktën nga e pasakta, për të nxjerrë në pah të vërtetën dhe për ta rikthyer atë në burimin e saj të vërtetë hyjnor.

Bota e sotme është bërë një tërthorëse në gjymtyrët e saj, me gjithë ata “trarë” a “zinxhirë” të gjatë, që përbën një lidhje të vetme e të pandërprerë, sidomos pas inovacionit shkencor të mjeteve moderne të komunikimit, gjë që kërkon domosdoshmërinë e arritjes së bashkëjetesës pa-



qësore me të gjitha racat, etnikumet dhe grupet e ndryshme religjioze që ndajnë të njëjtin nënqiell dhe hapësirë gjeografike, për një botë më të sigurt, larg urrejtjes, paragjyqimeve, konflikteve dhe religjiofobisë, për të jetuar të gjithë së bashku në paqe dhe harmoni të plotë.

Nëse njeriu i sotëm përreth tij do të zbulojë se kushdo që jeton në sipërfaqen e tokës nuk është pa një besim ose doktrinë, mbi të cilin bazohen ndjenjat dhe emocionet e tij, ky besim është faktori nga i cili ai detyrohet në jetën e tij, sipas koncepteve të mendjes së tij dhe të zgjedhjes së tij, që është një realitet i lindur dhe subjektiv, të cilin njerëzimi e ka që nga fillimi i krijimit. Njeriu, pa marrë parasysh se çfarë njohurie dhe përvoja ka arritur, prapë do të mbetet i kufizuar dhe i mangët në njohuri, sepse çdo ditë sjell diçka të re.

FETË ZHVILLOHEN NË PËRPUTHJE ME ZHVILLIMIN KULTOROR

Njohja e feve dhe besimeve ndihmon në menaxhimin dhe drejtimin e sjelljes së popujve të të gjitha shtresave për një bashkëjetesë dhe harmonizim midis kombeve të kulturave të ndryshme, të

gjuhëve, të shkallëve të fetarisë dhe të besimit. Fetë zhvillohen në përputhje me zhvillimin e kulturave të njerëzve. Fetë do të qëndrojnë për sa kohë që njerëzimi do të mbetet dhe do të zhvillohet. Me zhvillimin e saj, ajo gjithmonë do t'i përgjigjet shkallës së kulturës racionale që arrin grupi. Feja dhe prirjet praktike që rezultojnë nga besimi janë motori i kulturës së njerëzve dhe udhëzuesi i mendjeve për të korrigjuar sjelljen dhe ndërveprimin e lartë njerëzor.

Studimi i feve i jep një rëndësi të madhe njohëse, për të gjetur arsye për të vërtetën e tij dhe për të përcaktuar pozicionin e pronarit të kësaj shkence mbi këtë apo atë besim dhe gjithashtu na siguron mendimin njohës për të kuptuar fenomenin fetar, kulturor dhe civilizues të shoqërive njerëzore, në mënyrë që qëndrimet e mbylljes ndaj vetes dhe dëshira superiore për të besuar në një fe të veçantë dhe të përjashtojë çdo fe, mund të kapërcehet. Është një shkencë që kontribuon në përmirësimin e mirëkuptimit të ndërsjellë midis njerëzve të feve të tjera dhe ndihmon në edukimin dhe zhvillimin e gjeneratave të reja, bazuar në njohuri të sakta, në kuptim dhe njohje të vetëdijshme të karakteristikave të secilës fe.

Kohëve të fundit ka pasur shumë debate për rëndësinë e dialogut me tjetrin për të arritur paqen ndërfaqetare, pasi shumë nga studiuesit tanë të nderuar kanë hartuar zgjidhje të vlefshme për të arritur qëllimet e këtij dialogu. Ndër ato zgjidhje është që dialogu të bazohet në respekt të ndërsjellë, në pranim të tjetrit dhe distancim nga paragjykimet dhe mosdurmueshmëria.

Një nga përparësitë e këtij qëllimi është domosdoshmëria për të krijuar një infrastrukturë për kulturën fetare në shkollë, që do të thotë që mësuesit dhe arsimtarët t'i kushtojnë vëmendje edukimit fetar për të rinjtë që nga fillimi i hyrjes së tyre në fazën e parë arsimore, duke zhvilluar një kurs bazë që merret me aspektin e sjelljes dhe moralit në marrëdhëniet njerëzore me të gjitha fetë, me qëllim të identifikimit të doktrinave dhe besimeve të feve të tjera objektivisht, pa fanatizëm ose ekstremizëm.

Zhvillimet e fundit dhe trendet bashkëkohore flasin për depërtimin e materializmit dhe fanatizmit në jetën bashkëkohore, dominimi i interesave dhe ndryshimeve që na vijnë nga të katër anët me emra tërheqës si globalizimi, modernizimi, intenca për modernizimin e fesë

dhe shekullarizimin e shoqërisë, thirrjet për një rol dominant të njeriut dhe për rolin e tij në univers, për natyrën dhe për gjërat e tjera. Prandaj, është bërë nevojë imediate për të studiuar librat hyjnorë dhe për të shqyrtuar tekstet e tyre me fakte dhe prova të sakta, për të zbuluar ngjashmëritë mes tyre deri në pikat e konvergencës që afrojnë dhe nuk shkaktojnë përplasje midis bijve të njerëzimit në tërësi.

Fetë monoteiste bien dakord për domosdoshmërinë për të treguar virtyte dhe vepra të drejta, për të shmangur veset dhe për të qëndruar larg të gjitha anomalive, sjelljeve devijante dhe sociopatike. Ky unanimitet në virtyte na hap një dritare për të arritur thelbin e feve që janë zbuluar për të njohur të vërtetën absolute dhe pastaj ajo hap derën për një dialog objektiv, të sinqertë dhe konstruktiv, të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut në besim dhe jetë.

Një nga të vërtetat origjinale në fe, që duhet të vendoset që në fillimet e para të dialogut ndërfaqetare, është marrëveshja e teksteve hyjnore mbi bazat më të rëndësishme të besimit fetar, që është monoteizmi. Në Kuranin fisnik thuhet: “Unë, pa dyshim, Unë jam Allahu, që nuk ka

tjetër Zot përveç meje, prandaj vetëm mua më adhuro dhe kryej faljen për të më përkujtuar.” (Ta-ha,14). Në Dhjetë Urdhërimet në Dhiatën e Vjetër, përkatësisht në librin Ekzodusi (20/2-4), që i zbulua hebrenjve nëpërmjet Mosiut/Musaït (a. s.) thuhet: “Unë jam Zoti, Hyji yt që të nxora nga dheu i Egjiptit, prej shtëpisë së skllavërisë. Mos ki tjetër Zot, përveç meje. Mos bëj kurrfarë idhulli...”

Përmendja e monoteizmit në tekstet ungjillore erdhi në thënien e tij: “Ai është i Vetmi, e pos tij s’ka tjetër. Të duash Atë me gjithë zemër, me gjithë mendje, me gjithë fuqi...” (Ungjilli sipas Markut,12/32). Vrasja, shkelja e kurorës, vjedhja, dëshmia e rreme - janë parime të pohuara nga të gjitha fetë.

DUHEN BËRË PËRPPJEKJE PËR PËRHAPIEN E KULTURËS FETARE

Të gjithë studiuesit e teologjisë, misionarët, dhe të tjerët, të ngarkuar me misionin e arsimit dhe të edukimit nëpër qendra kulturore, në qendra hulumtuese e kërkimore, në universitete etj., duhet të bëjnë përpjekje që të përhapin kulturën fetare midis gjeneratave të reja, në mënyrë që dialogu ndërfaqetare të jetë dialog

objektiv, konstruktiv, transparent dhe mbi baza intelektuale, ashtu siç kërkon Zoti i Plotfuqishëm: “Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillime të mira dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!” (Nahl, 125), në mënyrë që i gjithë njerëzimi të promovohet duke u udhëhequr në rrugët e dashurisë, bamirësisë dhe të paqes. Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe me drejtësi ndaj atyre që nuk ju luftojnë për shkak të fesë dhe nuk ju përzënë nga shtëpitë tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët. (El Mumtehineh, 8)


Për më tepër shih referencat:

- Përkthimi i ajeteve kuranore është marrë nga versioni elektronik: <http://tanzil.net/#1:1>
- Përkthimi i fragmenteve biblike të

- Dhiatës së Vjetër dhe të Dhiatës së Re, nga versioni elektronik: <http://www.bibla.net/>
- Feja, hulumtime për studimin e historisë së feve, dr. Abdullah Draz
- Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit, Alija Izetbegoviç
- Këshilli Zvicëran i Feve (Për një bashkëjetesë të feve në paqe dhe liri) www.ratderreligionen.ch
- Të kuptuarit e qytetarisë, dr. Abdul Mexhid Nexhar
- Studim mbi fetë krahasuese, dr. Salih Nu'man
- Islami, e tashmja dhe e ardhmja, Zaki Milad
- Deklarata e Medinës, iniciatore e konceptit të tolerancës, dr. Radijeh Salim
- Dialogu ndërfeetar, dr. Abdurrahim

Es-Sulemij
– Studim mbi krahasimin midis feve, dr. Abdullah Sherkavij

(Autori është imam në Xhaminë e Bardhë në Aarburg të Zvicrës. Teksti është marrë, me lejen që ka siguruar BFI, nga: <http://gazetashqiptare.al/2020/12/21/njohja-e-feve-dhe-dialogu-nderfeetar-garanci-per-paqen-boterore/?fbclid=IwAR27wRydGYv4smvMHpQZi4i4fhx-Bi93p6BQDvVCyKXithXdNsv7r9BHCu>)



ISLAMI-PAQE



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me Myftiun e Bashkësisë Islame të Kosovës, h. Naim ef. Tërnavë, me Myftiun e Tetovës, prof. dr. Qani Nesimi etj., në ngushëllime te familja Shabani, në Kamjan të Tetovës, te profesori i nderuar prof. Ruzhdi ef. Shabani për ndërrimin jetë të babait të tij. (25.12.2020)



Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Banka Islamike për Zhvillim



KONKURS

PËR NDARJE TË KREDIVE STUDENTORE NGA BANKA ISLAME PËR ZHVILLIM (ISLAMIC DEVELOPMENT BANK) GJATË VITIT AKADEMIK 2021/2022

PËR STUDENTËT QË STUDIOJNË NË KËTO FAKULTETE:

- FAKULTETI I MJEKËSISË
- FAKULTETI I STOMATOLOGJISË
- FAKULTETI I FARMACISË
- FAKULTETET E TË GJITHA DREJTIMEVE TEKNIKE

Dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e kredisë studentore:

1. Kopje e diplomës së shkollës së mesme;
2. Kopje e dëftesave të vitit të III dhe të IV;
3. Çertifikata e lindjes;
4. Vërtetim prej mjekut;
5. Indexi;
6. Vërtetim nga Fakulteti;
7. Dy fotografi personale;
8. Vërtetim për të ardhurat e prindërve (vendi ku punojnë), ose vërtetim nga enti për punësim (nëse prindërit janë të papunësuar)

Aplikimi me dokumentacionin e nevojshëm bëhet online në afatin e paraparë, nga 22.12.2020 deri më 28.02.2021, në këtë link: <https://www.isdb.org/>

Bashkësia Fetare Islame në RMV

PYETJE-PËRGJIGJE

ÇFARË NËNKUPTON SEXHDEJA E HARRESËS

Pyetje: Për Sehvi-sexhden. Tepricat në namaz në veprim dhe në lexim dhe mungesat në namaz në veprim dhe lexim, a e kanë formën e njëjtë të Sehvi-sexhdes, apo dallojnë nga njëra-tjetra? Ju faleminderit. (T. H. Tetovë)

Përgjigje: Sehvi-sexhdeja (sexhdeja e harresës) në terminologjinë e shariatit islam nënkupton sexhden e cila bëhet në fund të namazit, për shkak të harresës së veprimit apo mosveprimit që është bërë në namaz e që duhej bërë apo nuk duhej bërë, pra varësisht nga veprimi.

Sexhdeja e harresës (sehvi-sexhdeja) sipas juristëve të medhhebit hanefij bëhet në fund të namazit, respektivisht në uljen e fundit pasi të lexohet teshehudi (etehijati), jepet selam në anën e djathtë dhe menjëherë i bëhen dy sexhde të harresës. Dispozita e sehvi-sexhdes është vaxhib.

Sehvi-sexhdeja për namazliun është vaxhib në këto raste:

- Nëse gjatë namazit e vonon një farz, ose ia ndërton vendin farzit, duhet bërë sehvi-sexhde, sepse nëse bëhet lëshimi i një farzi, atëherë prishet namazi dhe duhet përsëritur.
- Nëse namazliu e vonon apo e lëshon tërësisht një nga vaxhibet e namazit, duhet bërë sehvi-sexhde.
- Nëse namazliu me harresë gjatë faljes së namazit shton ndonjë veprim që është pjesë e namazit, si p.sh. të ketë bërë një sexhde më shumë se sa duhet, duhet bërë sehvi-sexhde.

Sehvi-sexhdeja vjen në shprehje vetëm në rastet e harresës, që nënkupton se nëse namazliu e lëshon një nga vaxhibet e namazit me qëllim, në këtë rast nuk obligohet me sehvi-sexhde, por duhet të përsëritet ky namaz brenda kohës së vet; e nëse nuk përsëritet namazi, konsiderohet i vlefshëm, por me të meta.

Po ashtu vlen të theksohet se nëse namazliu, gjatë faljes së namazit, me harresë ka bërë më shumë se një veprim që secili në vete obligon sehvi-sexhde, në fund të namazit bëhet vetëm një sehvi-sexhde për të gjitha lëshimet. Muktedija i cili falet pas imamit detyrohet me sehvi-sexhde nëse imami i tij bën sehvi-sexhde. I njëjti detyrim është edhe për Mesbukin (xhemati që e ka mbërri imamin në namaz pas rukusë së rekatit të parë); edhe ky bën sexhden e harresës bashkë me imamin nëse ai bën sehvi-sexhde, e pastaj kur imami të japë selam, ky ngrihet dhe e vazhdon namazin duke falur atë që i ka ngelur pa u falur. Forma e sehvi-sexhdes për të gjitha ato veprime që e obligojnë sehvi-sexhden është e njëjtë.

Vallahu Ealem. (17.01.2021)

Në rubrikën “Pyetje-përgjigje” të revistës “Hëna e Re” pyesin lexuesit, përgjigjet studiuesi i njohur, prof. Jusuf Zimeri. Pyetjet dërgohen në këtë adresë: henaerebfi20@gmail.com. Ato botohen ekskluzivisht sipas kërkesave të lexuesve, duke ruajtur në maksimum amanetin e tyre. Ju na shkruani, ne ju përgjigjemi.



Agjencia për Hallall Standard
Агенција за Халал Стандард
Helal Standard Ajansı
Agency for Halal Standard
مكتب شهادة للمنتجات الحلال



Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.

Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.
Tel: + + 389(0)2 3117410; 3117 412.
Fax: + + 389 (0)23117 883

websait: www.bfi.mk
email: halal.bfi@gmail.com